

JORDAN HAXHINIKOLLA

NJEREZ
ME
BLUZA
TE
BARDHA

novela
dhe
tregime

BIBLIOTEKA
SHTETIT

BJH-32
H 35

JORDAN HAXHINIKOLLA

NJERËZ ME BLUZA TË BARDHA

— *Novela dhe tregime* —



1143

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

MJEKU

— 1 —

Oficeri Luan Rrapi zbriti nga autobusi urban në të dalë të qytetit, mori valixhen në dorë dhe qëndroi buzë xhadesë. Urbani, pasi u mbush me udhëtarë të rinj, u nis përsëri drejt qytetit. Ai mbeti pranë valixhes i mbështjellë për një çast nga tymi i skapamentos. Kur tymi u shpërnda, ai vuri re pesë hapa më tutje një nënoficer, që po ecte mengadalë.

— Kjo është rruga që të sñpie në repart, shoku nënoficer? — e pyeti.

— Kjo është.

Luani vuri re se nënoficeri ishte një burrë pak i moshuar, me flokë të thinjur anash. Ai ecte pak i kërrusur, i sforcuar, sikur mbante me zor një dhembje.

— Në këtë repart punoni? — e pyeti Luani.

— Si urdhëroni!

Bënë një copë rrugë në heshtje.

— Po ju nga vini? Nga shtabi epror?

— Jo!

— S'ju kam parë tjetër herë. Unë kam vite në këtë repart, dhe i njoh të gjithë oficerët.

— Kam qenë në shkollë.

— Ashtu? Thashë se mos kishit ardhur për kontroll.

Oficer Luani qeshi.

— Do ta bëjmë rrugën së bashku.

— Unë eci ngadalë, ngaqë jam pak i sëmurë, kurse ju doni ndoshta të shkoni më parë.

— Nuk nxitohem.

— Epo mirë.

— Thatë se jeni i sëmurë? Çfarë keni?

— Për këtë isha në qytet te një mjek në poliambulancë.

— Nuk keni mjek në repart?

— Jo, nuk kemi. Thonë se do të vijë një. Siç duket as që ka për të ardhur.

— Pse thoni se s'do të vijë?

— Nuk u pëlqen doktorëve të vijnë në repartin tonë.

Luani qeshi.

— Nuk mendoni mirë, shoku nënoficer.

— Ky është mendimi im.

— Mirë ... mirë. Sa fëmijë keni?

— Kam katër. Një vajzë e kam të rritur. Vjet mbaroi shkollën për ndihmësmjeko. Tani punon në maternitet.

— E pakeni një ndihmë.

— Vajza është për derën e botës.

— Ndërsa unë mendoj se vajzat janë më të dashura për prindërit — foli Luani.

Ata ecnin përbri njëri-tjetrit anës rrugës. Në qiell fluturonin ca zogj që cicërinin. Luani u hodhi një vështrim e buzëqeshi me vete. Koha ishte e bukur, megjithëse bënte pak ftohtë. Në krah të djathtë të rrugës qenë ndërtuar banesa dykatshe me kontribut vullnetar. Një grua po nderte ca

rroba të lara në ballkonin e shtëpisë së re. «Sa mirë! Sa mirë! mërmëriti Luani me vete. Çdo gjë ndritka në këto banesa: shtëpia, rrobotet dhe ajo grua e re me ato faqet e kuqe si një mollë e bukur.»

Ai vinte për herë të parë në atë qytet. Sapo kishte mbaruar shkollën e lartë të mjekësisë. Në ministri i kishin njoftuar repartin se ku do të punonte dhe oficeri i ri që nisur me tren atë mëngjez duke marrë me vete një valixhe me plaçkat më të nevojshme.

Pas kaq vjetësh studimi po kthehej përsëri në repart midis ushtarëve. Tani që pajisur me dije më të gjera mbi problemet e shëndetësisë dhe e ndjente veten plotësisht të aftë për të drejtuar atë sektor. Kishte dëshirë të madhe për të punuar. Nga reperi nuk e ndanin veçse disa hapa.

— Komandanti aty është — e pyeti nënoficerin.

— Aty.

— Po komisari?

— Edhe ai aty është.

— Më kanë thënë se janë njerëz të aftë.

— Të aftë dhe shokë të mirë. — Nënoficeri u kollit. Vërtet kërkojnë, por ama, edhe kur ke ndonjë telash, dinë të ta qajnë hallin.

— Kjo është gjë e mirë.

Nënoficeri pohoi duke tundur kokën.

— Po të sillësh mirë, njeriu ta shpërblen më tepër me punë. Unë jam pa qejf prej disa kohësh dhe shkoj dendur te mjekët. Ata më japin receta me barna...

— I merrni barnat?

— Sigurisht jo të gjitha.

Oficer Luani qeshi me sinqeritetin e nënoficerit.

— Disa mjekë kanë maninë që të mbushin recetat plot me barna.

— Po nga se vuani.

— Nga bronkiti. Mjekët më thonë se ftohem lehtë.

Nënoficeri vuri dorën në gjoks dhe tregoi në gisht vendin ku ndjente dhembje.

— Kështu thoshin ata edhe për një të sëmurë që vuante nga zemra. Por një ditë u mbeti në dorë.

— Po në repart kush merret me punët e shëndetësisë? — e ndryshoi bisedën mjeku.

— Është një oficer, një snok i vjetër. Mوندohet i gjori, por pak gjëra di ai. Reparti ynë duhet të ketë mjek, janë kaq njerëz atje, oficerë, ushtarë.

— Kjo është e drejtë.

— E drejtë është, por nuk na japin. Mbarojnë kaq mjekë çdo vit, por vetëm për repartin tonë nuk po gjendet një.

— Do të gjendet edhe një për ju.

Të dy ushtarakët ecnin në heshtje. Luani dëgjonte përplasjet e hapave të tyre mbi asfalt. Ata bënë një copë rugë pa folur. Prej andej oficeri pa ndërtesat e qytetit ushtarak, që ngriheshin rrëzë një kodre. Dalloi fushën e fiskulturës, litarët për ngjitje, paralelet e rreshtuara njëra pas tjetrës dhe lokalitë e trup rojes pranë portës së madhe.

— Më duket se arritëm? — foli Luani.

— Po, këtu është komanda.

Sapo mbaroi së foluri, nënoficerin e zuri një kollë e fortë që mënd i mori frymën.

— Ç'patët, shoku nënoficer?

— Ja, kështu më zë kolla.

Luani u shqetësua. Ai dëgjonte frymëmarrjen e ashpër që mezi ngopej me ajër. Shpejt e shpejt hapi valixhen dhe nxori prej andej një tablet të bardhë.

— Pije, — i t'na — do ta heqë kollën si me dorë.

Nënoficeri e pa me t'habi.

— Shoku oficer, domethënë ju jeni mjeku, që po presim prej kaq kohësh?

— Po, unë jam.

— 2 —

Ditën që doktori arriti në repart u interesua të shihte ambulancën ku do të punonte. Atje shkoi bashkë me zëvendës komandantin për prapavijë, oficer Latifin. Dhoma që në një ndërtesë me një kat në anë të qytetit ushtarak. Përpara ndërtesës gjendej një copë truall i papunuar. Aty u takua me infermierin e vjetër, oficer Dinen. Ai e njohu me problemet e sektorit të punës. Mjeku mbeti i zhgënjyer. Në atë dhomë të vetme do të punonte ai. Ku do t'i mbante ushtarët e sëmurë? Të paktën të kishte tri dhoma, një për vizitë, një për shtrim dhe tjetrën për vendosjen e barnave. Luani qëndroi në mes të dhomës dhe rrotulloi kokën nga të gjitha anët. Iu duk sikur dikush ia shtrëngoi zemrën me dorë. Ndjeu dhembje dhe i dëshpëruar iu afrua tryezës së mjekimit.

— Ju keni punuar gjithënjë në këtë dhomë?

— Si urdhëroni, shoku doktor.

— Nuk ka lokal tjetër?

— Jemi ngushtë me dhoma. Unë e kam ngritur zërin disa herë, por askush nuk më ka dëgjuar. Ndoshta tani që erdhët ju, do t'ju japin.

— Të paktën të kishim një infermieri...

— Tani kërkesat janë rritur. Prej kohe këtu ndjehej nevoja për një mjek. Vetëm një infermier, siç jam unë, zor se u bën ballë të gjitha problemeve.

Luani e pa oficerin në sy. Ai kishte dy sy të qetë, ngjyrë kafe, me vështrim pak të lodhur. Tëmthas i qenë thinjur, kurse mbi ballë flokët i qenë rralluar.

«Mirë që gjeta një shok të vjetër këtu, mbase do ta kem më lehtë», mendoi Luani me vete. Atë mbrëmje Luani qëndroi në ambulancë për të fjetur. Si shtrat i shërbeu një krevat i vjetër fuqshor që kërciste sa herë që rrotullohej nëpër të. Kur mbeti vetëm në dhomë, nxori plaçkat nga valixhja, disa rroba dhe ca libra të profesionit, të cilat i vendosi në një dollap të vjetër. Mbasi i rregulloi sendet, u shtri në krevat dhe nisi të mendonte. Plot mendime ia sulmuan kokën. Mendja herë - herë e shpinte në fakultet, te grupi i shokëve, me të cilët kishte mbaruar Institutin e lartë të mjekësisë, herë e flakte në shtëpi, pranë njerëzve të tij.

Tani, këtu në repart, do të kishte shumë punë. Luani nuk i trembej punës, madje ndjente një dëshirë të madhe që ta fillonte sa më shpejt. Ajo natë iu duk e gjatë. Tërë natën ndjeu erën karakteristike të barnave të jodit, të pluhurave të ndryshme të vëna nëpër kavanoza të posaçëm e të vendosur në rresht me kujdes nga infermieri i reparatit.

«Më duket si një togë e rreshtuar nga Dinja», tha me vete. Ky mendim e bëri të qeshte. Mbase do të merrem vesh me të. E përse jo?»

Në mëngjez herët Luani dëgjoi borinë e repartit. Bëhej zgjimi. Nga krevati dëgjonte vrapin e ushtarëve nëpër rrugët e qytetit ushtarak, komandat një, dy, një, dy, të nënoficerëve dhe zërat gazmorë të ushtarëve. Një ditë e re kishte filluar për repartin. Pas fizkulturës do të vinte larja, pastaj ngrënia e mëngjezit dhe kështu me radhë. Ai i dinte përmendsh të gjitha veprimet dhe oraret. Ushtarët në fillim e kanë zor, por pak e nga pak ata mësohen me mënyrën e jetesës në ushtri dhe më vonë as që duan t'ia dinë. Sigurisht çështja e të mësuarit është një problem me rëndësi, sepse ushtarët vijnë nga të katër anët e vendit nga Alpet e Veriut, nga bregdeti, nga vise malore dhe secili ka një mënyrë të vetën.

Disa të trokitura në derë e shkëputën nga mendimet. Mjeku veshi xhaketën dhe hapi derën.

— Mirë mëngjez, shoku doktor!

— Mirë mëngjez, shoku Dine!

Të dy oficerët shtrënguan duart. Ata dualën nga ambulanca dhe u drejtuan për në dyqanin e ushtarëve. Bufetieri njihej si kafexhi i mirë:

— O Mete! Na bëj dy kafe me pak!

Mjeku vuri re se lokali nuk qe i pastër; Letra, bishta cigaresh e filxhanë kafeje të palarë qenë grumbulluar kapicë. Një erë e keqe thartirë i ra Luanit në hundë. «Bobo! Ç'qenka këtu! mendoj ai. Atë çast një ushtar kërkonte të blinte petulla. Metja i mori me dorë dhe ia dha. Luanit i hipi një zemërim i fortë, por e përmbajti veten. «Sa keq, sa keq» përsëriste me vete. Atij po i vështirëso-

nej dhe pirja e kafesë. Megjithatë e piu, ngaqë nuk desh i t'ia prishte Dines. Lokali qe i palyer, kurse vetë Metja jepte e merrte me duart e tij gjithshka.

— 3 —

Kaluan disa javë derisa mjeku e vuri ambulancën në rregull. Tani, kur hyje në atë lokal të vogël, përnjëherë të krijohej përshtypja se ndodheshe në një ambient të pastër ku sundonte rregulli dhe disiplina. Çdo gjë qe në vendin e vet. Në një kënd Luani kishte vendosur musllukun, legenin dhe peshqirin. Një paravan i krijuar me garzë metrazhi të hollë e ndante atë kënd nga pjesa tjetër e dhomës. Pranë dritares ndodhej krevati i vjetër i mbuluar me një çarçaf të bardhë, ndërsa te këmbët qe vënë një copë llastiku në ngjyrë të kuqe. Mbi tryezën e punës ishin regjistri, pena e shishja e bojës. Asgjë më tepër. Më tutje gjendej dollapi i barnave, i sistemuar me shishe të shkruara me etiketë; ato i ngjanin vërtet një toge ushtarësh të rreshtuar bukur. Duke parë këtë rregull, ata që hynin e kuptonin se të gjitha këto i kishte bërë mjeku i repartit. Javët e para kishte pasur shumë punë. Drita në ambulancë shuhej vonë. Dendur me të rrinte dhe infermier Dinja. Ata punonin, sistemonin, ndryshonin vendet e dollapeve, të tryezave, vinin parulla në mur, pastaj qëndronin për një çast në mes të dhomës.

— Dine, si thua, mirë e kemi kështu?

Dinja vështronte dhomën, anonte kokën herë

nga e majta, herë nga e djathta, pastaj thoshte me solmenitet:

— Më mirë se kaq s'ka ku të vejë, o shoku solemnitet:

Por Luani nuk kënaqej; gjithnjë ai gjente diçka që nuk shkonte.

— Po për perdet ç'mendim ke?

— Pse, o doktor, dhomë pritje do ta bëjmë ne këtë?

— A e di Dine, se si duhet ta bëjmë ne ambulancën? Më të rregullt e të pastër se sa dhomat e pritjes që kemi nëpër shtëpira.

Dinja 'habitej. «I çuditshëm qenka ky njeri», thoshte me vete infermieri. «Mirë e ka, mendonte Dinja. Shumë mirë e ka. Vetëm të vazhdojë gjithmonë kështu!»

Në shtab oficerët e ndihmuan Luanin me të gjitha forcat. I dhanë fonde, bojë për të lyer, i dhanë dollap të ri. Vetëm me Mihalin, zëvendëskomandantin e prapavijës, Luani e kishte të vështirë të merrej vesh. «Po kjo punë?» 'habitej zëvendëskomandanti për prapavijë. Pa shkelur mirë këmbën në garnizon, na kërkon infermieri të re. Pse, pak telashe kemi me ndërtimet e repartit?»

Prandaj që në fillim ai u mundua t'ja pakësonte një çikë zellin e tepruar vartësit të tij. Komandanti i repartit kërkonte të ndërtohej një klasë e re, komisari donte 'kuzhinë e mensë moderne. Dhe ja tani, mbiu si nga dheu dhe dëshira e mjekut, për të ndërtuar një infermieri të re për t'u shërbyer të sëmurëve të repartit. Përse kjo infermieri në një kohë kur në qytet kishte spital të madh me tërë ata mjekë? «Më duket se këtij sho-

ku i ka marrë ca koka erë? thoshte me vete. Ç'i duhet në fund të fundit ai telash?»

— Është e vërtetë që ka spital në qytet, — thoshte Luani — por ne duhet të kemi infermieri-në tonë. Shëndetësia ushtarake ka specifikën e vet.

— Rri, doktor, se do të hapësh telashe me duart e tua — përgjegjej Mihali duke ngritur supet i çuditur.

— Telashe? E përse?!

— Si, ore, përse? A e di ti ç'do të thotë të kesh një të sëmurë të shtruar në infermieri?

— E di.

— Jo, nuk e di, se, po ta dije, nuk do ta kërkoje një gjë të tillë. Një i sëmurë do krevatin, bataniet, do ushqimin në vend, do vizitat, barnat, Ehuuu!

— Patjetër që i do.

— Ja, e shikon si erdhe në fjalën time?

— Ne e kemi për detyrë t'ia sigurojmë të gjitha. Ju bazën materiale, ndërsa unë me Dinen pjesën teknike.

Epo ky, ore! — inatosej Mihali.

Këto mendime Luani ia tha edhe komisarit të njësisë, oficer Mensur Drinit, një burri të shkurtër e topolak me ballin e gjerë, që zakonisht fliste pak por mendohej shumë. Komisari kishte ardhur në repart para disa vjetësh kur aty s'kishte asgjë nga ato që i zinte syri Luanit. Nuk kishte as kapanone, as klasa; nuk kish thujtë asgjë. kurse tani garnizoni që bërë me ndërtesa, me fusha fizkulture e me gjithshka të nevojshme për një repart. Për pak javë përfundonte mensa dhe kuzhina e re. Shpesh bashkohej me ta dhe Luani. Ata hynin e

dëlnin në mensë, nëpër anekset e kuzhinës, bisedonin, pyesnin, jepnin mendime.

— Po kuzhinën e vjetër ç'do ta bëjmë, shoku komisar? — pyeti Mihali eprorin.

— Kuzhinën e vjetër? — Komisari u mendua për një çast, por nuk foli.

Ai vështroi Mihalin, pastaj Luanin.

— Çdo ta bëjmë vërtet?

— Po sikur ta bëjmë depo veshmbathjeje? Ju e dini që jemi ngushtë.

— Ta bisedojmë dhe me komandantin.

Luani ndërhyri menjëherë:

— Shoku komisar, kuzhina e vjetër me pak punë mund të bëhet një infermieri e mirë. Një gjë të tillë e marr unë përsipër. Të paktën do të kemi një vend ku ushtarët e sëmurë të mjekohen në kushte të qeta. Kjo i shërben shumë stërvitjes.

Mihalit nuk i erdhi mirë. Depoja e veshmbathjes që e vjetër dhe, kur binte shi, pikonte. Kaq herë e kishte bërë problem, por duke mos gjetur lokal, puna kishte mbetur pa u zgjidhur? Tani që iu paraqit rasti për të pasur një lokal për depon e veshmbathjes, doli Luani me propozimin e vet për ta kthyer në infermieri. E ç'i kishte gjetur ushtarët që nuk kishin pasur infermieri në repart? Ja tek i kishte aty përpara të shëndoshë e të shkatënet porsì diva.

— Shoku komisar, — ndërhyri përsëri zëvendëskomandanti për prapavijën — më urgjente ne kemi çështjen e depon. Rrobat po na kalben. Ju e dini këtë gjë, pasi kaq herë e kam ngritur në komandë.

— E di.

— Dhe besoj se më jepni të drejtë.

— Por edhe mendimi i Luanit nuk është pa interes. Njësia jonë duhet të ketë infermierinë e saj.

— Unë nuk thashë se...

— Infermiera është më e domosdoshme — ndërhyri Luani i kënaqur që komisar i njësise mendonte si ai.

— Unë nuk them se nuk duhet. Por shoku Luan do të bëhen gjërat si me sustë. Ne e ndihmuam për ambulancën. I dhamë dollap të ri, tryezë të re, ja lyem me bojë. Unë kam kaq telashe. Më kërkohen stola për mensën, xhama për dritaret, kompesato për tavanet e kapanoneve. Po më lot mendja e kokës. Ndoshta nga pranvera do të bëjmë dhe për infermierinë...

Mihali vështronte me sy komisarin e njësise dhe mundohej të kuptonte se si do të reagonte ndaj fjalëve të tij. Mensuri e dëgjoi qetë, pastaj foli ngadalë.

— Po ti si thua, shoku Luan?

— Unë them që ta fillojmë. Po mbeti puna deri në pranverë, as që ka për ta bërë fare infermierinë.

— Nuk do të ngjasë asgjë deri në pranverë. Mos ki frikë!

— S'është puna se kam frikë...

— Epo këto punë nuk bëhen kështu, 'nap e mbyll sytë.

— Shoku Mihal, — e ndërpreu komisar zëvendëskomandantin për prapavijë — doktori ka të drejtë. Ne duhet të ndërtojmë infermierinë. Me komandantin do të bisedoj unë.

— Nuk kam tulla, nuk kam...

— Do t'i gjejmë aq tulla sa duhen për të. Na

sëmuren ushtarët dhe nuk dinë ku të rrinë. Të venë në dhomën e kulturës, nuk i pranon njeri, të rrinë në kabanon, prapë nuk i len, prandaj hajde të përqijemi të ngremë infermierinë.

— 4 —

Në mbrëmje Mensuri e Vjollca po rrinin në kuzhinë dhe po bisedonin. Mensuri shikonte barkun e fryrë të së shoqes dhe mendohej «Ç'do të jetë vallë? Vajzë apo djalë?»

— Përse mendohesh, Mensur? — e pyeti Vjollca të shoqin.

— E përse nuk po mendohem, Vjollca? Për të gjitha. Për beben e vogël, për ty.

Gruaja e re qeshi.

— Ti je si një fëmijë, Mensur!

Mensuri iu afrua së shoqes dhe i ndenji pranë. Njollat e barrës i dalloheshin tani më mirë në fytyrë, ca njolla ngjyrë kafe, të papërcaktuara, në faqe, në ballë.

— Je e shqetësuar, e dashur?

— Pak!

Mensuri e afroi pranë vetes dhe e puthi.

Vjollca qëndroi me kokën e mbështetur mbi gjoksin e të shoqit dhe e ndjeu veten më të qetë. Mbylli sytë. Qe e lumtur. Së shpejti do të lindte dhe në shtëpinë e tyre të re do të futej një qenie e vogël, fëmija e tyre e dashur. Çdo gjë tek ata qe e re: vetë ata, shtëpia, orenditë. Si do të qe fëmija e tyre e parë? Fëmija e Mensurit dhe e saj. Teshat e vogla i kishte përgatitur me kohë.

Çdo gjë qe gati. Vetëm foshnja pritej të vinte. Krevati i vogël rrinte pranë shtratit të tyre. Tani ai qe i zbrazur, por një ditë aty do të flinte bebja, me syçkat e mbyllura, me doçkat e mbledhura. Kujt do t'i ngjante vallë? Mensurit apo Vjollcës? Mbase të dyve.

— Je lodhur, Vjollca? Bën mirë të shtrihesh.

— Po ti?

— Unë do të studjoj edhe pak.

Pas një ore Vjollcën e kapën ca dhëmbje që s'i kishte ndjerë asnjëherë më parë. «Me siguri këto janë shenjat», mendoi gruaja e re me vete. Mensuri u shqetësua. Ai nuk dinte si ta ndihmonte. Herë hynte në dhomën e fjetjes, herë në kuzhinë.

— Vjollca, të të bëj një çaj të ngrohtë?

— Jo, Mensur.

— Si e ndjen veten?

— Kam pak dhëmbje — tha ajo dhe u mundua të buzëqeshte, por një dhëmbje e re ia shfytroi tiparet.

Mensuri qëndroi në mes të dhomës i hutuar. Ç'të bënte? Pse e humbi toruan kaq shpejt? Pastaj u kujtua se do të ishte më mirë të thërriste mjekun e repartit. Vërtet ai nuk qe gjinokolog, por diçka duhej të dinte. Ngriti receptorin dhe me gishtin tregues që i dridhej formuloi numrin telefonik të repartit.

— Jam komisari.

— Urdhëroni, shoku komisar, oficer Agroni ju dëgjon.

— Ç'kemi nga reparti, shoku Agron?

— Çdo gjë vazhdon sipas programit shoku komisar.

— Shumë mirë. Shoku Agron, do të të lutem të lajmërosh pak doktor Luanin.

— Doktorin ka dalë. Tha se do të shkonte në spital, në qytet. Po i dërgoj korrierin.

— Të falem nderit!

Luani erdhi pas një gjysmë ore. Sa e pa Vjollcën, çdo gjë u bë e qartë për të.

— Ku e keni telefonin, shoku komisar?

— Në korridor.

Luani mori menjëherë maternitetin.

— Kush jeni ju lutem?

— Mamia e rojes, Majlinda Nikolla.

— Jam mjeku i repartit. Kam një rast për lindje. Ju lutem e dërgoni autoambulancën në pallatin e oficerëve.

— Kush është ajo?

Luani nuk i erdhi mirë që mamia po e zgjaste bisedën në telefon. U mat menjëherë t'i fliste ashpër, por u përmbajt.

— Mos është e shoqja e komisarit, Vjollca?

— Po. Nga e dini ju?


— Në një pallat banoj dhe unë. Në hyrjen tjetër. E mora me mend që duhej të ishte Vjollca. Është në kohën e saj.

Zëri i mamisë u ndërpre. Luani mbylli receptorin dhe u kthye nga komisar.

— Tani vjen autoambulanca.

— 5 —

Mjeku Luan Rrapi atë pasdite do të mbante një bisedë me ushtarët dhe kuadrot me temën: «Higjiena personale dhe kolektive ndikojnë poziti-



visht mbi zhvillimin e stërvitjeve ushtarake». Njerëzit qenë mbledhur në sallën e kinemasë së repartit: I çuditshëm ky mjeku i ri. E përse do t'u fliste ushtarëve dhe oficerëve? Apo do t'u shpjegonte njerëzve mbi rëndësinë e larjes së duarve përpara ngrënies?

Nënoficer Paskal Nikolla i mbështjellë me kapotë u ndal në bufenë e repartit. Ai s'ishte fort në qejf. Kolla e ngacmonte dendur.

— Po ti? — e pyeti Metja. — Nuk je me pushim?

Nënoficer Paskali i ngriti supet me dyshim.

— Po a je i sëmurë?

— S'jam mirë vërtet.

— Nuk të dha pushim doktori?

— Më dha.

— Po ç'kërkon atëhere?

— Nuk ma aprovoi shefi.

— Ama të themi të drejtën ky doktori që ka ardhur në repart kërkon qiçra në hell. Me Dinen merresha vesh që ç'ke me të. Kurse këtij o tungjat-jeta, s'ia gjej dot gjuhën — tha Metja.

— Rri, se e kemi doktor të mirë.

— Mirëpo është i sertë.

— Po dhe fare të butë s'ke ç'e do, a derëzi.

— Një ditë më gjobiti me 20 lekë, sepse nuk e kisha bufenë në rregull. D'nashë e mora, por meazallah se ma fali. Ke parë ti të tillë kokëfortë?

— Do të vish në sallën e kinemasë? — e ftoi nënoficeri duke u çuar në këmbë. — Flet doktori.

— Me gjithë mend e ke?

— Po. Njeriu mirë është të dijë prej të gjithave.

— Më duket mendjemadh ai doktori.

— E ke gabim!

— Ndoshta ti e mbron, se të jep pushim. Nënoficeri Paskal Nikolla u zbardh në fytyrë dhe iu afrua banakut.

— Mete! Mbaj gojën të them.

— Ç'pate, o Paskal? Ti e di që unë bëj shaka, a derëzi — e ktheu Metja bisedën kur e pa që Paskali u prish në fytyrë.

— Pse, ç'më di ti mua? Ndonjë paloburrë?

— Më vjen keq...

Nënoficer Paskali pagoi kafënë i zemëruar dhe doli nga bufeja për të shkuar në sallën e kinemasë. Salla qe mbushur plot me ushtarë, me oficerë dhe punonjës civilë të repartit. Paskali u ul në një karrige. Kapotën nuk e hoqi, se kishte të ftohtë. Kolla e ngacmonte herë pas here, megjithëse mundahej të mbante me zor.

— Xha Paskal, qenke ftohur — i tha një ushtar i ofiçinës që rrinte dy karrige më tutje.

— Do më kalojë... — ia ktheu nënoficeri.

— Kot ke dalë. Më mirë të rrije në shtëpi në të ngrohtë e të pije pak çaj.

— Erdha të dëgjoj doktorin.

Sallën e mbuloi heshtja. Oficer Luani doli në podium, hapi disa fletë përpara dhe, pasi qëroi zërin, nisi të fliste. Zëri i tij në fillim qe i dobët, gjithë emocione, por pak e nga pak mjeku e zotëroi veten. Fjalët tani i delnin të qarta, të kuptueshme dhe menjëherë ai e ndjeu se po e zotëronte auditorin. Ushtarët e dëgjonin me vëmendje. Edhe kuadrot po ashtu. Në një karrige Luani dalloi nënoficer Paskal Nikollën që e dëgjonte me kujdes. Nënoficeri qe mbështjellë me kapotë, sikur aty brenda, në kinema, të binte e të frynte erë dhe shi

së bashku. Përse vallë nuk qe shëruar akoma? Ai i kishte dhënë pushim për tri ditë. Përse nuk qe paraqitur përsëri në ambulancën e repartit? Paskali kollitej dhe nga tingulli i kollës Luani e kuptoi se nënoficeri do të kishte marrë me siguri ndonjë të ftohtë. Në fund të mbledhjes Luani nxitoi ta takonte. E gjeti në të dalë të repartit, të mbështjellë me shall, tek kollitej me shaminë përpara gojës.

— Nënoficer Paskali! — i thirri mjeku nga pas.

Nënoficeri qëndroi në vend, e përsnëndeti ushtarakisht dhe i dha dorën vetëm atëhere, kur Luani i shtriu të tijën.

— Ju uroj shëndet!

— Shëndet paç! — ia ktheu mjeku. — Si dukeni tani? Sikur nuk po më dukeni mirë.

— Do të kalojë, shoku doktor.

— Unë ju dhashë pushim, shoku Paskal. Pa më thoni, përse nuk e keni respektuar?

Nënoficeri heshti. Ai nuk dinte ç'ti thoshte këtij djali të ri, të veshur me petk oficeri, që po i kërkonte llogari se pse nuk e kishte respektuar pushimin mjekësor. Megjithëse Luani po e kritikonte, nënoficerit i erdhi mirë që tani në repart kishte një njeri që kërkonte llogari edhe për ruajtjen e shëndetit.

— Shoku Paskal, ju duhet ta dini se shëndeti nuk është vetëm pronë personale. Ajo i takon në radhë të parë, do të thosha, kolektivit ushtarak të këtij reparti. Prandaj nuk duhet të silleni kështu.

Paskali dëgjonte dhe habitej me fjalët e mjekut. Ai kishte dëgjuar se po ky mjek ishte grindur me zëvendëskomandantin për punë të infermierisë.

Nëpër repart qarkullonin fjalë se komisari kishte mbajtur anën e Luanit dhe e kishte urdhëruar oficer Mihalim të fillonte sa më shpejt adaptimin e kuzhinës së vjetër për infermierinë dhe vërtet mbas disa ditësh përpara kuzhinës filluan të grumbullohen tulla, rërë, gëlqere. Mjeku qëndronte aty, me orë të tëra duke punuar dhe vetë bashkë me muratorët.

Kështu flitej nëpër repart për Luanin. Kurse ja, tani, e kishte ndaluar atë vetë dhe po i kërkonte llogari se pse nuk kishte respektuar pushimin.

— Me sa duket do të përfundosh në spital — i tha Luani me një ton qortues.

— A e di si është puna, shoku doktor? — Nën-officer Paskali u përtyp. — Unë iu paraqita shefit tim dhe i thashë se kam tri ditë pushim.

— Dhe ç'të tha shefi?

— Tha që ofiçina ka shumë punë tani. Prandaj nuk e aprovoi pushimin. Por do të ma japë një herë tjetër.

Luani heshti për disa çaste. Një muskul i faqes së majtë iu drodh.

— Ashtu?

Mjeku u nda nga nënoficeri dhe u drejtua për në zyrën e komandantit të njësisë. Ziente përbrenda. Ai nuk e merrte dot me mend se si mund të sillej një kuadër me vartësin në atë mënyrë. Ai do të delte në raport para komandantit të njësisë për sjelljen e pañijshme të shefit të ofiçinës. Ishte për t'u habitur se sa mirë e mbronte ky oficer teknikën që kishte reparti. Luanit i pëlqente këmbëngulja e tij. Por, kur vinte fjala për të

ruajtur shëndetin e atyre njerëzve që riparonin këtë teknikë, pse nuk tregohej po aq këmbëngulës?

— 6 —

Komisari Mensur Drini qëndroi për një kohë të gjatë në dhomën e pritjes së maternitetit. Sa herë zbriste nga shkallët sanitarja dhe delte në korridor, komisar i ngrihej më këmbë si me sustë. As ai vetë nuk donte të vepronte në atë mënyrë, por nuk e përmbante dot veten.

— Lindi gjë ime shoqe?

— Akoma

— Po kur do të lindë?

Sanitarja ngriti supet. E ku ta dinte ajo se kur do të lindte Vjollca? Këtë punë e dinte me mirë doktori ose ndihmësmjekja e re, Majlinda. Vetëm ata të dy hynin e delnin në dhomën e lindjes. Kurse ajo që sanitare sidoqë, shpesh bënte edhe punën e portieres. Komisar i shikoi orën e dorës.

Sa kishte që rrinte aty? Një orë, dy apo më shumë? I kujtohej vetëm se si erdhi Majlinda bashkë me dy sanitare, të cilat tërhoqën një karrocë me rrota të vogla. Ato e morën Vjollcën dhe pastaj u zhdukën prapa një dore ku shkruhej: «Dhoma e lindjes». Mensuri e kishte fiksuar vështrimin mbi atë derë dhe priste.

Priste që të delte dikush prej andej e t'i thoshte një fjalë. Vetëm një fjalë. «Lindi! T'ju rrojë!»

Por nga ajo derë nuk po delte asnjëri. Komisar i vuri re se në njërin nga stolat rrinte një burrë. Ai

kishte mbështetur mjekrën mbi dorën e djathtë dhe mendohej. Mensuri iu afrua.

— Po ju kë prisni?

— Kam gruan për të lindur.

— Kur e sollët?

— Në orën katër.

— Ende s'ka...

Ende!

Përtej asaj dere disa gra kalonin çaste të vështira. Midis tyre që dhe Vjollca, shoqja e tij, që ai e donte aq shumë. Ajo luftonte për të nxjerrë në dritë një krijesë të re, frutin e dashurisë së tyre. Luftonte dhe vuante.

Vjollca po vuante, ndërsa ai nuk kishte asnjë mundësi për ta ndihmuar.

— Fëmija e parë është? — e pyeti Mensuri burrin që priste sa për të thënë diçka.

— Jo, i dyti.

Në atë çast dera e dhomës së lindjes u hap dhe që andej doli një vajzë e re, e freskët, veshur me të bardha. Një kapuç borë i bardhë ia mbështilte të gjithë flokët. E vetmja gjë që lëvizte në atë fytyrë prej vajze të re qenë sytë e saj bojë qielli. Mensuri e njohu: «Është vajza e nënoficer Pas-kalit», tha me vete dhe zemra i rrahu fort.

— Shoku komisar! — iu drejtua Majlinda oficerit. — Vjollca lindi djalë.

— Vërtet?

Ai s'po u besonte veshëve. Ishte krejtësisht i hutuar.

— T'ju rrojë, shoku komisar!

— Ju falem nderit. Si është Vjollca?

— Është fare mirë. Mos u bëni merak.

Burri që rrinte mbi stol u çua.

- Po ime shoqe nuk ka lindur ende?
— Mos u mërzitni. Edhe ajo së shpejti do të lindë.

— 7 —

Mjeku Luan Rrapi mbaroi vizitat në ambulancë. Dinja po bënte disa mjekime. Ajo dhomë që aq e ngushtë, sa Luanit tani i dukej sikur nuk kishte më vend as për t'u rrotulluar e jo më për të punuar. Vetëm një dhomë, aty vizitoheshin ushtarët, aty mjekoheshin, aty ruheshin dhe barnat.

E megjithatë duhej punuar. Mjeku arriti t'i pajiste të gjithë ushtarët me libreta shëndetësore, u bëri kontrollin radioskopik, mori masa për vaksinimin e trupës dhe çdo gjë e dokumentoi. Punët me sa duket po shkonin mirë, por Luani nuk kënaqej. Banjat e nënreparteve nuk ishin të gjitha në rregull; një pjesë e tyre që vjetëruar, ndonjëra kishte difekt. Në shtabin e prapavijës shpesh problemet zvarriteshin. Mihali, zëvendëskomandanti për prapavijën, pak interes tregonte për çështjet shëndetësore. Atë e kritikonin vazhdimisht në mbledhje. Ai bënte autokritikë, premonte se do të punonte më mirë, por punët prapë zvarriteshin. Luani kishte krijuar përshtypjen se hallkat e prapavijës nuk punonin në rregull. Ato i ngjisnin një orkestre të përbërë nga vegla të ndryshme, por që dirigjenti nuk që në gjendje t'i drejtonte në mënyrë të tillë, që prej tyre të dëgjohej vetëm një melodi.

Këto gjëra po bluante në kokë Luani në çastin që mbaroi vizitat në ambulancë. Ai e ndjeu

veten pak të lodhur. Do të deshte të bënte një shëtitje të vogël në ajër të pastër. Po pastaj ku do të shkonte? Mund të lexonte tekstin e patologjisë, por atë çast nuk kishte dëshirë. Po sikur të shkonte te komisar Mensuri e ta uronte për lindjen e djalit?

Ndërsa po mendohej, ushtar Agron Haliti hyri në ambulancë.

— Shoku doktor, — foli ushtari duke e përshëndetur — më dërgoi oficeri i rojes t'ju thërres se nënoficer Paskal Nikolla është shumë i sëmurë.

— Ku është?

— Në shtëpi.

— Unë nuk ia di shtëpinë.

— E di unë, shoku Luan, — ndërhyri Dinja — shkojmë bashkë.

Ushtar Agroni u largua. Luani e Dinja dolën nga reparti dhe u drejtuan për në qytet. Shtëpia e nënoficer Paskalit që vendosur në katin e parë të një pallati të madh, ku banonin familjet e kua-drove të repartit. Derën ua hapi një vajzë e re, e krehur me kujdes dhe me dy sy ngjyrë qielli.

— Mirë mbrëma! — e përshëndeti Luani.

— Mirë se ardhët! Urdhëroni!

Të dy ushtarët u futën brenda.

— Urdhëroni në dhomën tjetër — u tha Maj-linda.

— Ku është babai?

— Në kuzhinë.

— Atje do të hyjmë edhe ne.

Sapo hyri, mjeku vuni re se nënoficer Paskali nuk ishte mirë. «Me sa duket do t'i jetë bërë ndonjë «komplikacion», mendoi. I bëri një vizitë të imtë duke i kontrolluar me kujdes çdo organ. Te

musnkëritë u ndal më shumë. Në bazën e djathtë të gjoksit dëgjoi një zhurmë jo të zakonshme. Goditja me gisht e atij vendi jepte një tingull të mbytur. Majlinda u shqetësua. Ajo e vështroi Luani në sy dhe e kuptoi nga lëvizjet se babai i saj diçka do të kishte.

Luani ngriti kokën, vështroi Majlindën dhe foli me siguri:

— Pneumoni në bazën e djathtë.

— E ç'është kjo, o doktor? — pyeti nënoficeri si me të qeshur.

— Je ftohur, shoku Paskal — i tha Luani me një ton të butë.

— Pse s'thua që më paska ardhur fundi! — bëri përsëri shaka nënoficer Paskali, me buzët e thara dhe frymëmarrjen pak të rëndë.

— Ç'duhet të bëjmë tani, doktor? — e pyeti mjekun Majlinda, e shqetësuar.

— Jam i mendimit që ta shtrojmë në spital.

— Nuk ia bëjmë dot mjekimet këtu? Gjilpërat ia bëj vetë.

Luani tundi kokën.

— Dëgjomëni mua, është më mirë në spital.

Ajo ia nguli sytë mjekut me vëmëndje.

— Mirë, doktor, do të bëjmë si është më mirë.

Ndërsa mjeku po pinte kafënë që u bëni Majlinda, mendja i fluturoi tek ofiçina e reparitit. Njëra anë e ofiçinës nuk qe mbyllur me xhama. Atje frynte një erë e ftohtë që të thante e të grinte. Ja, atje qe ftohur edhe nënoficer Paskali. Kaq herë Luani i qe drejtuar shefit të ofiçinës që të merrte masa sa më shpejt e të vinte xhamat. Një ushtar mekanik, që punonte në atë vend, mori një pleurit përpara një muaji. Paskali

qe i dyti. Kush do ta kishte radhën pas tij? Prej disa ditësh punonte një artikull për gazetën «Luftëtari». Atje ai kishte shkruar se masat profilaktike janë masat më të sigurta për të mbrojtur shëndetin e luftëtarëve. Dhe si shembull negativ sillte kujdesin e pakët që tregonte shefi i ofiçinës për tu vënë xhama dritareve të lokalit ku punonin ushtarët dhe nënoficer Paskali. Ai kuadër duhej të kritikohet që të vinte mend. Kishte biseduar kaq herë me të në mënyrë s'noqërore, por ai as që donte t'ia dinte. «Folë o doktor, folë, se kështu ti justifikon rrogën që merr», i thoshte ai me ironi.

Këto gjëra bluante me vete Luani, ndërsa plotësonte fletështrimin e nënoficer Paskalit. «Jo, nuk do të vazhdojë më kështu», mendoi ai.

— 8 —

Ndërtesa e kuzhinës së vjetër të repartit qe transformuar në një infermieri të bukur, të ndarë me disa dhoma me dritare të gjera e plot dritë. Luani ato ditë qe lodhur sa kurrë ndonjëherë. Atë e ndihmonte Dinja, infermieri i vjetër i repartit, me ecjen e tij të ngadalshme dhe cigaren gjithmonë në cep të buzëve. Dinja fliste pak, por punonte shumë. Shumë teori nuk dinte, por çështjet praktike të shëndetësisë ushtarake i lozte në majë të gishtërinjve. Nuk e vriste shumë mendjen për të spjeguar anën teorike të problemit. Atij i interesonte zgjidhja. Po të zgjidhej çështja, ai e quante detyrën të bërë. E ç'i duheshin llafet e tepërta. Ja, kështu punonte Dinja, Luani muajt e parë u mbështet shumë në eksperiencën e tij të

madhe, «Dinja i ngjan një thesi të mbushur plot me dije, por me dije të painventarizuara!» bënte shaka doktori.

Luanit i erdhi mirë që gjeti në repart një shok të vjetër me eksperiencë. Ai erdhi nga auditorët e fakultetit me njohuri të gjera shkencore. Por i mungonte eksperiencia e jetës së repartit. Dhe pikërisht këtë gjë që i mungonte atij, Luani e gjeti te Dinja. «Ne të dy plotësojmë njëri-tjetrin», i thoshte mjeku komisarit të njësisë kur vinte fjala për infermierin.

Atë javë ata të dy kishin punuar me orar e pa orar. Luani kishte premtuar që më 10 Korrik infermiera të ishte gati, për punë. A do t'ia arrinte dot të mbante fjalën që kishte marrë përpara shtabit të prapavijës? Infermiera kishte nevojë për dollape, perde, bojë vaji për dyert dhe dritaret, abazhure, tryeza, krevate tek të një madhësie, batanie të reja të një ngjyre. E për çfarë nuk kishte nevojë infermiera.

Ato ditë Luani nuk kishte vetëm këto shqetësime. Natën, kur flinte, ose ditën, kur punonte, atë e shqetësonte dhe diçka tjetër, fytyra e Majlindës. Vajza e nënoficer Paskalit ishte futur në botën e tij të brendshme dhe nuk e linte të qetë. Atë mbrëmje, kur ai shkoi në shtëpinë e saj, për të vizituar Paskalin, Majlinda i la mjekut të ri mbresa të forta. Tani ai shpesh humbte në mendime.

— Shoku doktor... — i thoshte Dinja.

— The gjë, Dine?

— Dollapin e barnave ku do ta vendosim?

— Dollapin? A, po. Ku thua ti, Dine?

— Po ja, këtu.

— Mirë e ke. Hajt ta vëmë...

Dinja buzëqeshte. Ç'kishte mjeku që e humbte ashtu? Mos e kishte nga lodhja? «Epo djalë i ri është, mendonte infermieri me cigaren në cep të buzëve. Dikur kështu e humbja edhe unë kur u njoha me Lulen...»

Luani e shikonte shokun e tij të punës me bisht të syrit. «Mos vallë Dinja kupton gjë nga shqetësimet e mia? Po fundja ç'të keqe ka edhe në qoftë se e kupton?»

Po sikur t'ia thoshte Dines ato që ndjente për Majlindën? Ai qe burrë i pjekur dhe ndoshta do ta ndihmonte me mendimet dhe përvojën e tij. Çdo mbrëmje vendoste që, me të ardhur Dinja në mëngjez, t'ia hapte zemrën. Por, sapo zbardhte dita, ky vendim tretej menjëherë dhe Luani mbyllej në vetëvete. Ai i futej punës me ngulm si e si ta harronte atë brengë. Ishte një brengë e çuditshme. Një brengë që e bënte të vuante, por njëkohësisht i jepte dhe gëzim. Ai ëndërronte sikur ishte me Majlindën, sikur bisedonte me të, sikur delte shëtitje në periferi të qytetit. «Ç'u bëra dhe unë kështu, si ata romantikët qesharakë?» thoshte me vete.

Luani nuk harronte dot përshtypjet e një dite kur kishte shkuar në maternitet bashkë me komisarin për të takuar Vjollcën. Ndërsa komisar i bisedonte me të shoqen, Luani qe takuar me Majlindën në korridor.

— Shoku doktor, ju falemnderit shumë për interesin që treguat për babanë i kishte thënë vajza duke e parë në sy me vështrimin e saj të ëmbël e të butë.

Sa e hijshme që dukej ajo e veshur krejt me të bardha. Fytyra dhe sytë i shkëlqenin. Atje Majlin-

dën e kishte pasur fare pranë, aq pranë, sa i dëgjonte edhe frymëmarrjen.

— Unë bëra detyrën, Majlinda.

Vajza kishte buzëqeshur. Dy gropa të lehta i qenë bërë në faqe.

— Si është babai tani?

— Shumë mirë. Ju mban gjithnjë në gojë.

— Për të mirë apo për të keq? — bëri shaka Luani.

— Vetëm për të mirë!

Zëri i vajzës dridhej. Fytyrën e Luanit e përshkoi një avull i nxehtë. «Tani duhet të jem skuqur, kishte thënë mjeku me vete. Dreq, o punë.» Kur qenë ndarë, ajo i kishte thënë:

— Pse s'na keni ardhur ndonjë ditë? Babait do t'i bëhej shumë qejfi.

— Do të vij të shtunën.

— Mirë se të vini!

— I bëni të fala babait!

Luani mezi po e priste atë ditë. Tërë javën u mor me telashet e infermierisë. Infermiera u bë aq e mirë, sa i kaloi dhe parashikimet e tij. Edhe komisari vinte shpesh, qëndronte një copë herë, jepte ndonjë mendim, pastaj largohej i kënaqur.

Mihali, zëvendëskomandanti për prapavijën, qe treguar i gatshëm për çdo gjë. Ai kishte sjellë marangozin, bojaxhinë, muratorët. Çdo gjë kishte shkruar për bukuri. Dhe me të vërtetë, askush nuk e besonte se dikur aty, në atë infermieri të bukur, kuzhinierët e repartit pregatishnin gjellën. Mjeku dhe Dinja qenë të gëzuar. Luani sa nuk fluturonte. Gatishmëria që treguan njerëzit e në radhë të parë komisari e komandanti për ndërtimin e infermierisë e preku mjaft mjekun. Edhe Mihali tani ki-

shte ndryshuar. Ai qe një shok i mirë, punëtor i madh, sa harronte edhe veten në punë. Me Luani sillej mirë. E përse do t'i mbante mëri.

Të shtunën mbasdite Luani ishte i emocionuar. Ai u la mirë e mirë u rrua dhe ashtu siç qe qëndroi përpara pasqyrës. Dukej një djalë i ri, me një ballë të gjerë dhe me dy vetulla në formën e harkut përmbi sy. Buzëqeshi. Oficeri mbeti i kënaqur. Para se të largohej, i tha sanitarit:

— Ushtar Genci, po të më kërkoni për ndonjë urgjencë, ndodhëm në shtëpinë e oficer Paskalit.

— Si urdhëroni, shoku shef!

Në shtëpinë e Paskalit derën ia hapi Majlinda. Vajza kishte veshur një fund ngjyrë gri dhe një bluzë të bukur. Majlinda e priti e buzëqeshur; «Sa e mirë qenka bërë! tha me vete Luani. Ja dhe gropëzat në të dyja faqet».

Paskalit iu bë qejfi shumë që Luani erdhi për ta parë. Bile kishte ardhur pa e thirrur. Ky njeri do të bëhej i dashtur për ushtarët dhe oficerët. Paskalit i pëlqente thjeshtësia e tij.

Oficer Luani tani dëshironte me gjithë shpirt të ndodhej pranë Majlindës. Befas iu ndez në zemër një mall i çuditshëm për të. Çfarë po ngjiste në thellësi të tij? Majlinda hynte e dilte në kuzhinë, e bukur, e lehtë. Ai e vështronte dhe nuk kishte të ngopur.

Luani po e dashuronte atë vajzë. Ai kish snumë gjëra për t'i thënë. Por ku t'ia thoshte? Aty përpara babait të saj? A do ta pranonte Majlinda dashurinë e tij? Ndoshta ajo donte ndonjë tjetër...

«Pse mbeta kështu i heshtur? Duhet të them diçka...»

— Si jeni tani, shoku Paskal? — e pyeti Luani nënoficerin.

— Si topi. Nuk ndjej asgjë.

— Më bëhet qejfi.

— Po ju si i keni punët?

— Jo keq. Këto ditë përfunduar infirmierinë e re të repartit. Ka dalë e thjeshtë, por e bukur.

— Ju lumtë!

Majlinda hyri në kuzhinë me një tabaka në dorë. Qëndroi përpara Luanit me shtatin e saj të drejtë, me flokët e gjatë që i arrinin deri në supe.

Luani mori gotën me konjak.

— Të shkuara, shoku Paskal.

— Të falem nderit, shoku doktor!

— Gëzuar, Majlinda.

— Mirë se ardhët!

— 10 —

Në shtëpinë e Mensur Dritit qetësia ishte prishur. Dritani qante. Atëhere shqetësoheshin që të gjithë.

— Pse qan Dritani? Mos ka ndonjë gjë? Mos është i sëmurë?

Dritani flinte në krevatin e tij të vogël. Flinte me buzkat gjysmë të hapura e me duart e mbledhura pranë fytyrës.

— Ky djali ynë si shumë fle, moj Vjollca.

— Fëmijët gjumi i rrit, Mensur.

— I ke dhënë të pijë?

Vjollca qeshte.

— Po si thua ti, nuk i kam dhënë?

— Nuk desha të thosha atë. Por ke parë, ndonjëherë më duket se mund të harrosh...

Burra e grua qeshnin me fjalët e njëri-tjetrit.

Çasti më i bukur ishte mbrëmja, kur lahej Dritani. Ata vështronin trupin e brishtë të fëmijës, të shkumëzuar me sapun dhe trembeshin se mos e vrisnin me duart e tyre. Por kjo pasiguri që vetëm për një çast. Dritani fillonte të lëvizte duar e këmbë.

— Shiko, Vjollca, shiko si i lot këmbët.

— Duket sikur bën not.

— Qerratuci!

Fëmija hapte sytë dhe shikonte herë Vjollcën, herë Mensurin.

— A thua se na njeh? — pyeste Mensuri i drojtur.

— Është akoma s'numë i vogël.

Komisar Mensuri kishte mjaft punë në repart. Çdo gjë duhej të kalonte nëpër duart e tij e të komandantit. Punët kërkonin zgjidhje, operativitet.

Një ditë u kthye vonë në shtëpi.

— Çfarë bën djali? — e pyeti të shoqen sapo u fut në kuzhinë.

— Fle!

— Ta shoh pak?

— Edhe ti, Mensur, si bëhesh, tamam si fëmijë.

— Më mori malli.

— Do ta zgjosh nga gjumi.

Mensuri i hoqi këpucët dhe me majë të gishtërinjve iu afrua shtrimit të Dritanit. Parketi kërci-ti nën peshën e këmbëve të tij. «Dreqi e mori» mermëriti. Dritani lëvizi kokën. Futi gishtin e

madh në gojë dhe nisi ta thithte me sytë e mbyllur.

— Kolopuçi i babit! — mërmëriti.

Pas tij hyri Vjollca.

— Do t'i jap të pijë — i tha ajo.

Mensuri shkoi në kuzhinë dhe u shtri në divanin e ri që kishte blerë atë ditë. Lodhjen që ndjente më parë sikur ia kish hequr njeri me dorë. E çuditshme! Rrinte shtrirë në divan dhe e ndjente veten të lumtur. Përfytyronte Dritanin tek thithte me ëndje qumështin nga gjiri i Vjollcës.

Vjollca doli nga dhoma e gjumit dhe mbylli derën me kujdes.

— Fjeti?

— Po.

— Piu?

— Është një llupës i madh, që s'e ka shokun.

Ata qeshën të dy.

— A e di, Mensur?

— Çfarë?

— Sot në drekë Dritani qeshi.

— Kaq i vogël dhe qesh?

— Për kokën tënde!

— Si është e mundur?..

— As unë s'e di. Por e shihja që qeshte me veten e tij.

Mensuri habitej. Habitej edhe Vjollca. Fëmija e tyre e dashur kishte filluar të qeshte. Komisarri vështrroi Vjollcën. Ajo ishte e gëzuar.

Atë çast ra zilja e telefonit. Mensuri u çua dhe mori receptorin në dorë.

— Kush jeni?

Oficeri i rojes. — Si urdhëroni! — Shoku komisar, alarm!

- Kush e jep?
- Komand eprore.
- Erdha.

Mensuri u vesh me nxitim. Para se të dilte, ai hyri edhe një herë në dhomën e fjetjes, iu afrua krevatit të Dritanit dhe e vështroi. Vjollca i vështroi të dy dhe buzëqeshi.

Pastaj zbriti me të shpejtë shkallët e shtëpisë dhe humbi në errësirën e natës.

— 11 —

Me t'u dhënë alarmi, Luani u paraqit në vendin e tij. Pas pak erdhi Dinja duke nxituar, me cigaren e ndezur në cepin e buzëve. Në dorë ai mbante çantën e ndihmës së shpejtë. Fill pas tyre filluan të vinin ushtarët. Ata merrnin teshat dhe visheshin me nxitim.

— Do të hapet vendmjekimi, shoku shef? — pyeti Dinja.

— Po, do të hapet.

Dinja e dinte se ç'donte të thoshte hapje vendmjekimi. Ai ishte komandanti i repartit shëndetësor dhe duhej të merrte të gjitha masat. Kalonte sa te një repart te tjetri, i nxiste njerëzit të visheshin sa më shpejt. Kur u bind se ushtarët e kuadrot qenë gati, doli në mes të fushës dhe dha komandën:

— Reparti, sipas togave për tre rreshtohu!

Njerëzit u vunë në lëvizje. Ata sikur u elektrizuan nga ajo komandë e dhënë prerë me ton ushtarak. Secili vraponte për në vendin e vet pas ko-

mandimit të togës. Pastaj Dinja me hap rreshtor iu drejtua oficer Luanit.

— Shoku shef, reparti ndodhet i rreshtuar sipas urdhërit tuaj.

Luani e dinte se në togën e kirurgjisë ndodhej edhe Majlinda. Ajo ishte me sytë e skuqur nga pagjumësia, pasi alarmi e kishte zënë në maternitet, ku kishte shkuar për të ndihmuar mjekun që po operonte një grua.

Reparti u nis për marshim në mes të errësirës.

— Të fiken fenerët kundra erës — urdhëroi Dinja komandantët e togave.

Urdhëri u përsërit. Fenerët u shojtën. Njerëzit ecnin në errësirë, me pushkët në krahë. Në krye të kolonës marshonte Luani me Dinen. Nata që e errët pus. Re të dendura vijnin nga perëndimi, të ngarkuara me shi. Majlinda marshonte në rresht me kundërgazin, çantën e shpinës dhe armën të ngjeshur pas trupit. Kur shkrepëtinte dhe rruga ndriçohej për disa sekonda nga drita verbuese, vetëm atëhere ajo dallonte siluetën e Luanit në krye të kolonës. Reparti marshonte buzë arrave të mbjella, rrëzë vreshtave të fermave. Ushtarët dhe oficerët në fillim marshonin lehtë, por pak e nga pak pesha e armëve dhe e pajimeve sikur nisi t'u rëndonte. Në këmbët e tyre qenë krijuar filluska dhe plagë të shkaktuara nga këpucët nga lidhja e parregullt e peceve.

— Kemi dhe shumë për të marshuar? — pyeti dikush në errësirë?

— Ej, vëllaçko! Mos u mërzhit! Ky është fillimi.

— U lodhe?

— Ca!

— Ma jep mua pushkën sa të çlodhesh.

— Kur do të bëhet pushimi?

— S'është dhënë urdhëri.

Njerëzit eonin të lodhur. Majlinda dëgjonte frymëmarrjen e tyre dihatëse e të thellë. Edhe ajo mezi çapitej. Por sidomos e mundonte etja. Togat kalonin pranë burimeve me ujë të pastër, por asnjëra nuk ndalej. «Një pikë ujë! Një pikë ujë. Vetëm sa të lag pak buzët», mendonte Majlinda.

— Kolona, ndal! — u dëgjua zëri i fortë i oficer Dines.

Komandantët e togave përsëritën urdhërin. Togat qëndruan në vend. Njerëzit u ulën buzë xhadesë, hapën çantat dhe filluan të hanë.

Dikush thirri.

— Shokë, qenka një burim këtu!

Sa të çelësh e të mbyllësh sytë, ushtarët u sulën për te burimi me paguret ndër duar.

— Mos pini ujë, se jeni të dërsirë. Do të ftoheni.

— Mirë e ka!

— Partizanëve u ka takuar të marshojnë, të luftojnë e prapë të marshojnë pa vënë një pikë ujë në gojë.

Luani dëgjonte bisedat e ushtarëve. Ai tani ndodhej në mes të togës së kirurgjisë. Po Majlinda ku ishte? Pse s'ia dëgjonte zërin asaj? Mos kishte mbetur pas? Dikush i tha se kishte shkuar në burim për të mbushur pagurin me ujë.

— Ku është burimi?

— Ja, atje?

Luani zbriti poshtë, gjatë rrugicës, me ndihmën e elektrikut të dorës. Pranë një peme dalloj disa

ushtarë. «Ata duhet të jenë», mendoi mjeku. E gjeti Majlindën tek lante duart në çesmë pranë shoqeve.

— Majlinda!

Drita elektrike ra mbi sytë e vajzës. Ajo mbylli sytë dhe vuri dorën përpara.

— Urdhëroni, shoku doktor!

Majlinda ndjeu se zemra pa i rrihte shpejt. Luani qe atje, pranë saj, disa hapa larg, me llambën elektrike të ndezur. Përse e thirri? Mos kishte bërë gabim që qe larguar nga toga? Luani nuk diti ç'të thoshte dhe, për të mos mbetur keq, iu drejtua shoqeve.

— Si jeni, vajza?

— Mirë!

Mjeku u largua prej andej duke i këshilluar ushtarët që të çlodheshin, sepse pas marshimit i priste një punë edhe më e madhe.

Marshimi filloi përsëri. Kolona pas dy orësh arriti në vendin e caktuar. Me të mbërritur, ushtarët nisën nga puna.

— Ndal! — u dëgjua zëri i rojes.

— Kush është? — tha dikush.

— Djema, vështroi punën. Atë e di përgjegjësi i ndresës.

Tre fshatarë të armatosur u futën në çadrën e komandës. Ata i priti Luani bashkë me Dinen.

— Mirë se ardhët në fshatin tonë! — u tha ai që ishte në mes.

— Mirë se ju gjetëm! — ua ktheu Luani. — Urdhëroni!

— Nuk kemi kohë të rrimë. Ne jemi efektivë të çetës vullnetare. Kemi urdhër t'ju ndihmojmë për çdo gjë.

Njeriu me pushkë, që rrinte në mes, foli përsëri.

— Forcat tona kanë zënë pozicionet këtu pranë. Na thoni çfarë punë do të bëjmë.

Ushtarë dhe vullnetarë punuan së bashku si një trup i vetëm. Çadrat u ngritën me shpejtësi. Mjekët dhe infermierët ngarkuan aparaturat; tensioni më i madh i punës që në sallën e operacionit. Kirurgu jepte e merrte me njerëzit. Majlinda e Yllka një infermiere shkuan të merrnin aparaturën e narkozës. Ndërkohë nisi të binte shi. Nga larg dëgjoheshin bubullima. Qielli i nxirë çirrej herë pas here nga drita verbuese dredha-dredha. Majlinda mbante mbi supe kasetën e narkozës, ndërsa shoqja e saj, Yllka, mezi çapitej nën peshën e arkës me instrumenta operacioni. Këmbët u zhyteshin në baltë. Ato nxitonin që të arrinin sa më shpejt çadrën e madhe ku i priste komandanti i togës së kirurgjisë. Por shiu dhe balta i pengonin.

— Po kanalin si do ta kapërcejmë, Majlinda?

— Do të përpiqemi.

Kanali shtrihej para këmbëve të tyre i gjatë dhe i gjërë si një transhe.

— Mos ka ndonjë urë këtu pranë?

— Nuk shoh asnjë urë.

— Atëhere duhet të kapërcejmë, — tha Majlinda — shokët na presin.

— Një, dy, tri...

E para u hodh Majlinda me kasetën e aparaturës së narkozës në duar. Por vajza nuk e mbajti dot ekuilibrin dhe ra në kanal.

— Ç'pate, moj?

— Më shkau këmba. Yllkë, merr shpejt aparaturën, se mos laget!

— Po ti u bëre qull, Majlinda!

— Merr aparaturën!

Atë çast dy pjesëtarë të çetës vullnetare iu afruan vajzave dhe i ndihmuan të kapërcenin pengesën.

— Ju falemi nderit, shokë!

Në të gdhirë erdhi në spital komisar Mensuri, i cili i kishte sytë të skuqur nga pagjumësia.

— Sa është pjesëmarrja? — pyeti mjekun.

— Qind për qind, shoku komisar.

— Përfundoi hapja?

— Si urdhëron!

— Shkojmë ta shohim.

Së bashku me komisarin dolën nga çadra e komandës. Nata që thyer dhe tani të dy oficerët dallonin konturet e maleve, shtëpitë e fshatit dhe pyllin aty pranë. Luani e njihte mirë komisarin. Ai e dinte se Mensuri nuk kënaqej lehtë dhe kërkonte llogari një për një. Ai njeri nuk e duronte dot punën e sipërfaqshme.

— Doktor a mund të operohet këtu?

— Mundet, shoku komisar.

Në repartin e kirurgjisë Mensuri mbeti i kënaqur. Ai bëri shaka me oficerët dhe ushtarët.

— Këtu qenka dhe Majlinda. Shumë mirë. Çfarë detyre ke në sallën e operacionit?

— Narkotizatore!

— Si u bë babai tani? — pyeti përsëri.

— Mirë është, shoku komisar.

— Gëzohem!

— Dritani si është?

— Oh! Fare mirë.

Majlinda qeshi. Qeshën dhe Mensuri e Luani.

— 12 —

Fytyrën e ushtar Agron Halitit mjeku e mban-te mend fare mirë. Ai kishte ardhur një mbrëmje në ambulancën e vjetër, në çastin kur kishte mbaruar vizitat. Ai e kish lajmëruar se nënoficer Paskali qe sëmurë dhe kish nevojë për t'u vizituar.

Tani Agroni ndodhej i shtruar në infermierinë e re në dhomën e të sëmurëve, me dorën e djathtë të lidhur me fashio. Ushtari qe plagosur fare pak gjatë pastrimit të armës. Ajo nuk qe plagë në tërë kuptimin e fjalës, por më tepër një gërvishje. I doli ca gjak, por Agroni nuk u shqetësua. Dhe as u paraqit në infermieri për t'u mjekuar tek oficer Dinja. «Për një plagë të vogël të vete në infermieri!» kishte menduar.

Në fshatin e Agronit veprohej ndryshe. Në raste të tilla disa fshatarë merrnin bajgë të përzier me dhe e vendosnin mbi plagë. Asnjeri nuk e dinte se kush e kishte këshilluar këtë lloj mjekimi. shumë veta në fshat nuk e besonin. E megjithatë për forcë zakoni ndonjë dhe e bënte. Pas dy ditësh Agroni ndjeu dhembje në vendin e plagës, ndërsa në darkë plaga filloi t'i rrihte. Atë natë ushtari nuk fjeti mirë. Dora iu skuq dhe ai mundojë ta vinte sa më pak në punë.

— Pse nuk shkon të mjekohesh? — i kishte thënë komandanti i kompanisë.

— E mora si me shaka...

— Ec te doktor Luani, ai të viziton me kujdes.
Dhe kështu në orarin e vizitës ushtar Agroni u paraqit në infermieri. Mjeku, sapo e pa, u shqetësua.

— Sa ditë ke ti, ushtar Agroni, me këtë dorë?

— Nja tri ditë, shoku doktor.

— Po a nuk ke turp? Ta kesh infermierinë kaq afër dhe të mos vish të vizitohesh?

— Nuk i vura rëndësi. Thashë se do të më kalonte si përherë...

Luanit nuk i erdhi mirë. Ai e pa plagën me kujdes. I kontrolloi gjëndrat nën sqetull dhe vuri re se ushtari ndjeu dhembje. «Kjo do të thotë se infeksioni ka filluar të ngjitet sipër dhe të invadojë organizmin», mendoi mjeku.

— Më jepni ndonjë mjekim dhe keni për të parë se do të më kalojë. Unë e kam misërin të mirë. Luani tundi kokën.

— Jo, ti do të shtrohesh në infermieri.

— Për një gjë kaq të vogël?

— Po, për një gjë kaq të vogël — e përqeshi mjeku duke i rënë krahëve. — Lajmëro komandantin dhe eja të fillojmë mjekimin.

Tani ushtari po bënte disa ditë të shtruar. Luani e kontrollonte përditë dhe vinte re se si plaga po merrte pamjen e një infeksioni.

— Si dukesh? — e pyeti mjeku.

— Diçka më mirë, doktor. E shoh se gjilpërat po më bëjnë efekt.

Mjeku bënte shënimet e duhura në kartelën e të sëmurit. Rrinte në këmbë përpara Agronit dhe diçka nuk i pëlqente tek ai ushtar. Çfarë nuk i pëlqente vallë? Ardhja me vonesë në vizitë? Apo më-

nyra e zbetë sado e lehtë që paraqiste fytyra e Agronit ato ditë? Luani e dinte se ka çaste në mjekësi që, megjithëse mjeku e bën mjekimin e sëmundjes në rregull, prapëseprapë ai nuk është i qetë. Kjo gjë po ndodhte edhe te Luani. «Kot bëhem merak edhe unë. Plaga po vete mirë, enjtja dhe skuqja po shkojnë drejt zhdukjes. Atëhere pse bëhem merak?»

Luani e kishte në natyrën e tij shqetësimin. Këtë merak dhe këtë shqetësim ia njihnin të gjithë: komisari, Mihali, Dinja, ushtarët, Paskali dhe deri shefi i oficinës. Mjeku delte shpesh nëpër reparte, takonte oficerët, ushtarët dhe, po të vinte re diçka të dyshimtë të ndonjëri, e merrte me vete në infirmieri, e shtronte, e mjekonte, pastaj e nxirrte në repart.

Një mëngjez mjeku mezi e fshehu shqetësimin përpara Agronit.

— Shoku doktor, se pse kam vështirësi në përcjellje.

— Si?!

— Mezi përcillem.

Luani mendoi se mos Agroni që ftohur. I kontrolli fytyrën. Po për çudi nuk pa asgjë patologjike. «Si shpjegohet pengesa që ka në fytyrë ushtari?» pyeti veten. Në darkë ai erdhi përsëri te shtrati i Agronit.

— Agron, si je tani?

— Nuk jam mirë.

— Po çfarë ndjen?

— Mezi hap gojën...

Edhe ndonjë top të ishte shkrehur aty pranë

papritur e pakujtuar ndoshta nuk do ta kishte trembur aq shumë mjekun. Atij iu drodh zemra sikur t'ja kishte shtrënguar njeri me dorë.

— Me se e ke mjekuar ti plagën — e pyeti Luani ushtarin.

— Me se e kam mjekuar?... — Ushtarit nuk i kujtohej.

Ai e vështronte mjekun me një farë habie. Nuk i kujtohej asgjë. I gjithë shqetësimi i tij qe përqëndruar tani në nofull. Pse Agroni nuk e hapte dot gojën plotësisht? Ç'lidhje kishte goja me plagën e dorës? Plaga pothuajse ishte e shëruar.

Mjeku i dha ushtarit një gotë me ujë.

Agroni u mundua ta pinte, por mezi e përcolli. Sa herë që gëlltitej, shtrembëronte fytyrën nga dhembja. Mjeku doli nga infermiera pa thënë asgjë. Një rast i këtillë nuk i kishte ndodhur më parë. E megjithatë Luani dyshoi. Por dyshimi mbante emrin e një sëmundjeje, të cilën mjeku nuk donte të përmendte. Ndoshta qe nxituar. Ndoshta nuk kishte qëlluar në shenjë në gjetjen e sëmundjes. Ah, sikur të mos ishte e vërtetë! Luani do të donte më mirë të gabonte njëmijë herë, se sa të dilte ajo gjë, për të cilën mendonte. Të lajmëronte më lart për këtë punë? Apo të përcaktonte më parë diagnozën dhe pastaj të vepronte?

Këmbët e shpunë te parku i makinave. Thirri shoferin e ambulancës dhe së bashku u nisën për në infermieri.

— Agron! — i foli mjeku të sëmurit. — Do të shkojmë deri në spitalin civil.

I sëmuri nuk foli. Ushtari fuksoi sytë te Luani si me habi.

— Edhe këtu jam mirë, doktor.

— Atje do të jesh akoma më mirë.

Autoambulanca u nis. Mjeku qëndroi pas me të sëmurin. Gjatë rrugës ai vuri re një shenjë të çuditshme: ushtari dukej sikur qeshte me një mënyrë djallëzore. «Risur Sardonicus!»

— Tetanos!

S'kish më vend për dyshime. Ushtar Haliti që infektuar me mikrobin e tetanosit. I sëmuri u shtrua menjëherë në spital dhe po atë çast filloi mjekimin. Të nesërmen erdhi dhe e ëma e Agronit. Ajo qëndronte te koka e të bërit dhe qante në heshtje.

— Do të shpëtojë, doktor? — pyeste vazhdimisht mjekët.

— Do të shpëtojë, nënë, mos ki merak! Ne do të bëjmë çmos...

— 13 —

Luani u habit kur e njoftuan se e kërkonte komisari i njësisë. Ora ishte nëntëmbëdhjetë. Mjeku më mëngjez që takuar me të. Ai i raportoi për gjendjen shëndetësore të ushtar Agron Halitit, i cili kishte dalë jashtë rrezikut pas një lufte të madhe e këmbëngulëse. Luani ishte shumë i gëzuar. Tani ai po përgatitej të delte në qytet, sepse do të takohet me Majlindën. Ishte takimi i parë dhe atij mezi po i pritej të vinte ora. Përse e kërkonte komisari? Mos do ta dërgonte vallë me shërbim? Takimin me Majlindën mjeku po e priste me emocion. Herë-herë bëhej guximtar dhe vendoste që

t'ia thoshte pa drojtje. Herë të tjera i mungonte guximi dhe kishte frikë se mos i fliste për lindjet e vështira, për rastin me tetanos të ushtar Agronit, që shpëtoi për mrekulli nga vdekja. Ai kishte nevojë për aq guxim sa t'i thoshte Majlindës vetëm dy fjalë. Po, dy fjalë të shkurtëra, të vogla, por shumë të fuqishme: «Të dua». Vetëm kaq. Për edhe për ato dy fjalë i mungonte kuraja. Luani pat dhënë tërë ato provime, pat dalë përpara pedagogëve hijerëndë, e megjithatë ia kish dalë matanë. Kurse tani, duke shkuar në takim, Luani e ndjente veten shumë ngushtë, si një nxënës fillestar, që, sa herë takon mësuesin, skuqet nga emocioni.

Ndërsa ai po jepte e po merrte me këto mendime, një ushtar i shtabit e lajmëroi se e kërkonte komisar i njësisë. Luani u nis për në shtab. Mbase komisar nuk do të kishte shumë punë me të.

Luani trokiti në derë.

Mjeku njohu zërin e butë e dashamirës të Mensurit dhe u fut brenda.

— Shoku komisar, oficer Rrapi simbas urdhërit tuaj ju paraqitet.

— Luan, uluni.

Luani zuri vend në një cep të tryezës së gjatë karshi komisarit.

— Nga komanda eprore më njoftuan se ju do të merrni pjesë në mbledhjen e plenumit XI të Komitetit Qendror, që do të mbahet në Tiranë.

Komisari kërkoi një copë letër në dosje, pastaj shtoi:

— Në plenum do të merret në shqyrtim raporti i Byrosë Politike «Mbi gjendjen dhe masat që duhen marrë për ta ngritur në një nivel më të

lartë shërbimin shëndetësor, sidomos profilaktikën e higjenën.»

Luani mbeti disi i hutuar. E kishte dëgjuar mirë komisar Mensurin apo i kishin bërë veshët? Po, ai e dëgjoi fare qartë: «Do të merrni pjesë në mbledhjen e plenumit XI të Komiteti Qendror...»

— Për mua e keni fjalën, shoku komisar? — pyeti i drojtur.

— Po, për ju, shoku Luan.

— Unë... s'kam bërë asgjë... për të merituar një nder të tillë.

Luanit po i merrej goja. Nuk dinte si të fillonte. Një valë e fortë emocionesh e pushtoi atë çast dhe ai nuk po dinte si t'u jepte rrugë. A e meritonte një nder të tillë? Çfarë kishte bërë më tepër se të tjerët. Asgjë veç detyrës si mjek i një njësie. Kur kishte mbaruar gjimnazin kishte dashur të bëhej mjek. Kishte bërë kërkesën dhe i qe aprovuar. Kishte qenë student i rregullt e këmbëngulës në studime. Pastaj muajt dhe vitet kishin rrjedhur dhe ja, një ditë ai dha provimet e fundit. Të gjithë prisnin emërimet. Dikush mendonte për një vend të rehatshëm, ndoshta ndonjë tjetër mendonte për sektorët më interesantë. Po Luan Rrapi mendonte ndryshe. Ai preferoi më të vështirën, të shkante si mjek në një repart ushtarak. Kështu e filloi ai jetën e mjekut dhe u fitoi zemrat të gjithëve. Jo vetëm ushtarët, por edhe fshatarët që jetonin pranë garnizoneve të largëta e prisnin me respekt. Ata e takonin dhe kërkonin që t'u vizitonte ndonjë fshatar të sëmurë.

«Kemi sjellë edhe mushkën që të mos lodhesh, doktor.

Ç'është kjo mushkë? Unë do të eci në këmbë, ndërsa mushkës do t'i hipi ky shoku këtu, që është i mosnuar». Ndër fshatarët hapej lajmi se në fshat kishte ardhur doktori i ushtrisë. Nënatin vinin me fëmijët ndër duar, kurse pleqtë ecnin të mbështetur në bastun. Ja, kjo ishte pak a shumë jeta e Luanit. Ç'kishte këtu të jashtëzakonshme?

Kur doli nga komisari, iu kujtua se duhej të takohej me Majlindën. Pa orën. Me siguri që Majlinda do të kishte dalë te vendi i caktuar dhe e priste. Nxitoi hapin. Gati vraponte. Ajo ditë që dita më e shënuar për të. Brenda një dite dy gëzime, lajmin që i dha komisari dhe takimi me Majlindën. Me të vërtetë dy ngjarje të shënuara në jetën e tij që nuk do t'i harronte kurrë.

Luani iu drejtua vajzës ñ drojtur.

— Më fal, Majlinda! Më vjen keq që ndodhi kështu.

— Çfarë ju ndodhi?

— Në kohën që po delja për të ardhur, më thirri komisari.

— Domethënë do të nisesh me shërbim...

— Jo, jo. Komisari më njoftoi se duhet të nisem në Tiranë.

— Përgjithnjë?

— Jo. Në Tiranë zhvillohet plenumi XI i Komitetit Qendror. Jam ftuar të marr pjesë edhe unë.

Majlinda u kthye me vrull nga ai.

— Vërtet?

— Po, Majlinda.

— Kurse unë pandeha se...

Ata ecnin pranën njëri-tjetrit. Luani ndjente në krah të tij Majlindën e qetë, të bukur, me sytë

ngjyrë qielli. Ishte tamam ajo, Majlinda, që ai donte aq shumë. Vajza nuk dukej sikur ecte për-krah tij, por sikur fluturonte, tamam si ato fluturat e vogla e të bardha të pranverës. Luani mund ta dallonte tani Majlindën midis mijëra vajzave të tjera. E njihte nga flokët, nga supet e bukura dhe nga ecja. Ajo ecte me hapa të ngutur, me vështrimin përparë. Dhe me sa vëmendje e dëgjonte Luannin. Ai i fliste për udhëtimin që do të bënte në Tiranë, për mbledhjen ku do të merrte pjesë...

SHOKU SKËNDER, PASKENI ARDHUR?

*Kushtuar mjekëve
të reparteve.*

— 1 —

Oficer Skënderi doli nga infirmieria e repartit me mendjen të shqetësuar. Sapo mbaroi vizitat në ambulancë, me duar në xhepa u drejtua në rrugën e asfaltuar të qytetit ushtarak. Bënte ftohtë. Qe një ditë dhjetori me lagështirë e me erë. Në qiell tufa resh të ngarkuara me avuj vraponin njëra pranë tjetrës. Një natë më parë kishte rënë shi me shtamba dhe e gjithë natyra kullonte ujë. Kullonin pemët, çatitë dhe deri telat e telefonave që kalonin në mes të repartit.

«Nga çasti në çast përsëri mund të bjerë shi», mendoi Skënderi. Në fushën e stërvitjes ushtarët merreshin me fizkulturë dhe bënin stërvitje. Në veshin e oficerëve arrinin të shkëputura copëza komandash:

— Pranë veglës!

— Toga, pas meje për dy rreshtohu!

Mjeku buzëqeshi. Ajri i pastër i asaj pasdite

sikur e ripërtriu dhe ai e ndjeu veten më të lehtësuar. E megjithatë, duke shkruar për në shtëpi, një mendim i qe ndalur në kokë: «Përse atë ditë numri i ushtarëve që qenë vizituar ishte më i madh se herët e tjera?» Një pjesë e tyre qenë me temperaturë, kollitëshin dhe u mungonte ai humor që Skënderi ua njihte mirë.

«Ndoshta mund të jenë fenomene të shkaktuara nga ndryshimi i kohës», e qetësoi veten.

Skënderi qe në mëdysnje. Nuk dinte si të vepronte, t'ua bënte ushtarëve vaksinat apo të priste edhe disa ditë. Ai i kishte marrë të gjitha masat. Kishte grumbulluar vaksinën e nevojshme, shiringat, gjilpërat, sterilizatorët e vegjël, pat mbledhur ndihmës mjekët ushtarë të reparteve e ua kishte dhënë udhëzimet përkatëse. Pra çdo gjë qe gati.

«Si të bëj?»

Me të vërtetë nuk dinte si të bënte. Por atë pasdite paraqitja e mjaft ushtarëve në ambulancë me temperaturë e kishte shqetësuar mjekun. Ecte dhe mendohej. Nuk qe gjë e lehtë që të jepte menjëherë një mendim të saktë.

«Duhet të pyes mjekun epideemiolog të rrethit», vendosi duke dalë jashtë repartit.

Te stacioni i autobusit nuk iu desh të priste shumë. Hipi në maqinë, preu biletën dhe qëndroi më këmbë. Autobusi qe mbushur plot. Nëpërmjet dritares Skënderi vështronte se si i kalonin pas me shpejtësi fushat e punuara, serat prej plastmase, uzina e qytetit me oxhakun e lartë që shponte qiellin e ngarkuar me re; pastaj u dukën shtëpitë e para të qytetit.

— Shoku shef, urdhëroni uluni!

Përpara Skënderit u ngrit një ushtar, një djalosh i ri, i veshur me uniformë të re ushtarake, me rripin të shtrënguar rreth kapotës e me vijën e bardhë të qafores së re. Çdo gjë që e bukurohe dhe e hijshme tek ai ushtar.

— S'ka gjë, ushtar Luloçi.

Ushtari qëndroi në këmbë.

— Urdhëroni!

— Ju falemnderit!

Skënderi u ul. Kur ndenji mbi stol, atëhere e ndjeu sa që lodhur. Ushtar Luloçin e njihte mirë. Ata të dy qenë njohur disa muaj më parë, kur ushtari kishte qenë ende i ri në repart. Atë ditë Skënderi po shkante në komandë duke kaluar përpara dyqanit të ushtarit. Ushtarët që u ndodhën aty e përshëndetën duke marrë qëndrim gatitu. Vetëm njëri nuk lëvizti nga vendi. Skënderit nuk i erdhi mirë dhe e kuptoi se ai ushtar nuk që formuar ushtarakisht. Ai nxitonte për në shtab.

«Nuk bëra mirë që nuk e qortova», mendoi.

Kur mbaroi punë, Skënderi u kthye përsëri asaj rruge. Ushtari ishte po aty dhe përtypte me përtesë një petull të mbështjellë në letër. Ai edhe këtë radhë nuk e përshëndeti.

«Këtë herë do të ndalem».

— Shoku ushtar!

Djaloshi rrinte i mbështetur fare indiferent pranë murit të dyqanit. Rripin rreth kapotës e kish të liruar, ndërsa bustinën e mbante në xhep.

— Shoku ushtar! Pse nuk i përshëndetni eporet sipas rregullores?

— Nuk ju vura re...

— Unë kalova dy herë këtej.

— Nuk ju pashë.

— Përse nuk ndodhemi në kompaninë tuaj në këtë çast? Shokët bëjnë stërvitje, kurse ju rrini kot dhe hani petulla. A është kjo një sjellje prej një ushtaraku të mirë?..

Ushtari nisi të rregullohej.

— Si e keni emrin?

— Ushtar Durim Luloçi.

— Në cilën kompani jeni efektiv?

— Në kompaninë e dytë.

— 2 —

Epidemia u fut në repart. Mjeku u përpoq me të gjitha mënyrat për të ndaluar futjen në njësi, por nuk ia doli dot. Masat parambrojtëse që vuri në lëvizje e vonuan për disa ditë hyrjen e epidemisë në rreshtat e efektivit. Ç'mund të bënte më tepër Skënderi? Të gjitha ato që dinte rreth sëmundjes i vuri në jetë, por megjithatë viruset u përhapën me një shpejtësi të rrufeshme. Edhe në qytet ajo kishte nderë kthetrat e saj të tmerrshme. E kish vënë qytetin në një si darë dhe e shtrëngonte, e shtrëngonte, gjithnjë e shtrëngonte. Të dukej se nga çasti në çast ajo do të shtrohej sa gjerrë e gjatë, nëpër shtëpi, konvikte, fshatra... Dhe Skënderit i bëhej sikur të gjithë do të pyesnin: «Po ju mjekët ç'bëni? «Nuk jeni në gjendje të ndalni këtë epidemi?» Në veshët e tij buçisnin si në një simfoni të çakorduar dhembja, ethet, kolla, rënkimet.

Në fjetore numri i krevateve me të sëmurë vinte duke u rritur. Infermiera u mbush me rastet më të rënda, ndërsa të tjerët u vendosën në një kapa-

non të madh. Mjeku rrinte midis tyre, i vizitonte, i pyeste, u jepte mjekime.

Ushtarë të rinj vinin çdo ditë në vizitë. Ata vinin të tronditur, me fytyrë të skuqur nga zjarmia. Uleshin në stolin e gjatë përpara ambulancës dhe prisnin radhën që ndihmësmjeku t'u vinte termometrin. Edhe vetë Skënderi nuk ndjehej mirë. Por nuk e jepte veten. Ai duhej të rezistonte pavarësisht se zhiva ngjitej në termometër deri në 38 gradë. Pinte nga një aspirinë dhe sikur lehtësohej. Kush do t'i vizitonte ushtarët, po të sëmurej edhe ai?

Ndihmësmjeku qe ende i ri dhe zor se do t'i bënte ballë atij numri të madh të sëmurësh. Prandaj nuk e jepte veten.

Ndërsa bëhej gati për të dalë, dikush trokiti në derën e ambulancës.

Në prak u duk oficer Shpëtim Ajazi, komandanti i kompanisë së dytë. Pas tij rrinte ushtar Durim Luloçi, me fytyrë të skuqur e të mbuluar me bula djerse.

— Si është puna? — pyeti mjeku.

— Kam sjellë ushtar Luloçin të vizitohet, shoku Skënder. E solla me zor, pasi nuk dëgjonte.

— Shumë mirë keni bërë.

— Unë i kam ushtarët tërë ditën e ditës në rresht dhe i njoh kur sëmuren. Ai kollitet prej dy ditësh. U detyrova ta sillja vetë.

Skënderi i hodhi një vështrim ushtarit dhe e kuptoi se ai nuk ishte mirë. Fytyra i qe skuqur, frymëmarrjen e kish të vështirë dhe në sy i lexohej një rraskapitje e madhe.

Në pjesën e poshtme të mushkërisë ushtar Luloçit i dëgjohej një zhurmë.

— Do të shtrohet në infermieri — i tha oficerit.

Ushtar Luloçi i afrua mjekut.

— Nuk ka mundësi të marr disa barna. Ndoshta bëhem mirë.

— Ju jeni ftohur.

— Atëhere të vij pasnesër të shtrohem.

E dini si është puna, shoku doktor? Nesër kompania jonë ka qitje dhe ushtar Luloçi do të marrë pjesë — ndërhyri komandanti i kompanisë.

— Në asnjë mënyrë. Të shërohet një herë, pastaj të marrë pjesë në qitje.

— Edhe unë i këtij mendimi jam.

Ushtar Luloçi u shtrua. Sapo u fut në dhomën e ngrohtë të infermierisë, e ndjeu veten disi më mirë. Aty gjeti plot ushtarë të njohur që kolliteshin dhe nevrikoseshin nga temperatura e lartë ose nga dhembjet.

— 3 —

Tani, tek rrinte i shtrirë në krevat, ushtar Durimi kujtoi ngjarjen që i kish ndodhur me Skëndërin. Dhe i erdhi turp nga vetja. Atëhere Durimi nuk qe formuar akoma si ushtar, megjithse kishte veshur uniformën e gjelbërt. Në kompaninë e dytë kishin ardhur ushtarë nga të katër anët. Dikush nga qyteti, dikush nga fshati. Dhe secili kish sjellë me vete zakone nga vendlindja. Që në ditët e para ushtar Luloçi u ndesh me kërkesa të forta. Rekruti i numëronte ditët me gishtërinj dhe i bëhej sikur kofna nuk donte të rridhte. Ditët dhe javët e para iu dukën të gjata. Në mëngjez zgjohej me

bori, në darkë gjithashtu binte me bori. Ai kujtonte jetën e shkujdesur e pa telashe në familje. Kurse këtu duhej të përshëndestë ushtarakisht çdo epror që takonte rrugës. Rregulloret e detyronin ta mbante uniformën mirë, të zbatonte urdhërat e të vepronte me përpikmëri që nga zgjimi e deri në mbrëmje.

Në fillim ushtar Luloçi e pati të vështirë. Dhe qe pikërisht në njërin nga këto ditët e para që u ndesh me oficer Skënderin. Sa keq kishte vepruar! Në kompani sjellja e tij u muar në shqyrtim që të nesërmen dhe shokët e kritikuan rëndë. Që nga ajo ngjarje ushtar Luloçi nuk qe takuar më me Skënderin. Me shëndet qe mirë, prandaj dhe nuk shkonte në ambulancë. Por kësaj radhe sëmundja e mposhti dhe komandanti i kompanisë e mori me vete.

— 4 —

Skënderi arriti në shtëpi, kur akrepi i vogël i orës po i afrohej shtatës. Nata qe e errët dhe e ftohtë. Jashtë filloi të binte një shi i shtruar.

Në korridor hoqi kapotën.

— Si është vajza? — pyeti të shoqen.

— S'është mirë.

— I piu ilaçet?

— I vjell!

Vajza përvëlohej nga ethet, balli dhe flokët i qenë lagur nga djersa.

— Babi, erdhe? — e pyeti ajo.

Skënderi iu afrua së bijës dhe e përkëdheli.

— Si je tani, xhani i babit?

— Më dhemb koka.

— Do të të shkojë.

Vajza i shtrëngoi dorën të atit.

— Babi, ti nuk do të ikësh më? Dua që të rrih me mua.

— Ja, këtu jam, pranë teje.

Skënderi e mbuloi më mirë vajzën me jorgan, i fshiu djersët dhe pastaj e puti në ballë.

Vajza mbylli sytë dhe u përpoq të flinte. Skënderi rrinte përpara së bijës dhe dëgjonte frymëmarrjen ritmike e pak të ashpër. Zjarmia i kishte arritur kulmin. Nuk donte të përdorte antibiotikë. Shpresonte se mjekimet e thjesha dhe aftësia mbrojtëse e organizmit do t'i bënin ballë infeksionit.

«Mos është vallë e nevojshme të filloj një mjekim më të fuqishëm?»

Po ushtarët e sëmurë ç'bënin tani në repart? Skënderi kaloi nëpër mend një nga një fytyrat e ushtarëve të shtruar. Disa nga ato qenë të skuqura, të tjerat të qullura me djersë. U mundua të kujtonte pamjen e grykës të secilit, zhurmët që kish dëgjuar në mušnkëritë e secilit. Nga të gjithë të tjerët ushtar Luloçi qe më rëndë. Ç'bënte ai tani? Ç'mendonte vallë? Mos e ndjente veten të vetmuar. Disave u qenë infektuar bajamet, të tjerët nuk i linte të qetë kolla. Ndonjërit i dhembte veshi.

— Babi, këtu je? — pyeti vajza duke ngritur kokën.

— Fli, xhan, këtu jam...

Skënderi rrinte pranë shtratit të së bijës dhe mendohej për ushtarët e sëmurë. Ata ia kishin nevojën aq shumë tani në këto çaste. Ai e dinte se sa zemër u jepte prania e mjekut të sëmurëve.

Në repart Skënderi kishte lënë ndihmësmjekun dhe i kish dhënë atij udhëzimet. Prandaj s'duhej të shqetësohej.

Skënderi hangri darkë i heshtur dhe pastaj dëgjoi lajmet në radio. E shoqja e njihte natyrën e të shoqit. Kur ai heshtte, diçka bluante në mendje.

— Skënder, përse mendohesh?

Ai nuk iu përgjeggj.

— Mos je gjë i sëmurë?

— Nuk kam asgjë.

— Po ç'ke atëhere?

— Kam mjaft të sëmurë në repart. Kjo epidemi ishte e keqe.

— I ke marrë të gjitha masat?

— E megjithatë...

Skënderi e dinte se një ditë epidemia do të kalonte, ashtu siç kalojnë furtunat. Ajo qysh tani kish filluar të binte. Ushtarët do ta merrnin veten, do të gjallëroheshin dhe jeta në repart do të ecte si më parë. Mëngjezeve herët reparti do të gumëzhinte nga zërat e hareshëm të ushtarëve, nga vrapimet, nga shakatë që bënin me njëri tjetrin duke u larë te çesmat. Ai e dinte mirë këtë. Por Skënderi dinte gjithashtu se sëmundja ishte dinake dhe mund të shkaktonte ndonjë të keqe.

Mjeku u çua në këmbë.

— Skënder, pse u ngrite?

— Do të iki në repart.

— Tani? Ti s'ke shumë kohë që u ktheve prej andej.

— Duhet të shkoj.

E shoqja nuk i foli. Ajo e njihte vendosmërinë

e të shoqit. Ai i dinte mirë punët e tij. Le të shkonte, të sëmuret kishin nevojë për të.

— Për çdo gjë të vajzës më lajmëro me telefon.

— Mirë!

— 5 —

Ushtar Durim Luloçi rrinte shtrirë në krevatin e infermierisë. Ai e ndjente veten shumë keq. I dukej vetja sikur që futur në një kazan me ujë, poshtë të cilit zjarri bënte punën e vet. Kish zjarmi. Herë pas here e ngiste edhe kolla, një kollë e thate, që nuk e linte rehat të flinte. As dritën elektrike nuk e duronte dot. Ajo i vriste sytë dhe e shqetësonte. Të sëmuret e tjerë ishin ca më lehtë dhe flinin. Ndhimësmjeku i bëri gjilpërat. Edhe ai që lodhur nga pagjumësia.

— Ujë! — foli ushtar Luloçi.

Ndhimësmjeku iu afrua.

Ushtari piu gotën me ujë dhe mbylli sytë. U përpoq edhe një herë të flinte. Por nuk ia doli dot. Nga të gjithë të sëmuret ai bënte më shumë gjilpëra.

«Duhet të merrem me diçka, të mendohem për ndonjë gjë». Ai kujtoi ditën e parë në repart, ardhjen e rekrutëve, vënien në rresht dhe larjen në banjën e madhe.

Rekrutët qeshnin, fërkoreshin me sapun, laheshin duke bërë shaka. Në dhomën e veshjes i dhanë një çantë shpine të mbushur me teshat

ushtarake. Durimi veshi këmishën, të mbathurat, pantallonat, xhaketën.

— Shpejt, shpejt, shoku ushtar, — thirri një nënoficer i sektorit të prapavijës.

Durimi e pa i habitur.

— Kopsit xhaketën!

Gishtërinjtë e rekrutit lëvizën.

Ata ende nuk qenë stërvitur të mbërthenin aq shumë kopsa. Pas pak e ndeju veten të shtrënguar. E shtrëngonte qaforja, e shtrëngonin mëngët, rripi i mesit.

Po këpucët me se do t'i vishte? Çorape nuk i zuri syri. Në vend të tyre në çantën e shpinës gjeti një palë pece. Në jetën e tij nuk kishte mbathur ndonjëherë pece.

Atë çast iu afrua një oficer.

— Si i ke punët, shoku ushtar?

— Po... ja.

— Nuk të hyn këmba?

— Nuk e kuptoj përse nuk futet.

Oficeri i ra në sup me dashamirësi.

— Pa dale ta shohim.

Shpëtimi u ul mbi gjunjë, mori pecen dhe e hapi mbi dërrasë.

— Vëre këmbën këtu — i tha Durimit.

Durimi u bind. Oficeri e theu cepin e peces mbi gishtërinjtë e këmbës, e tendosi cohën, pastaj me shpejtësi e mbështolli rreth e përçark.

— Fute tani këmbën në këpucë — e urdhëroi oficeri. — Kështu mund të marshosh sa të duash dhe t'i kesh këmbët pa plagë.

Dhe ja, kështu i ndodhi Durimit ditën e parë të ardhjes në ushtri. Por kjo ngjarje tani i dukej

e largët, e pakapshme, sikur t'i kish ngjarë ndonjë ushtari tjetër dhe jo atij. Ai tani që i sëmurë, me temperaturë dhe nuk dinte se si do t'i vinte filli. Ai përsëri humbi në kllapi dhe, kur mendja iu kthjellua pak, nisi të mendonte përsëri për ato ditë të shkuara. Ditët e para i vinte zor të përshëndeste ushtarakisht. Se si i dukej. Vërtet këtë gjë e kërkonte rregullorja, por ai nuk e ndjente. Ndoshta nuk i që bërë ende shprehi. Edhe shprehitë dhe zakonet e reja duan një farë kohe të krijohen. Atë ditë që qe takuar me mjekun e repartit, ushtar Luloçi kishte ardhur për të blerë petulla, me bustinë, me rripin e mesit, me qaforen e shkopsitur. Të nesërmen kompania bëri mbledhje. Ushtar Luloçi nuk kishte ndër mend të fliste, por nuk e lanë të qetë. I pari e kritikoi ushtar Saimiri. Ai ua tregoi të gjithëve se si qe sjellë ushtar Luloçi me mjekun e repartit.

Asnjëherë nuk e kish ndjerë veten ai më ngushtë se sa atë ditë.

...Ushtar Luloçin e ngau kolla. Sa herë që kollitej, e shponte gjoksi.

— Si je? — e pyeti ndihmësmjeku.

— Çka...

— Të lajmëroj oficerin e rojes që të thërrasë doktorin?

— Jo, jo, ai s'ka s'numë kohë që ilku prej këtej.

Hapja, që i dha ndihmësmjeku, sikur e qetësoi. Durimi mbylli sytë. Përse po mendohej? Ku e ka fillin e mendimeve? Te diskutimi i komandantit të kompanisë.

Atë ditë foli në mbledhjen e kompanisë si kurrë ndonjëherë.

— Pa mendoni, shokë, se ç'do të ndodhte sikur të gjithë në skuadrën tonë të vinim dorë mbi uniformën, të braktisnin shërbimet, të mos jetonin me rregulloret, të mos nderonin eprorët. Pa mendoni ç'do të ndodhte? Patjetër do të çënohej gatishmëria luftarake...

Nga ajo mbledhje kishin kaluar disa muaj. Ushtar Luloçi iu vu stërvitjes me mish e me shpirt, studjoi rregulloret e mbi të gjitha bëri përpjekje për t'i vënë ato në jetë.

Por tani ai qe i sëmurë. A do të shërohej shpejt? A do të kthehej tërë ajo forcë që e bënte të lëvizte gjithë ditën e të vraponte nëpër transhe e karabinë, të ngjitej nëpër litarët e fushës sportive?

— Ushtar Luloçi, si jeni?

Kush e thërriste? Ky zë iu duk i njohur.

— Ushtar Luloçi, si e ndjeni veten tani?

Durimi hapë sytë. Në fillim drita ia vrau dhe ai u detyrua t'i mbyllte disa herë. Pastaj në bebë e syve të tij mori formë një fytyrë e njohur, vesnur me bluzë të bardhë dhe me stetoskopin që i rrinte varur në qafë.

— Shoku Skënder! paskeni ardhur?!

Dhe atë çast ai e ndjeu veten çuditërisht të getë.

POSTIERI

Pas disa muajsh jete në ushtri Mehmeti nuk e quante më veten ushtar të ri. Ai qe njohur me të gjitha, sepse kryente dhe detyrën e postierit. Ishte i vetmi njeri në repart që lidhte ushtarët e baterisë me familjet dhe të afërmit e tyre. Ai u sillte shtypin dhe revistat periodike. Sigurisht kjo ishte një punë e thjeshtë, por mjaft e këndshme. Kjo punë i ngjallte atij në shpirt një kënaqësi të çuditshme. Djaloshi shikonte se sa gëzim sillte tek ushtarët ardhja e një letre ose shpërndarja e gazetës. Me anën e letrave mësonin mbi shëndetin e të afërmeve, mësonin të rejat nga fshati apo qyteti, futjen e dritës elektrike në shtëpitë e kooperativave, ndërtimin e shkollës së re, ngritjen e banjove, lavandarive dhe furrave kolektive.

Ata merrnin forca të reja dhe i kalonin vesh-tirësitë e shërbimit me lehtësi. Mehmeti ishte ndoshta i vetmi që dinte se ushtar Frrok Nika, që bënte pjesë në një togë të baterisë, e kishte humbur energjinë e ditëve të para, qe bërë i heshtur dhe mënjanohet nga shokët. Ai kishte më tepër se dy muaj që s'kishte marrë letër nga shtëpia. Në letrën e fundit që kishte dërguar në shtëpi, pat kërkuar të prishej fejesa e bërë që në djep nëntëmbëdhjetë vjet më parë. Mehmeti e kuptonte se qetësia e ushtar Frrokut qe prishur. Në gazetë ai

kishte lexuar letrat që gratë dhe vajzat e malësive i dërgonin udhëheqësit të partisë. Ato jepnin fjalën se do të flaknin tutje zakonet prapanike, që i kishin mbajtur të lidhura porsitë skllave. Më tepër atij i kishte lënë mbresë letra e nëntë vajzave të fejuara, të cilat kishin folur në kuvend para gjithë popullit, duke dënuar zakonet prapanik të fejesave në moshë të vogël.

Po ai, si ushtar i Ushtrisë Popullore ç'qëndrim do të mbante? A nuk duhej ta prishte edhe Frroku një zakon të tillë prapanik, viktimë e së cilës qe edhe ai vetë?

Frroku ia hapi zemrën komandantit dhe pas kësaj mori penën dhe shkroi një letër në shtëpi. Ai u thoshte njerëzve të tij se nuk e quante më veten të fejuar me atë vajzë që nuk e njihje, se hiqte dorë nga ky zakon prapanik. Po ata të shtëpisë pse heshtnin? Dukej që edhe në kullën e tyre kishte marrë fund qetësia, e reja me të vjetrën qenë përplasur nën çati dhe njerëzit heshtnin, lëkundeshin të merrnin vendime. Prandaj edhe letra që priste Frroku po vonohej. Kjo vonesë e bënte atë të vuante, të mendonte, të vriste mendjen. Megjithatë ai për vete ishte i vendosur. Sa do të donte Mehmeti t'i sillte Frrokut një copë letër që ai të buzëqeshte e t'i kthehej gëzimi i mëparshëm!

«Çudi, thoshte me vete, po unë përse shqetësohem? Ç'faj kam unë që Frrokut nuk i vjen kjo letër?»

Ushtar Mehmetit iu kujtua ajo ditë, kur komandanti i baterisë e njoftoi se ai do të kryente dhe detyrën e postierit të baterisë.

«Njerëzit tanë nuk mund të jetojnë asnjë çast

pa gazetata, pa revistata, pa mësimet e partisë i kishte thënë komandanti atë ditë. — Ato janë ushqimi ynë i përhershëm. Edhe letrat kanë rëndësinë e tyre. Ushtarët duan të komunikojnë me njerëzit e shtëpisë, me të fejuarat, me shokët e punës, apo të shkollës.»

Dhe kështu ushtar Mehmeti kishte filluar nga detyra e re. Një herë në javë ai mblidhte letrat nga kutia e postës, që qe varur në hyrjen e mensës. Pastaj hipte duke kërcyer nga shkëmbi në anije dhe dorëzonte postën. Letrat i ruante me një kujdes të madh. Ai e dinte se në to shokët e tij kishin derdhur zemrën dhe mendjen e tyre. Sa herë i kish parë tek shkruanin të menduar në dhomën e kulturës. Të përkulur mbi letrën e bardhë, shkruanin, ndalonin pak, pastaj rifillonin përsëri. Ndonjëri buzëqeshte me vete. Ndërsa Frrokut, kur kishte shkruar atë letër, mbi ballë i qe dukur një brazë e thellë.

Kur anija kthehej nga qyteti dhe i afrohej shkëmbit, Mehmeti gjendej në «skelë». Ai merrte postën e shkonte në bateri! Të gjithë, sapo e shihnin, bërtisnin me një zë.

— Erdhi postieri!

— Erdhën gazetata!

— Mehmet, a kam letër?

Ardhja e postierit kthehej në një çast të gëzuar. Ushtarët i merrnin nga dora gazetata, revistata. Ata e pyesin për letrat, ia merrnin me nxitim, grisnin zarfet dhe fillonin nga leximi. Midis tyre gjendej gjithmonë edhe Frroku, por ai rrallë pyeste. E shikonte Mehmetin në sy dhe midis tyre bëhej ky dialog i heshtur:

«A kam letër sot?»

Jo!

Mos u tall, Mehmet?

Ti e di, Frrok, që unë nuk tallem».

Sa do të deshte postieri të kishte një letër për të dhe t'ia zgjaste. Mjaftonte një zarf i vogël, mbi të cilin të qenë shkruar nga një dorë e pastërvitur emri i Frrok Nikës, numri i repartit dhe në cepin e djathtë pulla e vulosur. Por ja që një zarf i tillë akoma s'po dukej.

Atë mbrëmje Mehmeti mori shërbimin. Vendroja gjendej Karshi detit, mbi një shkëmb. Poshtë, nën këmbët, e tij, ujërat e detit nxinin e rrihnin ritmikisht shkëmbin. Kushedi sa ushtarë kishin bërë roje në atë vend! Ashtu si ai e kishin përgjuar horizontin. Tutje në thellësi është bota tjetër, një botë ku njeriu për njeriun është ujk, ku një palë punojnë, robëtohen e vuajnë nga uria, ndërsa të tjerë rrojnë në luks të madh. Pas tij shtrihej atdheu i dasnur, Shqipëria socialiste, për të cilën ai dhe shokët e baterisë bënin roje. Shumë larg, buzë ujit, mezi shquhej qyteti bregdetar. Me sytë e mendjes ai ndiqte rrugën kryesore, kalonte midis shtëpive të larta dhe të bukura dhe qëndronte pranë një ndërtese me dy kate, mbi ballkonin e së cilës varej një tabelë me germa të mëdha: «Postë telegrafike». Kur Mehmeti shkonte me leje në qytet, ai shkonte vetë deri atje për të marrë letrat dhe shtypin e repartit. Kjo ndodhte shpesh. Ato ia jepte një vajzë shtatvogël, me flokë të pre-ra shkurt. E quanin Flutura. Stërvitjen ushtarake e bënte në një repart kundërajror të garnizonit. Bateria ku ajo bënte pjesë kishte dalë shkëlqyeshëm. Ajo, posa e shihte ushtarin, hynte në zyrën e postës e i thoshte e gëzuar!

— Erdhe!

— Erdha, Flutura.

— Thashë se nuk do të vije sot. Deti ka pasur shumë dallgë.

Flutura i vinte përpara pakon me gazeta e letra dhe e vështronte me kureshtje.

— A të zë deti ty, Mehmet?

— Jo, nuk më zë.

— Si lum ti! Mua më bën shumë keq.

Mehmeti merrte pakon ndër duar, kontrollonte gazetatat dhe letrat, i mblidhte përsëri dhe pastaj bëhej gati të dilte:

— Kur do të vish përsëri?

— Të shohim.

— Rrugë të mbarë, Mehmet!

— Mirëupafshim, Flutura!

Postieri delte nga zyra i dehur nga gëzimi. As ai vetë nuk e kuptonte nga i vinte gjithë ajo lumturi. Ç'po ndodhte vallë me të? Ç'vend zinte Flutura, ajo nëpunëse e thjeshtë e postës, në zemrën e tij? Ai nuk e dinte. Sidoqoftë ajo vajza me shtat të vogël, që qëndronte përtej xhamit transparent, veshur me bluzë të zezë e jakë të bardhë, sepse e shqetësonte. Kujtimi i saj e shqetësonte edhe natën kur flinte, ose kur bënte roje mbi shkëmb me armë në dorë. Mehmeti nuk u jepte dot rrugë këtyre mendimeve. Ai gati vraponte, me letrat e gazetatat ndër duar, në drejtim të skelës. Ora e nisjes afronte shpejt. Detarët ngarkonin fuçi, dërrasa, çimento, ndërsa komandanti i anijes qëndronte sipër; i qetë, duke vështruar retë e ngarkuara me shi, që vinin që përtej detit.

Atë ditë ushtar Mehmeti hipi në anije më shpejt se zakonisht, përshëndeti detarët dhe zuri

vend në një drejtim me bashin. Anija u nis duke çarë përmes dallgëve. Direku i saj përkulej andej-këtej sipas drejtimit të dallgëve. Dikujt filloi t'i përzihej. Mehmeti u struk në vendin ku rrinte dhe nisi të lexonte letrat: Hasan Kamberi. . Petrit Rrapii... Frrok Nika.

— Frrok Nika paska letër! — thirri me zë.

— The gjë? — pyeti një oficer.

— Jo!

Tjetri heshti. Pastaj e pyeti përsëri.

— Në ç'repart je?

— Ja, atje — dhe i tregoi me gisht baterinë.

— Zor se i afrohet anija baterisë me këto dallgë.

— Vërtet?!

— S'ma merr mendja, ka shumë ball det.

Mehmeti hodhi vështrimin nga komandanti i anijes. Ai qëndronte i qetë në postin e komandimit dhe jepte urdhëra njëri pas tjetrit. Po ta shikoje me vëmendje, mund të vije re shqetësimin, e tij. Tani edhe Mehmetit po i përzihej. U mundua të hiqte vështrimin nga dallgët që ngriheshin deri në bash.

Atë çast ushtar Mehmetin e shkëputi një dallgë që u hodh mbi bashin e anijes. Dallga që shumë e ftohtë dhe e kripur. Uji tani i varej nga kapota dhe pikonte poshtë. Ai vuri dorën nën xhakëtë dhe preku pakon me gazetat dhe letrat e ushtarëve.

«Nuk janë lagur», — tha me vete.

Ai duhej të zbriste patjetër në bateri. Ushtarët prisnin gazetat dhe letrat nga shtëpia. Këtë radhë Frroku kishte letër. Po a kuptonin ata se ç'do-

nte të thoshte kjo për shokun e tij, Frrokun? Ai bisedoi me disa nga detarët, të cilët i njihte më mirë.

— Ne jemi gati, — i thanë ata — vetëm thua-
ji komandantit.

— Me leje, s'okuk komandant!

— Ç'është?

— A do të më lini dot në breg?

Dallgët bënë zhurmë. Komandanti nuk dë-
gjoj.

— Si the?

— Mundohuni të më zbrisni në bateri, shoku
komandant.

— Afrimi pranë shkëmbit është me rrezik,
shoku ushtar.

Mehmeti nuk e dëgjoi mirë, por e mori me
mend që komandanti s'pranonte. Dallgët e ngri-
nin dhe e ulnin anijen, sikur të ishte ndonjë lë-
vozhgë arre në mes të detit. Komandanti i anijes
qe detar i vjetër. Për të tregonin shumë ngjarje
interesante... Prandaj edhe postieri kish besim se
ai mund ta afronte anijen pranë bregut shkëmbor,
pa e dëmtuar atë.

— Shoku komandant, ju lutem shumë! — për-
sëriti Mehmeti.

— Po ç'ke, more djalë?

— Ju lutem shumë të më zbrisni!..

— Ti pse nxitohesh?

— Unë nuk nxitohem... por ja, kam gazetata
dhe letrat e ushtarëve.

— Çfarë?

— Gazetat... Letrat. Ushtarët i presin me
padurim.

— Ti je postieri i baterisë?

— Si urdhëron!

— Zbrit poshtë!

Mehmeti zbriti me të shpejtë nga ura e komandimit. Komandanti iu afrua grupit dhe dha një urdhër. Pas pak Mehmeti vuri re se bashi i anijes po drejtohej për nga bateria. Por pikërisht atë çast dallgët sikur u egërsuan edhe më tepër. Deti ulej dhe ngrihej parreshtur, bashkë me të tundej dhe anija.

— Shkëmbi ku do të hidhej postieri s'ishte larg.

— Para mengadalë! — dha urdhër komandanti.

Detarët vrapuan me bordin nga ana e shkëmbit.

— Stop! — u dëgjua përsëri zëri i komandantit të anijes.

— Ju falemnderit, shokë detarë!..

Mehmeti kërceu menjëherë nga anija mbi shkëmb. Duart e ushtarëve e kapën pas kapote dhe e tërhoqën. Ai vështroi përsëri, por Frroku s'qe me ta. Sa keq! Ai kishte menduar se nuk do të kishte letër as këtë radhë. Sikur ta dinte, do të kishte vrapuar i qeshur, ashtu siç e mbante mend Frrokun disa kohë më parë.

Ushtarët e baterisë, të grumbulluar mbi shkëmb, përshëndetën me grusht ekipazhin e anijes, që largohej duke u lëkundur mbi dallgët e tërbuara.

Ushtar Mehmeti mendonte për gëzimin që do t'i jepte shokut të tij.

NJERËZ ME BLUZA TË BARDHA

— *Novelë* —

— 1 —

Spitali e ndiqte divizionin pas. Njerëzit marshonin ditë e natë nëpër ato rrugë të punuara me kalldrëm, midis maleve të ashpra të mbuluara me borë.

Ushtarët qenë të lodhur, por nuk e jepnin veten. Më tepër se rruga i mundonte uria dhe të ftohtët që bëri atij dimri.

Zakonisht në spitalin e divizionit mjekoheshin ushtarë që vinin nga vija e frontit. Kishte midis tyre të ftohur që kolliteshin, njerëz me temperaturë, të tjerë që u pikonin gjak plagët e këmbëve nga marshimi i gjatë dhe mjaft të plagosur me armë zjarri në luftimet me nazistët që tërhiqeshin.

Brigadat ecnin gjithnjë përpara, ndërsa të sëmurët mbeteshin pas, vetëm ose të shoqëruar, derisa takoheshin me spitalin.

Shefi i spitalit qe një mjek i ri, i shëndoshë, i veshur me uniformën e oficerit italian. Kostumi i rinte mirë dhe kjo gjë me sa duket e kënaqte. Në këmbë kish veshur një palë këpucë alpine të mëdha

me gozhdë që të bënin të besoje se ai njeri do të ikte nga çasti në çast kushedi se ku. Në fakt nuk kish se ku të shkonte. Vendi i tij qe në spital. Ai rrinte aty, ditën dhe natën, në mes të sëmurëve dhe të plagosurve të divizionit. Barna nuk kishte shumë. Ai e donte së qe luftë dhe kënaqej me ato që kishin. Mjetet, me të cilat luftonin sëmundjet, qenë sulfamidi, aspirina, kinina. Gjilpërat për forcimin e zemrës si kamfori ose kafeina ishin me pakicë, prandaj dhe përdroreshin në të sëmurët më rëndë.

Kur spitali i divizionit merrte urdhër që të ndalej e të hapej në ndonjë ndërtesë, ata e kuptonin se punët në front nuk shkonin dhe aq mirë. Kjo desh të thosh se nazistët bënin rezistencë, ndërsa batalionet e kishin vështirë të përparonin. Ngjarjet në front mjeku i merrte vesh në shtabin e prapavijës ose me anën e të plagosurve që vinin nga reparti e vijës së parë.

Eksperiencia e mësoi doktor Spiron që nga lloji i plagëve që merrnin të plagosurit të përcaktonte dhe llojin e luftimit, luftohej në mbrojtje apo në mësymje. Kur trupat kalonin në mësymje, te të plagosurit mbizotëronin plagët e barkut dhe të anësive të poshtme. Kur forcat tona mbroheshin, plagët e të dëmtuarve përqëndroheshin më tepër në shpatullën e majtë, në krah ose në gjoks.

Atë dimër bëri mjaft të ftohtë. Binte borë vazhdimisht. Dhe binte me ditë të tëra. Malet, fushat, fshatrat tulateshin ndën peshën e borës së bardhë thuajse do të shtypeshin fare. Vendet ku kalonte divizioni qenë të shkreta e të djegura nga armiku që tërhiqej. Ai bënte çmos që të mbronte

rrugët kryesore. Përndryshe forcat që tërhiqeshin do të mbeteshin të rrethuara, midis atyre maleve të ashpra e të ftohta, të pangrënë dhe nën zjarrin e pandërprerë të forcave të divizionit që i ndiqte këmba-këmbës.

Batalionet e kompanitë marshonin drejt veriut, të veshur keq e të pangrënë, por të vendosur për të luftuar. Nga pas i ndiqte spitali i divizionit i ngarkuar mbi pak kuaj, e mbi karroca të vjetra që kërkelinin nëpër kalldrëm sikur të kishin dhembje.

— Kur do të qëndrojmë të marrim pak veten?
— pyeti Ollga, infermierja e spitalit.

— Kur të na japin urdhër — u përgjegj Nazja, një shoqe e saj.

— U bënë tri ditë që po ecim.

— Kjo varet si venë punët në front — tha ndihmësmjeku, Nekiu, një djalë i ri me shpatulla të gjera.

Ollga i hodhi vështrimin ndihmësmjekut dhe i buzëqeshi.

— E di... — u përgjegj ajo shkurt.

Sytë e Nekiut qenë të lodhur, por, kur ato u ndeshën me ata të Ollgës, morën një shkëlqim të çuditsëm. Infermierja u mbështoll mirë me kapotën e saj dhe vështroi larg në drejtim të një fshati.

— Përse mendohesh? — e pyeti Nekiu.

— Mendohem.

— Për kë?

— Për ditët e bukura që do të vijmë.

— Gjaku i shokëve të vrarë nuk shkoi kot,

Ollga.

— Jo, s'do të shkojë kot — mërmëriti Ollga.

Pak më tutje qëndronin të dy mjekët, Spiroja dhe Marioja, me atë mjekrën e tij të vogël dhe me majë. Edhe ata bisedonin. Kohët e fundit Marioja kishte shfaqur shenja lodhjeje. Doktori thoshte se ai vuante nga një lloj neuroze që shkaktohet në kohë lufte të njerëzit me vullnet të dobët, me moral të rënë dhe që nuk kanë një ideal.

— Compagno Mario!

Italiani u kthye nga Spiroja.

— U lodhe? — e pyeti Spiroja me përzemërsi.

— Deri në grykë — u përgjegj Marioja.

Mjeku qeshi.

— Gjithnjë marshojmë. Ku do të shkojmë? Në Berlin? Basnkë me ne marshojnë dhe morrat. Ato na futen kudo: në këmishtë, në xhaketë, në trup e deri te bluzat e bardha në ambulancë. Në fillim më vinte neveri, por tani pak e nga pak po mësohem:

Marioja fliste pa e vështruar. Fliste dhe lëvizte duart.

— Shumë mirë!

— Çfarë shumë mirë — u habit i huaji.

— Po ja, që po mësohesh, compagno Mario.

Spiroja, sa herë e dëgjonte, qeshte me të madhe me fjalët që thoshte shoku i tij i punës.

— Ç'mjekësi bëjmë ne? A s'më thua, doktor?

— Ne duhet të bëjmë sigurimin shëndetësor të brigadave të divizionit; të mjekojmë të sëmurët e të plagosurit në mënyrë që ata të kthehen sa më parë në front. Kapito?

— Mua më ka ardhur në grykë kjo jetë.

— Durim, Mario!

— Nuk mundem.

— Ti, ke frikë?

Marioja e shikoi shokun në sy.

— Po, kam frikë. Njeriu që nga çasti që lind dhe gjatë gjithë jetës ndodhet në një gjendje frike. Ai u trembet skamjes, dhembjeve, luftës, vdekjes...

Spiros nuk i pëlqeu ky mendim.

— Mario, këto mendime bien erë disfatizëm. Ne nuk e honepsin fatalizmin.

— Dëgjomë mua ti — foli italiani duke trazuar mjekrën me gishtërinj. — Mua më tremb e panjohura. Sa isha në ushtrinë tonë, trembesha se mos më dërgonin në spitalin e frontit. Tani më tremb ideja se si jetojnë gruaja dhe fëmijët gjatë mungesës sime. Por më tepër më frikëson një gjë, a do të shpëtoj dot gjallë nga lufta. A do t'i shoh dot një ditë njerëzit e mi të dashur?

— Do t'i shohësh, Mario. Tani për tani ne duhet të luftojmë armikun e përbashkët.

— S'më ka mbetur asnjë fije shprese dhe duri — u përgjegj Marioja i dëshpëruar.

— Shumë keq, doktor!

— Po ç'të bëj sipas teje?

— Ti duhet të bëhesh trim, i guximshëm. Ja ç'duhet të bësh.

— Ti po tallesh!?

— Aspak! Mbi të gjitha ti je mjek dhe për ty ne kemi shumë nevojë. Ne të kemi besuar jetën e shokëve tanë të plagosur. A e kupton ti këtë? Së bashku me ne luftuan partizanët italianë të batalionit «Antonio Gramshi» dhe ata i bënë nder vetes dhe popullit tuaj.

— Doktor Mario, mirë thotë shoku Spiro. Ne të duam si njerinë tonë — ndërhyri Ollga.

— Ju falem nderit.

— Kurse ti demoralizohesh në një kohe shu-

më të vështirë për ne, për spitalin, për jetën e të plagosurve e të sëmurëve — shtoi infermierja.

— Ollga, nuk mundem, më kupton? Nom posso!

Mario e shikonte vajzën me ca sy të çuditshëm. Ajo fliste dhe ai dëgjonte zërin femëror që dridhej në ajër. Fjalët e Ollgës i hynin thellë në shpirt dhe i ndillnin ca ndjenja të ngrohta, të cilat kishte kohë që s'i pat ndjerë.

Ollgës i vinte keq që doktor Marioja kishte humbur besimin ndaj çdo gjëje. Mjeku kërkonte të mbështetej diku. Po ku? Te kush? A nuk mund të mbështetej plotësisht te kolektivi i spitalit? Optimizmin dhe besimin që kishin ata, të gjithë, duke filluar që nga Dani, roja i spitalit e deri te doktor Spiroja, këtë optimizëm duhej t'ia ngjallnin edhe këtij.

— Unë nuk e kuptoj — i tha ai Spiros — se nga buron ky optimizmi juaj?

— Ne jemi të një brumi tjetër — iu përgjegj mjeku duke i rënë Marios me dorë mbi sup. Pastaj nxori paqetën e cigareve dhe ia zgjati shokut.

— Mario, ndize një herë!

— 2 —

Spitali i divizionit u vendos në një shtëpi dykatshe. Oborri që mbuluar me hislla dhe me bar si një pyll i vërtetë. Shtëpia nuk ish shumë e re. Çatia e saj prej teneqeje, me kulm të mprehtë dhe mjaft e lartë, kishte marrë një ngjyrë si në të kuqe nga ndryshku. Disa parvazë të dritareve qenë kalbur nga shiu, ndërsa të tjerët i kish bluar mola.

Në faqen e përparme të ndërtesës delte një ballkon i vogël, si një çiban; shkallë prej dërrase që të shpinin në katin e sipërmqenë të vjetra, vende-vende të kalbura dhe, kur shkelje mbi to, kërcisnin sikur do të thyheshin.

Në fillim çdo gjë iu duk doktor Spiros e trishtuar.

Ai mblodhi personelin dhe u shpjegoi atyre urdhërin e komandës së divizionit që spitali të hapej në atë ndërtesë.

— Sa do të rrimë këtu — pyeti Marioja.

— Nuk dihet, doktor.

— Si gjithnjë!

Por asnjeri nuk ia vuri veshin atij.

— Këtu duhet punë — t'na Nekiu.

— Në radhë të parë duhet pastruar oborri dhe dhomat shtoi Ollga. — Kësaj ndërtese duhet t'i japim pamjen e një spitali të vërtetë.

Mbledhja që e shkurtër. Njerëzit filluan menjëherë nga puna. Prenë barin, hisllat, lanë dyshemetë, xhamat dhe ngritën ambulancën.

Nekiu u mor me vendosjen e barnave, mbasi ai bënte dhe punën e farmacistit. Por dhoma që i dhanë që e vogël dhe me lagështi.

— Doktor, këtu do të na prishen barnat — i lutej ai doktor Spiros.

— S'kemi vend tjetër, Neki.

— Nuk di unë! Ato duan vend të thatë dhe të ajrosur.

— Ja, thuamë ti kë dhomë të marrësh?

Nekiu ngrinte supet.

— Mbase nuk do të rrimë shumë — i thoshte Spiroja për të dalë nga situata.

— Asaj nuk i dihet!

Nekiu kishte të drejtë. Kush e dinte sa do të qëndronin. Edhe ata të shtabit të divizionit zor se mund ta dinin. Meqë po vendosej spitali në atë ndërtesë, kish një farë kuptimi. Siç duket lufta që ndezur e rreptë në llogoret e vijës së parë. Nazistët luftonin me tërbim duke ruajtur rrugët kyçe të tërheqjes së tyre.

Armiku bënte përpjekje të dësnpëruara para se të jepte shpirt. Gjëmimi i artilerisë së brigadave arrinte deri në spitalin e divizionit. Njerëzit mbanin vesh. Topat gjëmonin për një farë kohe, pastaj përsëri zotëronte heshtja.

— Tani fillon sulmi i këmbësisë sonë — i thoshte Nekiu Olgës.

Ai merrte me mend se si artileria godiste vijën e parë të armikut dhe tani i takonte radha këmbësisë.

— Së shpejti do të na vijnë në spital të plagosurit.

— Nga e di ti, Neki?

— Pas artilerisë gjithnjë e ka fjalën këmbësoria.

Aty nga mesdita vinin të plagosurit e parë. Ata i sillnin me karro ose me kuaj. Ambulanca spërkatej me gjakun e të plagosurve. Ata shtrëngonin dhëmbët që të mos rënkonin. Bashkë me të plagosurit vinin dhe ushtarë me këmbë të ngrira nga qëndrimi i tepërt në borën e transheve. Atë ditë erdhi një djalë i ri me emrin Julqezar. Kishte një emër të çuditshëm.

Vërtet i ri, por duronte më tepër se një i rritur.

— Julqezar, si dukesh tani? — e pyeti Ollga.

— Jam më mirë.

Julqezari nuk e bënte veten. Djali e shikonte infermierën në sy dhe mundahej të buzëqeshte.

— Tani do të bëjmë mjekimin e plagës.

— Mirë, shoqe.

Ollga i hoqi fashiot e gjakosura dhe garzat që i qenë ngjitur pas plagës. Pranë saj mbante një tabaka të madhe me jod, garza, fashio e lloj-lloj pincash. Julqezari mbylli sytë. Dhoma u mbush me një erë të keqe që delte nga muskujt e mavijosur të plagës. Ajo mori gërshërët dhe preu copëra mishi të kalbur. Infermierja shtrëngonte dhëmbët. Herë-herë asaj i dukej se nuk do ta çonte deri në fund mjekimin e plagës. I bëhej se forcat do ta linin në mes e do t'i binte të fikët.

«Mbañu, Ollga!» i tha vetes.

Julqezari dha një britmë. Jodi e dogji dhe ai i humbi ndjenjat. Ollga i afroi një shishe të vogël në hundë dhe priti. I sëmuri nuk reagoi. Vajza u tremb. Ja afroi shishen edhe një herë pranë hundës. Julqezari lëvizi pak kokën, pastaj hapi sytë si me përtesë.

— Po ti ç'pate? — e pyeti Ollga.

Partizani u turpërua.

— S'di se si më erdhi.

— Ama trim që na qenke. Unë të dija hero të vërtetë, kurse ti...

Të sëmuret qeshën.

— Po në luftë si bën ti? — e ngacmoi me dashamirësi Ollga.

— Shoqja Ollga, ta dinit ju se si lufton ai në fushën e betejës, do të habiteshit — tha ushtar Selami nga fundi i sallës. — Njëherë së bashku me dy shokë ai kapi një rob gjerman dhe e solli në shtabin e batalionit.

— Lëre, se e pashë.

Julqezari e mblodhi pak veten.

— Këtu në spital ndryshon puna, se si më vjen kur shoh gjithë këto ilaçe.

Një i plagosur tjetër, që kishte tërhequr vëmendjen e mjekëve në këtë dhomë që edhe Refatit. Ai digjej prej disa ditësh nga një temperaturë e lartë, që nuk ia kuptonin se nga i vinte. Ilaçet s'po i bënin efekt. Doktor Spiroja e vizitonte përditë, herë vetëm, herë me Marion. Ata flisnin në gjuhë të huaj, pastaj delnin nga dhoma duke tundur kokët të pakënaqur.

— Ç'mendoni ju, doktor Mario? — e pyeste Spiroja në ambulancë. Marioja heshte. Vrenjtje vetullat dhe mundohej të sillte ndër mend ndonjë rast të ngjashëm me atë të Refatit.

— S'di ç'të them.

— Mua nuk më pëlqen temperatura.

Spiroja vinte duart në xhepat e bluzës së bardhë dhe bënte ecejakë nëpër dhomë.

Ata shikoheshin sy ndër sy dhe heshtnin. Laborator spitali nuk kishte. Pa laborator puna e mjekëve vështirësohej mjaft. Spiroja kujtonte të gjitha rastet me temperaturë të zgjatur që kish ndeshur në praktikën e tij dhe mundohej t'i krahasonte me sëmundjen e Refatit. Por edhe ajo pak eksperiencë që kish për mjekësinë shëruese nuk po e ndihmonte. «Mos vallë ka në këto anë ndonjë sëmundje që nuk e kemi në anët tona?» pyeste veten mjeku i divizionit. Por ai s'mund të jepte menjëherë alarmin pa u siguruar mirë. Asnjëherë Spiroja nuk e kish ndjerë veten kaq ngushtë sa këtë radhë. Si të bënte? Të jepte sinjalin e

alarmit duke raportuar në komandën e divizionit për dyshimet e tij?

Çdo ditë i afrohej Refatit pranë shtratit, i vështronte me kujdes ca njolla të vogla bojë mavi të përhapura në lëkurën e barkut, shikonte fletët e temperaturës dhe mendohej. Pas tij vinte Nekiu i heshtur dhe shikonte doktorin e shqetësuar, që lexonte mbrëmjeve vonë libra të trashë me shpresë se mos gjente ndonjë shpjegim mbi sëmundjen e Refatit. Librat thoshin shumë gjëra, flisnin për shumë sëmundje të rrezikshme që dikur kishin përgjysmuar ushtri të mëdha duke rrezikuar fitore të arritura me sakrifica.

— 3 —

Refati kish ditë që digjej nga temperatura. Në batalion kishte qenë fare mirë. Vërtet se atje vuani ca nga ushqimet e nga të ftohtët, por midis shokëve të skuadrës së tij e kalonte për mrekulli. Mëqenëse kompania gjendej në vijën e parë, komanda u jepte atyre nga pesëmbëdhjetë kokrra patate dhe treqind gram bukë misri. Ky qe ushqimi që hante kompania e groposur në llogore.

Borë kishte me tepricë. Ajo binte mbi llogore, mbi shpinat e tyre dhe gati sa nuk i ngrinte. Sa vinte mëngjezi, kompania delte nga llogoret, shkundte borën dhe nisej për në sulm. Atëhere mitralozat nazistë fillonin të villnin zjarr.

Në front qe mjaft vështirë, por Refati dinte përse luftonte dhe kish një besim të patundur në fitoren.

Një mbrëmje atë e zunë ca të padredhura. I

dhembte koka. «Do të kalojë», tha me vete. Batalioni nuk kishte infermier. Shokët e shpunë në shtëpinë e një fshatari. Një burrë i motshëm, bashkë me njerëzit e shtëpisë e priti mirë. I bëri ca mjekime popullore, por gjendja u rëndua edhe më tepër. Pas dy ditësh Refatin e shpunë në spitalin e divizionit.

Tani ai dergjej në shtratin me kashtë prej disa ditësh. Mjekët e vizitonin përditë, infermierët i bënin gjelpera, por temperatura nuk i binte.

Doktor Spiroja vinte pranë shtratit të Refatit dhe e brënte dyshimi. Ç'qe ajo temperaturë që po e treste nga dita në ditë atë djalë të ri? Cili që ai mikrob që e shkaktonte? Edhe në popullatën civile kishte mjaft të sëmurë që vuanin. Mos që i njëjti mikrob që jepte atë temperaturë te të dy palët.

Në mëngjez mjeku i divizionit shkoi në shtab, bisedoi gjerë e gjatë mbi dyshimet e sëmundjes dhe propozoi masa konkrete për luftën kundër miorrave. Ai formuloi udhëzime për repartet poshtë dhe u largua nga komanda me zemrën të ngrohtë. Në komandë i kishin mbështetur plotësisht mendimet e tij. Mjeku kërkoi që të delte vetë nëpër reparte për të parë gjendjen, të ndihmonte sa të mundte, në mënyrë që t'i vihej fre përhapjes së sëmundjes në reparte. Gjendja ishte serioze. Spiroja e kuptonte fare mirë këtë gjë. Përhapja e sëmundjes do të ndikonte në uljen e gatishmërisë luftarake. Ai si mjeku i divizionit kishte përgjegjësi të madhe për këtë.

Partizanët donin të luftonin fytyrë me nazistat. Ata prandaj ndodheshin tani përtej atdheut, që të luftonin me hordhitë naziste të ndihmonin

popullin fqinj të çliruhej sa më parë nga nazizmi dhe të ndihmonin përparimin e Ushtrisë së Kuqe duke vonuar tërheqjen nga Ballkani të shumë divizioneve armike.

Spiroja erdhi vonë në spital.

— Si janë të sëmurët? — pyeti Ollgën në ambulancë.

— Një pjesë kanë temperaturë.

— Po Refati si duket?

— Rëndë.

Spiroja i'u afrua dritares i menduar. Njëpër-mjet perdes ai dalloj konturet e çative të qytetit të shkatërruar nga lufta.

Si do t'ia delte mbanë kësaj epidemie që po merrte dalëngadalë proporcione të mëdha? Laboratori mungonte. Mjekët mungonin. Ai me shokët e tij do ta drejtonte këtë luftë në këtë vend të huaj? Dhe si? Pa mjete dezinfektuese të mjaftueshme dhe i rrethuar nga morrat në të katër anët. Atë çast syri i shkoi në një cep të bluzës së bardhë. Një pikë me ngjyrë që lëvizte.

— Morr! — mërmëriti me vete.

Hoqi bluzën nga trupi dhe ia dha Ollgës.

Ndoshta ai morr mund të qe i infektuar nga mikrobet e sëmundjes. Po ta kishte pickuar në trup? Që nga ai çast duhej të kalonin pesëmbëdhjetë ditë pa asnjë shënjë dhe pastaj do të fillonin shenjat e para të sëmundjes: ethe, dhembje koke dhe dobësi. Nuk kishte asnjë vaksinë, me të cilën të mbronte personelin dhe veten e tij. Sa do të dëshironte të gjendej aty pranë një laborator bakteriologjik për të ekzaminuar morrat e infektuar, të bënte analizat e gjakut të të sëmurëve dhe të siguronte me saktësi natyrën e sëmundjes. Por

këto ishin ëndrra me sy hapur. Në vendin ku ish hapur spitali nuk gjendej asnjë nga ato që kërkonte Spiroja.

Para se të ikte për të fjetur, Spiroja kaloi nga salla e të sëmurëve ku gjendej Refati. Ju afrua pranë shtratit dhe e vërejti me kujdes. I sëmuri kish mbyllur sytë, ndërsa fytyra i qe mbuluar me bula djerse.

— Refat!

Djaloshi hapi sytë. Vështroi rreth e përçark me habi sikur të mos i kujtohej se ku ndodhej. Pastaj lagu me gjuhë buzët e përthara nga ethet dhe mbylli sytë përsëri. Kush e kishte thirrur? Mos qe në ëndërr? Hapi sytë përsëri dhe ktheu kokën nga drita. Atëhere dalloj pranë shtratit një trup njeriu të veshur me të bardha. Ai njeri i kish marrë dorën me duart e tij dhe diçka numëronte me mend.

«Cili është ky?» mendoi me vete .

— Refat! Si e ndjen veten?

— Ç'ka...

— Të dhemb gjë?

— Më pihet ujë.

— Jam doktori...

— Tani të njoha.

Refati lëvizti në shtrat dhe rrëzoi batanien për-tokë. Ollga e mori dhe e mbuloi me kujdes.

— Mos u zbuloj xhan, se ftohesh — i foli infermierja.

Refati e pa në sy. Infermierja buzëqeshi. Ajo mundohej të plotësonte të gjitha porositë e mjekut për të ndihmuar sado pak në përmirësimin e Refatit.

— T'i jap ujë, doktor? — pyeti ajo mjekun.

— Jepi, Ollga. Me lugë...

Spiroja mori një stol dhe u ul pranë Refatit. Ai i dëgjoi për një kohë të gjatë zemrën me stetoskop, pastaj u mendua.

— Ollga, merr shiringën dhe bëji një olio camphora.

Infermierja do! nga salla dhe u kthye me shiringën në dorë. Spiroja mbushi një pjatë me borë dhe vuri mbi të një pecetë të bardhë. Pastaj e shtrydhi dhe e vendosi mbi ballin e të sëmurit.

Ne duhet ta shpëtojmë, mendoi Spiroja duke i hedhur një vështrim Ollgës që rrinte në këmbë.

— Ke gjumë, Ollga?

— Jo doktor.

— Shko fli!

— Nuk më t'bet.

— Unë të shoh se po të mbjllien sytë. Shko fli.

— Jam në shërbim, doktor.

— Do të rri unë.

— Ju? Edhe ju jeni i lodhur!

— Pastaj vij të zgjoj.

Infermierja ngurroi për një çast.

— Shko, shko...

Mjeku ia nguli sytë përsëri Refatit. I sëmuri kishte një fytyrë të re, si prej çilimiu. Balli nisi t'i mbulohej me pika të mëdha djerse, ndërsa buzët mavi qëndronin të puqura sikur t'i kishte kyçur njeri me çelës. Mjeku e vështronte, i maste pulsën dhe sikur iu çel fytyra. Ai mori një peshqir dhe me të fshiu trupin e të sëmurit që qe mbytur në djerse. «Kjo është shenjë e mirë», tha mjeku me vete. Të sëmurët e tjerë bënë gjumë të thellë. Vetëm njëri prej tyre gërhiste. Ai qe Selamiu,

që ngulte këmbë të delte nga spitali.

Spiroja kishte dremitur mbi stol, te koka e të sëmurit dhe nuk mori vesh fare kur rrezet e para të agimit kishin hyrë nga dritarja e barrakës. Vetëm zëri i Ollgës e zgjoi nga gjumi.

— Doktor!...

— 4 —

Batalioni ku bënte pjesë më parë Ollga ishte në vijën e parë. Të plagosurit dhe të sëmuret po shtoheshin. Shtabi i batalionit u shqetësua, sepse në repartin e tyre nuk kishte të paktën as edhe një infermier. Nga shtabi i brigadës erdhi një urdhër. Ai kërkonte që komanda e batalionit të dërgonte në spitalim e divizionit një shoqe për të marrë pjesë në kursin për infermiere.

Komisari i batalionit e pat thirrur Ollgën në shtab. Ata biseduan gjerë e gjatë mbi këtë punë, por Ollga nuk bindej. Asaj as që i kishte shkuar ndonjëherë ndër mend se mund të bëhej infermiere. Por lufta kish ligjet e saj. Ajo nuk mund të kuptohej pa të plagosur, pa të sëmurë. Kush do të merrej me ta. Vetëm spitali i divizionit nuk u bënte dot ballë të gjithëve. Jakupi, infermieri i brigadës, nuk e përballonte dot volumin e punës. Prandaj shtabi i batalionit kishte vendosur të dërgonte në kursin e infermierëve Ollgën.

— Si thua, Ollga?

Ajo kishte heshtur.

— Heshtja do të thotë se e aprovon mendimin tonë.

— Jo, jo.

— Po, pse?

Ollga kish heshtur përsëri. Fjalët që thosh komisari ishin të drejta. Dikush duhej të shkonte në kurs. Dikush. Po pse vallë Ollga? Një fjalë goje është: «Ollga, ti do të shkosh në kurs!» Ollga nuk e merrte dot me mend veten e saj jashtë shokëve e shoqeve të skuadrës. Skuadra që bërë për të si familje e dytë.

— Ollga, pse nuk do të shkosh në kurs? — e pyeti me ngulm komisari.

— Pse të shkoj unë?

— Po kush të shkojë?

— Ndonjë tjetër.

— Cila?

Ollga qe zënë ngushtë.

— Ku e di unë?

Komisari kishte buzëqeshur.

— Jo, shoqe. Nuk është mirë kështu. Në luftë: po na plagosen shokë, po na sëmuren. Ata duhen mjekuar.

— Kemi Jakupin.

— Po ç'do të bëjë vetëm Jakupi në një brigadë të tërë? Një njeri me kaq të plagosur e të sëmurë. Ç'të bëjë më parë ai?

Ollga kish ulur kokën. Sytë i qenë mbushur me lot. Ato që thosh komisari ishin të vërteta, por ajo e kishte të vështirë të ndahej nga shokët dhe shoqet e kompanisë. Me ta kishte jetuar qysh në krijimin e brigadës. Kish marrë pjesë në sa e sa luftime, i pat rënë Shqipërisë që nga Jugu e deri në Veri, duke ndjekur këmba-këmbës armiqtë dhe tradhëtarët e vendit. Ky qe dimri i dytë që po kalonte. Dhe këtë radhë jo në tokën shqiptare, por

më tutje, në veri, përtej kufirit. Ajo ishte ushtar dhe duhej t'u bindej urdërave. Komandanti suprem kish urdhëruar që brigada të kalonte kufirin dhe të ndiqte armikun këmba-këmbës. Ndihmë internacionale. Marshimi që i gjatë, dimri që i ftohtë, malet të ashpra. Por midis shokëve të skuadrës ajo e ndjente veten mirë. Komandant Suloja tregojë i kujdesshëm me të gjithë. Ai vërtet që ca i vrazhdë në pamje, por kish një zemër të mrekullueshme. Kish shpatula të gjera e ecje të shpejtë. Gati sikur vraponte. Mbante veshur një kapotë gjermane të gjatë deri ndënë gju.

Por komisari i repartit nguli këmbë që ajo të shkonte në kurs, pasi batalionit i duhej një infermiere. Kështu që një mëngjez ajo u nis së bashku me disa shoqe të tjera të brigadës për në vendin ku gjendej spitali i divizionit. Ato mbërritën në mbrëmje dhe e gjithë ndërtesa sikur ndryshoi pamje. Spitali u duk sikur u bë më i qeshur, ndërsa të sëmurët dhe të plagosurit i shikonin vajzat nga dritarja me sy gazmorë.

— Ç'janë këto?

— Kursante për infermiere?

— Çfarë

— Do të bëjnë kurs për infermiere dhe do të shpërndahen nëpër reparte.

Të nesërmen vajzat filluan kursin. Programi që kishte ndërtuar doktor Spiroja që i ngjeshur dhe parashikonte t'u jepte kursanteve gjërat më të domosdoshme, për të punuar në një spital ose në një sektor të pavarur. Mësimet i zhvillonte herë Spiroja, herë ndihmësmjeku. Në dhomën e tyre, që shërbente si klasë, flitej për kockat e njeriut, për muskujt, arteriet, për mikrobet që mbushnin am-

bientin dhe orë e çast rrezikonin njerëzit. Aty ato mësuan se të gjitha sëmundjet kishin një shkaktar. Dhe këta qenë mikrobet.

Kursantet dëgjonin me vëmendje dhe mbanin shënime në fletore. Ollga mundohej t'i merrte me mend këto qenie shumë të vogla si disa pika ose presje të shkruara në letër. «Si është e mundur që një njeri i rritur të sëmuret nga qenie kaq të vogla, saqë nuk shikohen as me sy? pyeste Ollga veten. Veç nazistëve në front ne paskemi edhe armiq të tjerë të padukshëm, që futen në trupin e ushtarit dhe e sëmurin atë, përshembull sëmundja e tifos së morrit.»

Morra kishte nga të doje, në popullatën civile e në ushtri. Kudo që shkonin, partizanët e divizionit ndesheshin me morre të infektuar e të painfektuar. Nga mund t'i njihje nëse ishin të infektuar me mikrobet e tifos ekzantematike, siç e thërrisnin mjekët? Morrat, duke thithur gjakun e të sëmurëve, bashkë me të thithnin edhe mikrobet. Këta parazitë të infektuar bridhnin të lirë nëpër ushtarët, i pickonin duke u futur në gjak mikrobet dhe pastaj i sëmurnin.

Spitali i divizionit po mbushej dita-ditës me të sëmurë. Partizanët e sëmurë vinin nga batalionet në ambulancë me temperaturë, me dhembje koke, me dobësi të theksuar dhe shtriheshin në dyshekët me kashtë të rraskapitur e të dërmuar nga ethet. Në darrë të disa temperatura arrinte deri 40° dhe ata flisnin përçart ose mbaronin nga mëngjezi pa i ndier askush.

Doktor Spiroja ishte alarmuar. Ai kishte dërguar udhëzime nëpër brigada që të bëhej luftë për çmorritje, të spërkateshin me pluhur DDT, të për-

vëlonin teshat nëpër fucitë partizane. Por deri atë-
here rezultati nuk po dukej.

Pranë spitalit, në faqen e një kodre të rrum-
bullakët, qenë varrezat. Përditë Selmani e Agimi
hapnin gropa të reja për të varrosur shokët që
nuk i bënin dot ballë sëmundjes. E si mund t'i
bëhej ballë asaj sëmundje duke luftuar në borë
të paushqyer mirë, përballë nazistëve të armatosur
gjër në dhëmbë. Vetëm morali i lartë i partizanë-
ve, qëllimi që i kishin vënë vetes për të çliruar po-
pullin fqinj, i bënin ata që të përlesheshin me ar-
mikun me egërsinë më të madhe. Me gjithë këto
vështirësi tani u duhej të luftonin edhe me sëmu-
ndjen e rrezikshme që i kërcënonte nga dita në
ditë.

Në këto rrethana mjeku po shikonte konkre-
tisht se ç'do të thotë morali i lartë për një ush-
tri. Ai i shihte me sytë e tij se partizanët e divi-
zionit kishin besim të madh në forcat e veta dhe
në njerëzit e partisë. As nazistët dhe as vështirësi-
të e mëdha të natyrës nuk e kishin dërmuar dot
vullnetin e tyre. Dhe as do ta thyenin. Ky mendim
i pëlqeu doktorit dhe gjithë atë mbrëmje nuk iu
nda nga mendja derisa e zuri gjumi.

Por natën vonë portier Danja e zgjoi nga gju-
mi.

— Doktor! Doktor!

Spiroja u përmend me vështirësi.

— Ç'është? — pyeti ai nëpër gjumë.

— Një fshatar kërkon një mjek. Se ç'ka një
hall të madh. E di që je lodhur, por thashë se...

Spiroja zbriti mbi dysheme.

— Ku rri?

— Në një fshat pesë kilometra që këtej.

Ai u çua, u vesh dhe doli në oborr, me çantën e barnave të urgjencës nën sjetull. Të ftohtët e preu në fytyrë si brisk i mprehtë. Së bashku me fshatarin u nis për tek i sëmuri me një kaloshin. Koba që e vrenjtur dhe nga qielli binin flokë bore. Kapela dhe xhupi që kishte veshur nisën të zbardheshin. Pas një ore udhëtimi kaloshini qëndroi përpara një kasolleje të vjetër. Ajo kasolle i solli ndër mend fshatrat e Shqipërisë së varfëruar nga lufta e të djegura nga fashistët dhe nazistët. «Kudo populli ka vuajtur njëloj nga shfrytëzuesit dhe nga pushtuesit barbarë,» mendoi mjeku duke hyrë në kasolle.

Në kasolle mezi ndriçonte një llambë vajguri me qelqin të nxirë nga tymi. Në qoshe të kasolles ishte shtrirë një fëmijë i sëmurë, i mbuluar me një velenxe. Pranë tij qëndronte një legen i vjetër, mbushur me ujë, në sipërfaqen e të cilit notonin ca thëngjij të shuar. Spiroja e pa dhe buzëqeshi.

— Çfarë ka fëmija? — pyeti në gjuhën e tyre.

— Kollë... efne, doktor,

Mjeku iu afrua shtratit dhe përkëdheli fëmijën.

— Si i ke punët, more vogëlush?

Djali ngriti sytë që i shkëlqenin nga ethet dhe u mundua të buzëqeshte.

— Pa dale të të shikoj ca...

Një grua e re doli nga errësira dhe i ngriti velenxen. Spiroja nxori stetoskopin nga çanta dhe dëgjoji mushkëritë e fëmijës.

— Çfarë ka, doktor? — pyeti fshatari me zë të dredhur.

— Është ftohur.

— Është rëndë?

— Po.

Fshatari heshti nga dhembja që i shkaktuan ato fjalë, ndërsa gruaja nisi të qante me dënese. Me cepin e përparësës ajo fshinte lotët, e ngashëryer, duke mërmëritur me veten e saj ca fjalë pa kuptim. «Ndoshta i lutet zotit që t'i shpëtojë fëmijën, mendoi ai. Diçka duhet të bëjë për të!» Spiroja vendosi në një gazetë një ampulë, e theu dhe pastaj thithi tërë lëngun në shiringë. Gruaja ndiqte me kureshtje të gjitha lëvizjet e mjekut. Në jetën e saj s'kishte parë ndonjë mjek. Në fshatin e tyre me shërimin e njerëzve merreshin ca plaka të motshme. Ato nuk dinin gjë tjetër veçse të fndhnin në ujë thëngjij të ndezur për të djegur «syrin e keq».

Jashtë frynte erë. Dëbora binte pa pushim duke u përplasur me zhurmë në dritaren e vogël të kasolles.

Mjeku e dinte që fëmija ishte në gjendje shumë të keqe. Por ai duhej ta shpëtonte atë fëmijë dhe të kthente gëzimin në atë familje të varfër fshatarësh.

Pasi i bëri gjilpërën, Spiroja priti i ulur mbi një stol të vjetër, pa i hequr sytë nga fytyra e dobësuar e fëmijës. Sa kohë priti? Një orë? Dy orë? Fshatarja e strukur pranë shtratit të fëmijës nisi përsëri me dënese.

I vuri termometrin. Temperatura kishte filluar të ulej «Shenjë e mirë», mendoi Spiroja, mbase vogëlushi e kapërcen.»

Filloi të gdhihej. Spiroja iu afrua dritares dhe hodhi vështrimin jashtë. Çdo gjë që zbardhur. Mje-

ku kapsalliti sytë dhe buzëqeshi. «Filloi një ditë e re. Ç'bëjnë vallë të sëmurët në spital?»

Në mëngjez fëmija e ndjeu veten më mirë. Kish mbyllur sytë dhe flinte i qetë. Spiroja ndjeu një gëzim të çuditshëm. I sëmuri e kishte kaluar rrezikun. Mjeku u çua, u la disa barna e porosi, pregatiti çantën dhe doli i shoqëruar nga fshatari.

— 5 —

Mario Bonati qe nga Xhenova e Italisë. Ai ish djali i një farmacisti që punonte me rrogë pranë farmacisë së një padroni. Që i vogël kishte ëndërruar të bëhej mjek. Kur mbaroi gjimnazin, u regjistrua në fakultetin e mjekësisë. Në kohën që vazhdonte studimet bota po ziente nga kontradikta të forta. Musolini fliste nga ballkonet e pallateve të mëdha dhe nxiste popullin italian në luftë. Atëhere Marioja nuk merrej me politikë dhe nuk ua vinte veshim fjalimeve të tij. Por, kur Marioja mbaroi universitetin dhe u diplomua në mjekësi lufta botërore kishte plasur.

Doktor Marioja punonte në një spital të Xhenovës, kur e thirrën nën armë. I dëshpëruar ai u vesh oficer. E dërguan si mjek regjimenti në Shqipëri. Një verë e kaloi në fushim në Bysënek të Elbasanit, nën hijen e disa plepave të motshëm, pranë një burimi të ftohtë. Kurse në dimër regjimenti mblidhej në gazermat e Shkumbinit, ku Marioja vizitonte ushtarët.

Jeta në repart i qe mërzitur. Më shumë e mërzitnin ushtarët me vizitat e tyre që s'merrnin

fund. Shumë prej tyre qenë stimulantë, gërvishnin plagët që të mos u mbylleshin lehtë, ose ngrinin termometrin duke e fërkuar.

Pastaj ngjarjet politike u rrokullisën me shpejtësi të madhe. Forcat fashiste italiane pësuan disfata të njëpasnjëshme nga partizanët shqiptarë. Regjimenti i Marios u shkri si një filluskë sapuni. Çfarë disfate! Çfarë turpi! Njerëzit u shpërndanë në të katër anët e vendit.

Kurse ai, Marioja, u end disa ditë nëpër qytetet e Shqipërisë, së bashku me shokët e tjerë, ish — oficerë të regjimentit. Mario Bonati që në një gjendje të rëndë shpirtërore. Nuk i punohej. Edhe mjeksia i që neveritur. Ngjarjet politike e kishin deziluzionuar plotësisht.

Një ditë një i njohur i zgjati një copë letër.

— Ç'është kjo? — pyeti Marioja me dyshim.

— Është një thirrje për ju, italianët.

— Çfarë thotë?

— Lexoje!

Në atë letër u bëhej thirrje italianëve, ish — ushtarëve dhe oficerëve që të kalonin me forcat partizane dhe të vazhdonin luftën kundër të njëjtit armik, ashtu siç bënë partizanët e batalionit «Antonio Gramshi» në brigadën e parë sulmuese.

— Jo, zotni, unë nuk jam më për luftë.

— Duhet të luftoni, doktor.

— Të luftoj? E përse?

— Të kontribuoni dhe ju. Tani nazizmin e kemi armik të përbashkët.

— Unë s'kam ndër mend t'i lë kokat në viset tuaja. Armiqtë e mij janë vetëm mikrobet.

— I trembesh vdekjes?

— Po, i trembëm. Zanati që kam më vë shpesh përballë vdekjes.

— Ju jeni ushtar dhe ushtari vdes vetëm në llogore.

— Gjepura! Këto fjalë u thuhën rekrutëve ditët e para kur vijnë në repart.

Dhe kështu rrodhën ditë të trishtuara për Marion. Qyteti i dukej pa jetë dhe i heshtur si vdekja. Në shpirtin e tij kishin ndodhur ndryshime të mëdha. Një hije e zezë ja kishte ndrydhur të gjitha dëshirat dhe s'e linte të merrte vendim. I dukej vetja si një njeri i paaftë, «Ndoshta një ditë do të më kalojë dhe atëhere do të filloj një jetë të re. Si do të jetë ajo? Kur do të fillojë?» Marioja nuk u jepte dot zgjidhje këtyre mendimeve.

Një ditë ai bashkë me disa të tjerë ra në duart e nazistëve. Ata deshën t'i pushkatonin. Dhe do t'i kishin pushkatuar në një fshat, po të mos kishin ardhur partizanët. Midis tyre dhe nazistëve u ndez një luftë e rreptë që edhe tani, kur i kujtohej, Marios i dridheshin mishrat. Aty nga darka gjermanët u thyen dhe fshati u lirua. Marion e muarën partizanët dhe e shpunë në shtabin e tyre. Që atëhere ai nisi të punonte në spitalet partizane duke mjekuar e s'nëruar të sëmurë e të plagosur shqiptarë. Mjeku admironte natyrën e këtyre njerëzve. Po ai nuk arrinte dot t'i kuptonte.

Në spitalin e divizionit Marioja po bënte disa muaj. Në të vërtetë ai nuk qe një spital ashtu siç duhej. Marioja pat punuar në spitale fushore të kompletuara bukur me materiale dhe personel, kurse këtu... E megjithatë aty njerëzit punonin me mish e me shpirt për të shpëtuar jetën e partizanëve të plagosur dhe të sëmurë. Doktor

Spiroja qe një njeri i çuditshëm dhe i palodhur. Shpeshherë Marioja e kishte zili atë njeri, për dashurinë që kish për njerëzit, për profesionin e mjekut, për shokët. Marioja mendohej të vepronte si ai, por e kishte të vështirë. «Spiroja me të vërtetë është i një brumi tjetër» thoshte me vete mjeku. Spiroja, Neki, Olga dhe Nazja luftonin kundër dy të këqijave: kundër nazizmit dhe kundër epidemisë së tifos së morrit me pak baza materiale dhe në një godinë të vjetër. Por ata kishin një gjë që s'e kishte Marioja, moralin. Ja kushte i mbante në këmbë të gjallë e të shkathët. Ja pse ata nuk dinin të ankoheshin asnjëherë.

Atë mëngjez Marioja ndodhej në ambulancë, me Spiron, kur trokiti dera.

Brenda u fut Rakipi me shkopin në dorë. Ai mendohej të ecte drejt.

— Si është puna, Rakip? — e pyeti Spiroja.

— Puna është se... unë duhet të dal, doktor.

— Pse, nuk je mirë këtu?

— Jo, ju falem nderit për gjithshka që keni bërë për mua, por unë duhet të dal. Samiu nesër del nga spitali dhe vete në repart, kurse unë...

— Atë e dimë ne, shoku Rakip.

— Shoku doktor, ashtu është, ju jeni mjekë dhe i dini mirë punët tuaja, por edhe unë e di mirë kur them se jam mirë.

— Edhe pak ditë dhe do të shërohesh.

— A e dini ju se ç'do të thotë një më pak në front, doktor?

— Them se e di.

— Jo, nuk e dini mirë, se, po ta dinit, do të

më kishit lënë të dilja. Unë do të ankohe më lart, ja tek po jua them.

Marioja mendoi se Spiroja do të grindej me të sëmurin. Ai u ngrit më këmbë, ju afrua Rakipit dhe e kapi për qafe.

— Shoku Rakip, na kupto drejt. Ne duam që ti të shkosh në front krejtësisht i shëruar dhe atje të luftosh sa për dy veta.

Rakipi i hodhi një vështrim këmbës së pashëruar, pastaj shkoi dhe kërkoi leje që të largohej. Marioja habitej. Ç'gjë i bënte këta ushtarë të vepronin në atë mënyrë? Çfarë i shtynte ata që të kërkonin me këmbëngulje të largoheshin nga spitali për të shkuar drejt e në front? Me siguri që i bën ideologjia e tyre. Këta janë komunistë».

— Interessant! — tha Marioja pasi doli Rakipi nga dhoma.

— Çfarë është interesante, doktor Mario? — pyeti Spiroja që nga dritarja ku po rrinte.

— Si çfarë? Po, ja, rasti i Rakipit. I thonë të rrijë në spital rehat, mirë e bukur, kurse ai na kërcënohet se do të ankohet me lart, në rast se nuk e lëmë të dalë nga spitali. Ç'i thua ti kësaj? Unë nuk arrij ta kuptoj. Me të vërtetë nuk e kuptoj dot.

— Për ne, partizanët, një qëndrim i tillë është i zakonshëm.

— I zakonshëm?

— Po!

— E pra dëgjo. Në regjimentin ku punoja përpara kapitullimit më ndodhi një fenomen i çuditshëm. Një herë m'u sëmurën shumë ushtarë nga verdhëza. Vrisja mendjen se nga vintë gjithë ai

numër i madh të sëmurës. Atë kohë nga Italia vinin mjaft pako me karamеле, çokollata nga familjet e ushtarëve. Në këto dhurata që vënë një lëndë që provokonte një farë verdhëze artificiale. Ushtarët largoheshin nga fronti në masë...

— 7 —

Spitali i divizionit do të shpërngulej dhe do të shkonte përpara. Fronti kishte shpërthyer dhe gjermanët u detyruan të tërhiqeshin. Tërë atë natë repartet e divizionit marshuan në këmbë, nëpër borën e bardhë që të vriste sytë. Bente të ftohtë. Ushtarët ecnin të lodhur njëshkolonë nëpër rrugë të tërthorta, që të mos diktoheshin nga aviacioni armik. Ata qenë veshur keq. Të ftohtët bente punën e vet. Disave u ngrinë këmbët, ndonjë tjetri duart dhe tani dergjeshin në spitalet e divizionit.

Doktor Spiroja qëndronte pranë dritares dhe vështronte atë qytet të vogël të shkatërruar nga lufta. Ai vështronte oxhaqet e shtëpive të vjetra, tymin që dilte prej andej dhe e kapi trishtimi.

«Si do të lëvizë gjithë ky spital me të sëmurët rëndë?» pyeste veten mjeku. Urdhëri ishte urdhër dhe urdhërat nuk diskutoheshin. Lufta kishte ligjet e veta.

Doktori dëgjoi një trokitje në derë.

— Hyrë — tha.

Në prak të derës u paraqit Dani.

— Shoku doktor, — tha ai me një zë të butë — janë disa njerëz poshtë që duan të takohen me

ju. Se ç'thonë, por unë s'ua marr dot vesh gjuhën.

Spiroja zbriti poshtë. Pesë burra qëndronin përpara derës së spitalit dhe po ngarkoheshin me Njërin nga ata ai e njohu. Ishte fshatari që e kish thirrur atë natë të ftohtë për t'i vizituar djalin e sëmurë.

— Si e ke djalin? — e pyeti mjeku me përzemërsi.

— Shumë mirë e kam, doktor. Të falem nderit, se ma shpëtove nga vdekja!

— Unë bëra detyrën — tha Spiroja dhe buzëqeshi.

— Atë që na bëra ti, o doktor, unë dhe gruaja ime nuk do të ta harrojmë gjithë jetën. Shpesh të kujtojmë.

— Ushtria juaj na ndihmoi — u hodh e tha një burrë tjetër tepër i gjatë e me mustaqe të dendura. — Okupatorët na i dogjën të gjitha. Ne jemi njerëz të varfër dhe s'kemi se si t'jua shpërblejmë...

— Mos e thuaj atë fjalë, — e ndërpreu Spiroja — ne kemi bërë detyrën tonë.

Malësori i shtrëngoi dorën fort.

— Morëm vesh se po ikni që këtej.

— Po, po, do të ikim. Fronti u shty më përpara.

— Ju lumtë e dalçi faqebardhë!

Fshatari i parë ju afrua.

— Doktor, ju kemi sjellë ca mollë për të sëmurët e spitalit dhe nja dy karroca për transportimin e të sëmurëve më rëndë.

— Ju falem nderit, shokë!

— Këto nau ndodhën e po jua japim me gji-

thë zemër tha malësori, duke vendosur dorën e djathtë në drejtim të zemrës.

— Ju falem nderit! — përsëriti Spiroja, i prekur.

Burrat shtrënguan duart me mjekun dhe u larguan. Spiroja mbeti për pak kohë në prak të derës dhe i ndoqi me sy derisa ata u zhdukën pas bërnyllit të rrugës.

«Njerëz të mirë», mendoi mjeku.

Karrocat, të tërhequra nga qetë, kishin ardhur përpara derës së spitalit dhe po ngarkoheshin me plaçka dhe me të sëmurë. Shtëpia e adaptuar për spital qe bërë rrëmujë. Të sëmuret që e kishin kaluar rrezikun e tifos së morrit zbrisnin vetë duke u mbajtur pas murit dhe zinin vend në karrocat e fshatarëve duke fshehur kokën në jakat e mëdha të kapotave.

Të tjerët, që ishin më rëndë, i sillnin me barela dhe i vendosnin në karrocë mbi kashtën e butë. Spiroja doli nga ndërtesa dhe mori drejtimin për nga kodra, ku ishin hapur varret e shokëve. Mbi varre vuri re disa lule që sapo kishin filluar të vëshkeshin.

«Kush i ka sjellë këto lule mbi varret e partizanëve tanë? foli si me vete mjeku i divizionit. Pastaj ktheu kokën dhe hodhi vështrimin nga qyteti. Njerëz nga populli që na duan», tha përsëri me vete.

Spiroja lexoi disa tabela prej dërrase që qenë vendosur pranë çdo varri: Sali Mato 1920-1944; Refat Kalaja 1924-1944; Liri Shpuza 1927-1944. Mjeku i lexonte dhe i sillte që të gjithë para sysh. Qenë të rinj, ëndërronin që pas lufte të ktheheshin në Shqipëri dhe të merrnin pjesë në rindërtimin e

vendit të shkatërruar nga lufta. Por vdekja e parakohshme ua preu ëndrrat përgjysëm.

— Shokë, prehuni të qetë, ëndrrat tuaja do t'i shpiem në vend!

— 8 —

Ollga kishte hipur në karrocën e të sëmurëve rëndë. Pranë saj qëndronte çanta e ndihmës së shpejtë ku zakonisht mbante barnat me efekt të menjëhershëm.

Prapa karrocave vinin të sëmurët dhe të plagosurit e tjerë, për të cilët s'kishte më vend. Disa ecnin të mbështetur në ndonjë kafshë, kurse të tjerët marshonin të mbështetur në supin e shokëve më të fuqishëm. Jashtë bënte ftohtë, bora kishte ngrirë, kurse karvani i karrocave dhe i të sëmurëve shtyhej përpara pa u ankuar. Asnjëri nuk kërkonte bukë për të ngrënë. Në ecje e sipër njerëzit gjenin ndonjë kokërr patate ose ndonjë kumbull të thatë. Të tjerët përtypnin bollgur të gjallë.

Infermierja ndjente lëkundjet e karrocës që llokoçitej nëpër gropat e kalldrëmit të rrugës. Megjithëse, nuk qe ngopur me gjumë, ajo mendohej t'i mbante sytë hapur. Dhe me sytë hapur ëndërronte...

... Kur iku nga brigada për të ardhur në kursin e infermiereve, përse vallë nuk kishte dashur? As ajo vetë nuk e dinte mirë. Ndoshta i vinte keq për të gjithë: për shoqet, për kompaninë dhe për Sulon, komandantin e skuadrës me fytyrën gjithnjë të vrenjtur, por me shpirt të mirë.

Para se të ikte, ai i kishte thënë:

— Nuk do të na harrosh, Ollga?

Vajza kishte ulur sytë.

— Jo, shoku Sulo. Nuk do të harroj asnjë nga shokët dhe shoqet e skuadrës. Midis jush e kam ndjerë veten si në shtëpinë time.

— Nisu atëhere. Të qoftë rruga e mbarë!

— Shiko, mos na mbahesh rëndë kur të na bëhesn doktoreshë. Dëgjove?

Të gjithë kishin qeshur. Pastaj kishin shtrënguar duart dhe qenë ndarë. Në kurs jeta që e ndryshme. Vajzat, nuk dëgjonin më të shtënat e mitralozave ose plasjet e predhave të artilerisë. Ndonjëherë netve, kur çdo gjë heshte, dëgjoeshin të shtënat e topave të rëndë. Po dhe ato vinin të transformuara, gati-gati të mbytura, nga një distancë shumë e largët. Në kurs vajzat bënin mësim teorik, ndërsa praktikën e zhvillonin në spital pranë të sëmurëve: lidhnin plagët, kujdeseshin për mjekimin e të sëmurëve, bënin gjilpëra.

— Çudi! Më lehtë është të jesh në front, se sa të shkruash e të mësosh gjithë këto gjëra që paska njeriu në trupin e tij — u thoshte Ollga shoqeve të saj.

— Ç't'i bëj komisarit të brigadës që m'u qep me gur në trastë, pa, po t'ishte për mua, s'vija këtu.

— Pse?

— Unë dola partizane për të luftuar dhe jo për t'u bërë infermiere — thoshte disi si e zemëruar Nazja.

— Ç'bëjnë shokët tani?

— Luftojnë! Ja ç'bëjnë.

— Kurse ne rrimë këtu, në fund të dynjasë, e mësojmë mikrobet e sa të tjera.

— Ndoshta edhe këto gjëra duhen, moj mo-trani. Kush do t'i mjekojë shokët tanë kur të plagosen ose kur të sëmuren?

— Mirë thotë!

— Infermiere të bëhen ato që duan.

As Ollga vetë nuk po e kuptonte se si po transformohej dalë ngadalë në infermiere. Po kë-shtu e pësoi edhe Nazja, kështu e pësuan edhe shoqet e tjera. Në kurs ato mësuan shumë dhe në mbarim të tij e ndjenin veten të afta të mjekonin çdo të plagosur e të sëmurë.

Spiroja dhe Neki kishin bërë çmos që t'u mësonin infermiereve të para të divizionit gjërat më të domosdoshme për të punuar në një spital.

Mbrëmjeve vajzat bënin shaka me mjekët, Da-nin dhe me të dy sanitarët, Selmanin dhe Agi-min. Ditët dhe mbrëmjet tani kalonin më lehtë. Ollga qe mësuar me njerëzit dhe deri në një fa-rë mase i vinte keq që kursi po mbaronte. Një ditë do të niseshin për në repart, afër frontit dhe do të ushtronin detyrën e infermieres së batalio-nit.

— Dy nga ju do të rrinë në spital — u tha mjeku një mbrëmje.

— Kush? — pyeti Nazja.

— Nuk e di. Atë do ta caktojë komanda.

— Si thua ti, Neki, a e di doktor Spiroja? — iu drejtua Ollga ndihmës mjekut.

— Ndoshta dhe e di.

— Ju.

— Asnjë nga ne nuk do të qëndrojë — foli e vendosur Nazja.

— As edhe një — përsëriti Lola.

— Atë mos e thuaj, se, po të vendosë komanda e divizionit, ju s'keni se ç'bëni.

— Ua! Brigadat kanë nevojë për infermiere.

— Pse, spitali nuk ka nevojë? — t'na Nekiu duke i hedhur një vështrim kuptimplotë Ollgës.

— Spitali le të gjejë.

— Ku t'i gjejë?

Ollga mblodhi supet. Ajo pa Nekiun dhe uli sytë.

— Ku e di unë?...

— Spitali i divizionit u shërben brigadave. Të sëmuret që do të dërgoni ju këtu për t'u shëruar duan shërbim dhe jo fjalë.

Vajzat heshtën. Arësytimi që me vend dhe nuk donte më diskutim.

Ollgës asaj mbrëmje i kishte rënë një nur i bukur. Bluza ia nxirrte format e trupit në dukje. Neki u shikonte me dashuri. Sytë e saj të mëdhenj të zez flisnin më tepër se sa fjalët. A kishte dasnuruar ndonjëherë ajo partizane?

Tek pushonin, Neki u kishte përshpëritur në vesh.

— Ollga, pse je bërë kaq e bukur?

— Që të të pëlqej ty — i që përgjegjur vajza me shpoti dhe që çuar në këmbë.

— Ç'pate, Ollga? — e pyeti Nazja.

— Asgjë! — tha Ollga duke hapur derën.

— Ku do të shkosh? — e pyeti Nazja.

— Do të dal pak jashtë.

Pas saj doli dhe Neki.

Në barrakë të sëmuret sapo qenë zgjuar nga gjumi. Refati hapi sytë, shtriu krahët për t'u çmpirë dhe buzëqeshi.

— Mirë mëngjezi!

— U zgjove? — e pyeti një partizan që rrinte pranë tij.

— Si është komisari? — pyeti Refati.

— Ka rënkuar gjithë natën.

— Sikur nuk po ndihet.

— E ka zënë gjumi.

Refati u ngrit më lart mbi dyshek. Tani e ndjente veten më mirë. Doktor Spiroja i kishte thënë se e kishte kapërcyer rrezikun dhe së shpejti do të delte nga spitali.

— Kur, doktor? — e pat pyetur ai kureshtar.

— Ndoshta nga java!

«Çudi me këta mjekët, habitej Refati. Asnjëherë s'të thonë të vërtetën.»

— Do të të japim një muaj leje shëndetësore që të shkosh ta kalosh pranë familjes, derisa ta marrësh veten mirë.

Refati do të shkonte pranë njerëzve të shtëpisë! Çfarë gëzimi! Çfarë lumturie! Refati me sytë e mendjes vraponte gjithë ata distancë të madhe që e ndante nga fshati dhe e shihte veten në rrugët e vendlindjes. Njerëzit e shihnin me kureshtje dhe nuk e njihnin. Ai po bënte dy vjet që qe larguar nga fshati, me një çetë partizane dhe që atëhere s'kish kaluar më andej. Qenë hapur fjalë se qe vrarë gjatë Operacionit të dimrit dhe në shtëpi e dinin të vdekur. Dhe ja, tani, ai do të kthehej përsëri në fshat. Fshati është djegur,

shtëpitë janë rrënuar, ndërsa njerëzit banojnë në kolibe të përkohshme. Ata e shohin më vërejtje këtë njeri të hequr nga fytyra sikur të ketë dalë nga një sëmundje e gjatë dhe e rëndë. E shohin dhe mendohen.

— More, po ky është Refati! — 'hidhet e thotë njëri nga ata.

— Si, ore, Refati?

— Po ne e dimë të vrarë?

Refati rri në këmbë përpara tyre dhe buzëqesh.

— Unë jam Refati, i tëri...

Sa e kishte marrë malli për njerëzit, për gurët e fshatit, për ato gërçne ku ai kulloste ato pak bagëti që i kishte lënë i ati. Nëna që plakur, supet i qenë kërrusur. Kështu e kishte lënë Refati dhe e ruante në kujtesë fytyrën e saj të dashur. A do ta gjente gjallë. A do të kish mundësi edhe një herë ta mbante kokën mbështetur në gjoksin e saj të ngrohtë, siç bënte kur që i vogël?

«Ndoshta nga java do të dalësh...»

Refati numëronte me mend ditët... I duhe-shin ende dhe pesë ditë. E si do t'i shtynte ai ato pesë ditë? Një, dy, tre... Pesë ditë dhe katër net. Ditët shkojnë si shkojnë, por netët, ato janë më të vështira për t'u kaluar.

« Mirë unë do të shkoj, po komisari? Ai i ka punët keq. Doktorët thonë se zemra i është dobësuar, aq sa... »

Komisari rrinte i shtrirë dhe mezi dëgjohej tek merrte frymë. Që kur kishte ardhur në spital, temperatura nuk i pat rënë. Digjej i tëri sikur të kishte nën vete një furrë me dru që s'shuhej

kurrë. Ai e kuptonte se gjendja e tij që e rëndë, por nuk donte t'i dorëzohej sëmundjes.

«Do të kalojë dhe kjo, thoshte me vete. Sa të më bjerë pak kjo temperaturë.»

Por temperatura nuk ulej. Sëmundja dita-ditës po e dobësonte. Sa kohë do të vazhdonte kjo gjendje kështu? Po sikur të vdiste? «Jo, unë nuk dua të vdes këtu në spital. Unë dua të rroj.»

— Komisar!

— Kush e thërriste? Nga i vinte ky zë?

— O shoku komisar? Si je sot?

— Doktor Spiro, ti je?

— Po, unë jam.

— Ë...

Komisari mblodhi forcat. Doktorin i ka ardhur pranë, fare pranë. I dëgjon zemrën, mushkëritë, e sheh në bebe të syrit për një konë të gjatë dhe prapë i dëgjon zemrën. Bën, ç'bën ai, aty e ka merakun, te zemra. Ç'të këtë vallë zemra e tij? Pse e dëgjon me kaq vëmendje doktor Spiroja?

Me sa duket diçka nuk vete mirë në trupin e tij. Por komisarin nuk do që të jepet. Ai dëshiron të luftojë me sëmundjen dhe me vdekjen dhëmb për dhëmb. Po. Dhëmb për dhëmb. Sa herë në kompani ka qenë pranë vdekjes! Midis gjyleve që pëlcisnin, midis predhave që i vërshellenin pranë veshit, ndërsa jo shumë larg nëpër transhe qenë groposur nazistët me helmetat e rënda, me tytat e pushkëve të drejtuara për nga kompania. Ai dhe shokët e tij shtrëngonin nofullat, kalonin në sulm duke thirrur:

— Përpara, shokë!

Nga të katër anët bëhej tym. Nazistët linin transhetë dhe ua mbathnin këmbëve. Dhe kështu,

pëllëmbë më pëllëmbë, kompania, komisari, shokët e tij ecnin përpara, çlironin fshatra, njerëz të munduar nga lufta dhe mungesa e ushqimit. Ata i prisnin në kasollet e tyre të varfëra, u jepnin patate të pjekura dhe mbrëmjeve këndonin këngë të bukura popullore.

«Vetëm temperaturë të mos kem, pa përsëri do të shkoj në kompani», mendon komisari. Këtu, bashkë me të është shtruar dhe Suloja. Edhe ai është i sëmurë nga e njëjta sëmundje. Të gjithë ata që janë shtruar në këtë dhomë janë infektuar nga i njëjti mikrob, qenie të vogla e të padukshme.

Komisari nuk e ndjen veten mirë. Atij po i merren mendë, sytë po i vishen, do të bërtasë, po nuk ka fuqi. Ca rrathë në ngjyrë të gjelbër i sillen përqark në mënyrë të ngatërruar dhe ndjen se pak nga pak po fundoset diku thellë, shumë thellë...

— Doktor Spiro! Doktor Mario! Ejani shpejt, se komisari... — thirri një i sëmurë me sa zë pati.

Në dhomë hyjnë me vrap Spiroja, Marioja, Ollga.

Ollga hap dritaren. Spiroja numëron pulsën e komisarit. Por pulsë nuk preket fare. Ai e kërkon me gishtërinjtë nervozë, por nuk e gjen dot.

— Pulsë nuk i kapet fare — tha Spiroja.

— As zemra nuk po i rreh — u përgjegj Marioja.

Të dy mjekët u panë sy ndër sy të shqetësuar.

— Komisarë po vdes — thirri Ollga e trembur.

— Pusho! i thirri Ollgës me inat mjeku.

Spiroja mori në dorë shiringën që i dha Neki dhe ia nguli të sëmurit në mish. I vuri në hundë një copë pambuk të lagur me ilaç. Komisari qëndronte i zbetë, pa frymë, gati si një i vdekur.

Mjeku u përkul mbi të, mbështeti duart në vendin e zembrës dhe filloi t'i bënte masazh. Aty e shtypte gjoksin e dobësuar të komisarit, aty e lironte. E bënte këtë punë me një përpikmëri të habitshme dhe me një vëmendje të madhe, sikur të kishte mbështetur të gjitha shpresat tek ajo lëvizje ritmike. Kur u lodh, atë punë e vazhdoi Marioja. Spiroja zgjati dorën dhe kërkoi pulsën e të sëmurit. Pastaj iu duk sikur diçka lëvizi, nën mollëzat e gishtërinjve të tij. Mos që ai, pulsi? Apo u gënjye? Përqëndroi vëmendjen te dora. Përsëri ai ndjeu ca rrahje të dobëta, të plogështa.

— I bëni edhe një gjilpërë për forcimin e zembrës — tha Spiroja i emocionuar.

Neki u theu në çast një ampulë të vogël, thithi lëngun e saj në shiringë dhe menjëherë e injektoi në krahun e komisarit. I sëmuri bëri një lëvizje shumë të lehtë të krahut.

— Është gjallë! — tha Neki.

— Tani filloi t'i rrahë më mirë — foli Spiroja i gëzuar.

Nën gjishtërinjtë e dorës së djathtë mjeku dëgjonte trokitjet ritmike të pulsit të të sëmurit. Ato në fillim qenë të dobëta, dhe godisnin si me frikë. Pastaj u bënë më të dendura, më të plota. I sëmuri hapi sytë i zbetë, i lodhur, sikur të që kthyer nga një marshim i gjatë, i sforcuar.

— Ku... jam? — pyeti ai.

— Në spital, shoku komisar.

— E?!

Ollga e shikonte Spiron me admirim dhe besim.

— Doktor, e shpëtove!

— Tani ai do kujdes të madh. Një krizë e dytë e shkëput atë nga ne përgjithmonë i tha infermieres së re mengadalë dhe doli nga dhoma me shokët e tjerë.

Suloja rrinte i shtrirë në krevatin pranë dritares. Ai ende nuk e kish marrë veten nga skena që pa me sytë e tij. Komisari kishte vdekur dhe që ngjallur përsëri. Me të Suloja që shtruar pothuajse në një ditë, por sëmundja e kishte rënduar më tepër komisarin. Kurse ai e ndjente veten më mirë. Forcat po i ktheheshin pak e nga pak dhe ndoshta nuk ishte larg dita kur do të delte nga spitali.

Në skuadër midis shokëve Suloja e ndjente veten mirë. «Shtëpia ime është skuadra», thoshte Suloja me vete. Familja e tërë i që vrrarë nga nazistët gjermanë. Edhe të afërmit qenë shpërndarë andej-këtej. Kjo luftë i kish hallakatuar njerëzit. Ishte fare i vetëm, prandaj që edhe i vrazhdë e i mbyllur në vetë-vete. Ollgën komandant Suloja e kishte si motër. Ajo kish edhe një veti që i bënte njerëzit menjëherë për vete. Në skuadër e donin të gjithë. Ollga i jepte lezetin e saj skuadrës. Dikujt i qepte këmishën, dikujt kapotën, dikujt i thoshte një fjalë të mirë e të ëmbël. Çfarë vajzë! Dhe ja, sëmundja e solli punën në atë mënyrë që Suloja të takohej përsëri me Ollgën në spitalin e divizionit.

Ollga ishte e zënë me punë të shumta. Në spital vinin vazhdimisht të sëmurë. Vinin nga të gjitha brigadat, nga vija e parë dhe nga prapavijat. Ata zbrisnin nga karrocet të dobët, të zbetë, të

ndihmuar nga shokët e tyre dhe futeshin në barrakë me shpresë se do të shëroheshin. Ollga u bënte gjilpëra dhe i mjekonte, u jepte të hanin me lugë sikur të qenë foshnja. Një pjesë e madhe delnin pas disa javësh të gëzuar dhe të lumtur. Por edhe në varrezat pranë spitalit tabelat e drunjta shtoheshin. Ollga qëndronte pranë komisarit të kompanisë. Ai, megjithëse kishte s'npëtuar, prapëseprapë që në gjendje të rëndë. Ethet i kishin hipur përsëri dhe po e tretnin si qiri. I sëmuri fliste përçart.

Ajo qëndronte, pranë shtratit, me shpresë mos shikonte në fytyrën e komisarit bula djerse apo ndonjë shenjë të uljes së temperaturës. Por as njëra, as tjetra nuk po dukeshin. Pulsi që dobësuar përsëri. Gjendja që rënduar. Ajo e shikonte me admirim atë njeri që në repart nuk kishte ditur të pushonte një çast. Diku fliste me partizanët, diku organizonte një meeting ose merrte pjesë në mbledhjet e rinisë në kompani.

Aty nga mbrëmja gjendja e komisarit u keqësua më shumë. Spiroja, Marioja dhe Nekiun qëndronin pranë të sëmurit. Me të gjitha ndërhyrjet e tyre ata nuk mundën ta shpëtonin. Aty, në orët e para të mëngjezit, komisari mbylli sytë përgjithnjë.

Po atë ditë erdhën në spital tre luftëtarë nga reparti. Ollga u takua me ta e i pyeti për shokët dhe shoqet.

— Kemi ardhur të takohemi me komisarin — tha Jakupi, përgjegjësi i shëndetësisë në brigadë.

— Me komisarin?

— Po.

— Këtu nuk lejohet të futesh brenda — nguli këmbë. Ollga.

— Kemi bërë gjithë atë rrugë për ta takuar, kurse ti...

— Ka rregulla, shokë...

— Të ishte ndonjë tjetër e të na i thoshte këto, epo hajde, por ti, shoqja jonë, që na njeh?!

— Nuk bën, shokë, është sëmundje ngjitëse.

Ollga nuk u mbajt dot. Ajo u shkreh në vaj. Qante me ngashërim. Partizanët shikonin supet e infermieres që dridheshin dhe vështrojnë njëri-tjetrin.

— Ollga, ti diçka na fsheh.

— Komisari...

Partizanët hoqën bustinat. Ata nuk donin ta besonin që komisari i kompanisë kishte vdekur me të vërtetë. Ndoshta s'e kishin dëgjuar mirë, ndoshta infermierja...

— Domethënë është e vërtetë?

— Po

— Si do t'u themi shokëve në kompani!

Luftëtarët shikonin në tokë majat e këpuçeve e të opingave të ngrëna nga marshimet. Ata rreftuan Ollgën dhe e pyetën për çdo gjë rreth komisarit. Ajo fliste dhe fshinte sytë me shami. Fliste duke sjellë para sysh fytyrën e tij të zbetë e të ftohtë si vdekja.

— Shokë... — u dëgjua zëri i Jakupit. — Ç'bëjmë ne kështu? Pse e lëshuam veten fare?

— Ai ishte njeriu më i dashur në kompani.

— Vdekja e komisarit duhet të na frymëzojë e jo të na demoralizojë — tha Jakupi.

— Mua më duket se komisari nuk ka vdekur.

— Nuk ka vdekur.

Të tre partizanët u larguan nga spitali. Ollga qëndroi te praku i derës dhe i vështronte tek shkonin të heshtur drejt kodrës me varreza.

Doktor Marioja sapo që kthyer nga repartet ku e kishte dërguar doktor Spiroja për të kontrolluar masat higjieno-sanitare, luftën kundër çmorrirjes dhe për të vizituar të sëmurët që nuk kishin mundësi të vinin në spital. Me një punë të kështillë Marioja nuk që marrë ndonjëherë. Zakonisht të sëmurët vinin tek ai. Kështu ishte rregulli me sa dinte Marioja. Por këtu në divizion ky rregull që përmbysur.

— Mjeku duhet të shkojë tek i sëmuri, doktor, — i thoshte Spiroja me këmbëngulje.

Marioja qeshte.

— Nuk ka mundësi të bëhet një gjë e tillë.

— Kjo është çështje koncepti — përgjegjës doktor Spiroja. — Ne na është krijuar mendimi se nuk mund të bëhet ndryshe.

Ata bënë polemikë për këtë problem dhe secili ruante mendimin e vet. Tani që Marioja ishte kthyer nga repartet, mendimi i tij që lëkundur dhe ai po shikonte se pikëpamjet e Spiros nuk qenë pa baza.

— Ndoshta në të ardhmen, ne do të na duhet të krijojmë një mjekësi për njerëzit e shëndoshë.

— Si?!

Marioja buzëqeshte.

— Po, po! Ashtu siç ka një degë të mjekësisë që merret me shërimin e të sëmurëve, po ashtu duhet krijuar një mjekësi që do të mbrojë nga sëmundjet njerëzit e shëndoshë.

«Çudi me këtë doktor Spiron, thoshte Marioja

me vete. Ka një optimizëm dhe besim në të ardhmen për t'ia pasur zili.»

Ç'është e vërteta Marioja kishte mësuar shumë gjëra prej tij.

Vështirësitë e jetës dhe lufta partizane e kishin pjekur para kohe atë njeri. Spiroja nuk përfitonte asgjë nga zanati i mjekësisë. Çfarë mendime kishte ai mbi këtë profesion që shumë të tjerë i bënë të pasur? Kur që në Itali, Marioja pat ëndërruar të punonte në spitalin e madh të qytetit. Dhe ja kishte arritur qëllimit me ndihmën e disa miqve të të atit. Por lufta ia prishi tërë planet. Atë e degdisën në Shqipëri.

Këtu, në spitalin e divizionit, Marioja po fillonte një jetë të re. Spiroja, Ollga, Nekiu e konsideronin atë si shok të tyre. Ata e respektonin dhe kishin besim në aftësitë e tij. «Njerëz të çuditshëm këta shqiptarët; po të punosh, të duan e të respektojnë», mendonte Marioja me vete.

Një mbrëmje u mblodhën në ambulancë.

— Andej bëhet lufta — tha Marioja me shqipen e tij gjysma — gjysma.

— Edhe këtu te ne bëhet luftë, Mario. —

— Bëhet, por më ndryshe.

— Edhe ne luftojmë kundër mikrobeve, kundër epidemisë.

Nekiu nxori paqetën e cigareve dhe u dha nga një të dyve.

— Lufta që bëjmë ne është e heshtur, pa të shtëna artilerie — shtoi Nekiu.

Dhoma që mbushur me tym cigareje. Marioja ndiqte me sy tymin që ngrihej dredha-dredha mbi kokën e tij. Nekiu thifhte cigaren e mendohej. Përse mendohej vallë ai? Ndoshta e kishte men-

djen tek Olga? «Ata do të jenë një çift i bukur», mendoj mjeku. Aty për aty ai i pat zili ata dy të rinj që duheshin. Ç'bënte vallë e shoqja në Gjenovë në atë orë? A e kujtonte Marion? Kush e di. Ai kish kohë që s'merrte lajme nga ajo. Në letrën e fundit Gabriela i pat shkruar: «Më ka marrë malli për ty, i dashur. Kur do të vish një ditë në Itali? Vajza po rritet dhe të kujton shpesh. Këto ditë erdhi lajmi nga fronti i lindjes së doktor Zaketi u vra. Na erdhi keq të gjithëve. Ti e ke pasur shok». I gjori Zaketi! Kishin qenë shokë shkollë për një kohë të gjatë. Ai nuk ishte më i gjallë. Ndoshta do të qe vrrarë në ndonjë bombardim ajror, ose nuk do t'i kishte rezistuar dot të ftohtit të madh që bënte andej. Ndoshta edhe ai një ditë do të mbaronte si i mjeri Zaketi në këtë vend të huaj. Kështu mendonte Marioja, kur ende nuk e kishte marrë veten pas asaj tronditje shpirtërore, që pësoi. Tani pranë Spiros, Nekiut, midis të sëmurëve të spitalit ai e ndjente veten më të sigurt. Ndjenja optimiste dhe besimi po e përshkonin qënien e tij. Nga këta njerëz të thjeshtë, punëtorë dhe luftëtarë, ai po mësonte shumë gjëra.

Marios iu kujtua takimi me një luftëtar të vjetër në një kompani, kur shkoi për të ndihmuar reparatet. Mjeku e kishte spërkatur me pluhur DDT.

- Ç'është ajo, doktor?
- Pluhur!
- Çfarë djall pluhuri është ky?
- Pluhur është! Pluhur që vret morrat.
- Paska erë të keqe. Ptfu!

Marioja kish qeshur.

— Më tepër më pëlqen era e barutit. Besa po!
— qe përgjegjur partizani i vjetër.

Partizanët kishin qeshur. Ndërsa Marioja mendonte: «Shqiptarët janë njerëz të pushkës. Kushtet historike i kanë bërë të tillë».

Nëpër repartet e divizionit ai kishte parë njerëz të vendosur, të disiplinuar e luftëtarë. Disa prej tyre i kishte çdo ditë përpara; Spiron, Nekinë, Ollgën. Nazen dhe edhe Damen, portierin e spitalit. Njerëz të zakonshëm, që punonin me vetmohim, që mund të jepnin gjithshka për të shpëtuar jetën e tjetrit.

— 11 —

Ollga kish tri katër ditë që nuk e ndjente veten mirë. Pasdite e çanin kyçet, e pushtonte një dobësi e madhe dhe fillonte t'i dhembte koka. Vajza nuk i vuri rëndësi dhe nuk u ankua. Ajo pinte aspirina, ndjehej pak më mirë dhe atëhere kalonte nga një i sëmurë te tjetri për t'u ndarë barnat sipas porosisë së mjekut.

Masat që u morën në njësi dhe reparte dhanë rezultatet e tyre. Rastet me tifto morri ranë në mënyrë të ndjeshme. Në spital vinin e shtroheshin më rrallë të sëmurë. Lufta kundër murrave u kurëzua me sukses. Njerëzit e spitalit i kishin thënë «Ndal!» epidemisë.

Edhe lufta atje në front po arrinte fundin. Një ditë Ollga do të kthehej në fshatin e saj në Shqipëri. Do të shkonte në fshat bashkë me Ne-

kinë, do të takohet me nënën dhe pastaj do të punonin të dy në spital. Lufta kishte lënë mjaft të sëmurë. Spitalet do të kishin punë dhe ata të dy do të jepnin kontributin e tyre.

Ollga ra në mendime. Po bënte dy vjet që nuk i kishte parë njerëzit e vet. E kishin marrë malli për të ëmën, për motrat, për kopshtet me portokalla e limona, për rrugët me kalldrëm të fshatit. E për kë nuk e kishte marrë malli? Apo për detin e kaltër, shushurimën e valëve të të cilit i ndjente dhe tani këtu, në këtë vend midis maleve shkëmbore, shumë larg atdheut. Lufta kishte qenë e ashpër, dimri i ftohtë. Ajo e ndoqi batalionin këmba-këmbës. Kudo dëgjoheshin plasje predhash artilerie dhe aeroplanash që bombardonin pozicionet e vijave të para. Ollgës nuk i dilnin nga mendja luftimet e ashpra. Asaj iu kujtua kënga që këndonin partizanët e batalionit në darkë. Ishte një këngë që e kishin sajuar bashkë:

*O ti mali gropa-gropa,
Qëllon gjermani me topa
Topa, gjyle, aeroplanë
Gjëmojnë an e mbanë.*

Por tani ajo ishte pa qejf. I mërrëshnin mend dhe trupin e ndjente të këputur. Mos e ka nga lodhja? Mos është ftohur atë ditë që lau kokën? Ajo nuk e di. Vetëm se trupi i dhemb i tëri dhe ë ndjen se nga dita në ditë po bëhet më keq. Aspirinat nuk i bëjnë asnjë efekt. Gjumi nuk e çlodh. Çfarë të ketë vallë? Po sikur t'i thotë doktorit? Po Ollga nuk do të ankohet. Ata janë kaq pak njerëz në spitalin e divizionit sa vetëm largimi i njërit prej tyre do të

prishte shumë punë. Kush do të kujdesej për të sëmurët? Vetëm doktor Spiroja me Marion? E vërteta është se Marioja që bërë tjetër njeri. Ai punonte pa u kursyer dhe kishte ndryshuar. Mendimet pesimiste që dikur i patën pushtuar trurin po i daraviteshin si ajo mjegulla e dendur që largohet për t'u lënë vend rrezeve të ngrohta të diellit. Ai që galle-ruar, punonte pa vënë re orarin dhe sa herë që Spiroja largohej me shërbim linte si zevendës doktor Marion. Që të gjithë në spital e donin atë njeri të huaj, me mjekrën e vogël ngjyrë gështenjë, që i thërriste njerëzit me fjalën: Compagno!. «Idetë e partisë po e transformojnë edhe Marion, ashtu siç na ndryshuen edhe ne,» mendoj Ollga. Po Nazja si do t'i bënte ballë, e vetme, gjithë asaj pune? Jo, ajo nuk do të ankohej te mjeku. Mbase do të shërohej.

Po një mëngjez Ollga nuk mundi të çohet nga krevati. Që shumë e sëmurë. Erdhi Spiroja dhe e vizitoi Ai u ngrit në këmbë, u hodhi një vështrim të shpejtë Marios dhe Nazes, pastaj tha:

— Tifo e morrit.

Që atë çast Ollga u shtrua në barrakë bashkë me të sëmurët e tjerë. Temperatura i shkoi 40. Disa herë humbi ndjenjat dhe fliste përçart, dërsitej dhe i dukej sikur mbrëmja nuk do ta gjente të gjallë. Netët i dukeshin të gjata. Tepër të gjata.

«Përse nuk gdhihet?» mendonte infermierja e shtrirë mbi kashtën e verdhë të spitalit.

Mëngjezet vinin njëri pas tjetrit. Ollga nuk ndjehej mirë. Sula vinte pranë shtratit të saj dhe e pyeste:

— Ollga, si je sot?

— Sëmurë jam, Sulo.

— Mua më dukesh se je më mirë.

Ollga tundte kokën në shenjë pohnimi.
Suloja shpesh i linte racionin e tij të frutave.
— Haji, Ollga, të bëjnë mirë.

Ajo e shikonte Sulon me sytë e saj gjysmë të mbyllur.

Nga dritaret e barrakës futeshin rrezet e dritës. Jashtë koha që e bukur, qielli i kaltër. Pranë saj është edhe Nekiu. Ai e vështron dhe i buzëqesh. Po të mos që e sëmurë, do të qëndronte pranë tij e lumtur. Shumë e lumtur. Dhe ashtu do të bëhet. Në dejet e saj ndjen gjakun që i lëvrin, ndjen dashurinë për gjithë ata që ka pranë, për Nekinë, për vendin e saj, për jetën e re.

USHTARI ARTIST

Kur erdha në repart, më lindi dëshira për të punuar bocetin e një ushtari zbulues. Në fillim kjo qe një dëshirë e vogël, ngacmuese, të cilën u mundova ta largoja nga vetja. «Këtu në repart nuk do të kem kohë të merrem me skulpturë,» thashë me vete. Por kjo dëshirë nga dita në ditë erdhë e u zmadhua. Ajo nuk më ndahej më kudo që shkoja: në fushën e stërvitjes, në klasë, në orët e kulturës masive apo netve tek flija në krevatin me dy kate. Kush është artist, e kupton këtë ndjenjë. Kështu më ngjiste sa herë që filloja të punoja bocetin e ndonjë pune. Kjo ndjenjë më ndiqte pas si një hije dhe më linte të qetë vetëm atëhere kur unë merrja baltë argjili dhe filloja nga puna.

Një ditë fola me komandantin e skuadrës.

— Shoku Pali, mua më vjen ca ndoresh të bëj skulpturë.

— Pa shiko, ti qenke artist.

— Ndoshta artist nuk jam akoma, por desha... kam dëshirë të bëj një skulpturë.

— Çfarë do të bësh?

— Një ushtar zbulues.

Pali më shikoi me habi. Ai më hodhi vështrimin te duart dhe gishtërinjtë e mi dhe ndoshta nuk

i besohej që unë me ata dhjetë gishtërinj isha në gjendje të bëja një skulpturë një ushtar zbulues. Nënoficer Pali e kisha komandant skuadre. Ai që një komandant i përgatitur, i shkathët. Në stërvitje nuk bënte lëshime. Syri i tij i kontrollonte të gjitha veprimet. Donte vetëm lëvizje të përpikta, sipas rregullores. Rregulli dhe disiplina i kishte hyrë atij njeriu në gjak. Ndonjëherë e kisha dhe zili. Thosha me vete: «A do të bëhem edhe unë një ditë si Pali?» Por, kur shihja se me sa ngathtësi veprojë javët e para në stërvitje, mendoja se asnjëherë nuk do të arrija shkathësinë e komandantit të skuadrës.

Pali na përsëriste gjithnjë.

— Në mal, në qytet, në kinema apo në të ftohtë ushtaraku është ushtarak, duhet të veprojë sipas rregulloreve dhe të ruajë krenarinë e ushtarit.

Prandaj, tek ushtari zbulues që do të mode-loja, dëshiroja të fiksoja ato cilësi prej zbuluesi të zot që kishte grumbulluar Pali në veten e tij. Në repartin tonë kishte dhe kuadro e ushtarë të tjerë të zotë. Kështu mund t'ju flisja për oficer Talon, komandantin e togës, për Ardianin, madje dhe vetë komandanti i repartit që një zbulues i mrekullueshëm, me trup të lidhur, me shpatulla të gjera si prej atleti. Por mua, si skulptor, më tërhiqte më tepër nënoficer Pali me hundën e tij të drejtë, me nofullat e theksuara dhe sidomos me atë vështrim burror që depërton në thellësi e gjerësi. Boceti duhej të paraqiste një ushtar zbulues me automatikun në gjoks, me helmetë, me muskuj të tendosur, të shkathët e të guximshëm, që arrin të kapërcejë çdo vështirësi në fushën e stërvitjes.

Çdo ditë dëgjoja nga goja e komandantit të

togës se cilat ishin cilësitë më të mira luftarake të një ushtari zbulues. I dëgjoja dhe i fiksoja në mendjen time. Këto të dhëna do të më duheshin për bocetin zbulues.

Unë isha akoma i ri në skuadër. Nuk e kisha ende përvojën që kanë ushtarët më të vjetër. Sapo qeshë ndarë nga prindërit, nga shokët, nga shkolla ku punoja si mësues vizatimi. Shpesht, duke qenë në rresht, mendja më fluturonte te nxënësit, te Gimi i vogël, nxënësi më çapkën i klasës, por që vizatonte aq bukur, aq pastër. Ndoshta ai një ditë mund të bëhej një piktor i vërtetë... Mendja më shkonte te prindërit, te vëllai që punonte si agronom në kooperativë.

E ku s'më shkonte mendja.

Kaq herë komandanti i skuadrës më pat tërhequr vëmendjen.

— Ushtar Arbeni, tregohuni më i vëmendshëm ndaj mësimit!

Unë skuqesha prej qortimit të tij, ashtu siç turpëroheshin nxënësit e mi, kur i qortoja në klasë. Atëhere largoja mendimet dhe përqëndroheshja i tëri në stërvitjet dhe te fjalët që thoshte Pali për lëvizjet e ndryshme të zbuluesit. Ngjitesha e zbrisja nëpër s'nkëmbinj e nëpër ndërtesa. Pali jo vetëm shpjegonte, por edhe vepronte me një shkathtësi të çuditshme si ndonjë artist cirku.

Mendimin tim për të bërë skulpturën e një zbuluesi Pali e priti mirë.

— Do ta vëmë në lulishten e repartit — tha ai duke qeshur.

Filluam nga puna. Gjetëm një dhomë të vogël (më saktë një depo), grumbulluam baltë argjili, pak hekur. Kjo qe atelieja. Atelie i t'nënçin, se ajo nuk

plotësonte as kërkesat më të thjeshta, por megjithatë përpara hiçit që diçka. Pali pozonte, unë punoja. Nga dritarja e vogël dhjetëra sy ushtarësh kureshtarë më vështronin tek punoja bocetin e komandantit të skuadrës.

— Një ditë komandanti e komisari i repartit erdhën në «ateli» për të parë se ç'po bëja me skulpturën e zbuluesit. Tani në repart të gjithë e kishin marrë vesh se ç'ishim duke bërë Pali dhe unë, artisti, siç më thërrisnin me shaka shokët e mi ushtarë. Kur pashë që po hynin në dhomë eprorët, mora drejtqëndrim. Po ashtu bëri dhe Pali. Duart i kisha tërë baltë, ndërsa rreth e qark ekzistonte një rrëmujë, që s'më ndahej kurrë gjatë punës: një kovë me ujë, baltë argjiloze në të katër anët dhe një stol i vjetër, mbi të cilin ulesha kur lodhesha.

— Punë të mbarë! — na uruan. — Si vete frymëzimi?

— Po mundohemi...

Panë skulpturën e i erdhën për qark. Qëndruan dhe e vështruan nga kënde të ndryshme të dhomës.

— E?

— Hm! — mërmëriti si nëpër dhëmbë komisar. Ai që një burrë i gjatë, pak zeshkan, me ca mustaqe të holla, që i mbante me shumë kujdes.

«A do t'u pëlqejë», thashë me vete pa e fshehur një farë emocioni.

«Ushtari zbulues» ishte e para punë artistike që po bëja me tematikë nga jeta e ushtrisë. Edhe unë s'e kisha të lehtë. S'kisha më shumë se 3-4 muaj që ndodhesha në repart me uniformën e ushtarit. Sapo kisha filluar të fiksoja reflekset e jetës dhe punës në ushtri.

— Ç'thua, shoku komisar, për veprën e ushtar Arbenit? — e pyeti komandanti shokun e tij.

Komisari vazhdonte ta shikonte skulpturën dhe heshte.

— Si të them...

— A ia ka arritur qëllimit? A është ky ushtari zbulues, për të cilin ne flasim çdo ditë?

Komisari heshte përsëri.

«Ndoshta e pëlqen, mendova me vete, më mirë se kaq s'kam si e bëj.»

— Për të ngjarë i ngjan nënoficer Palit. Bile do të thosha se i ngjan mjaft. Por a është kjo e gjitha? Ky është vallë qëllimi i artistit? Sikur ka fotografuar fytyrën e atij që pozon?

— Domethënë nuk e pëlqen? — tha komandanti shkurt dhe prerë.

— Kjo skulpturë sikur nuk paraqet botën e brendshme të zbuluesit tonë, psikologjinë, guximin, vendosmërinë.

M'u duk sikur tavani i asaj dhome të vogël më ra mbi kokë. Ndjeva një dhembje të brendshme, një dhembje që vetëm ne, artistët, e provojmë shpesh kur dikush na kritikon veprën. E pra! Gjithë ajo punë që pata bërë për të hedhur në skulpturë komandantin e skuadrës, nënoficer Palin, më shkoi kot. Unë e dija se mendimi i komisarit të repartit do të për'napej në të gjithë efektivin.

Ç'do të thoshin vallë shokët? Ata s'e kishin parë akoma skulpturën e ushtarit zbulues, pasi unë nuk kisha dashur që ta shikonin para se ta mbaroja.

«Le ta shohin në fund kur ta kem mbaruar,» thosha me vete. Dhe, sa herë largohesha nga dhoma e punës, i hidhja një cohë të ndotur me baltë

përsipër në mënyrë që ata, shokët, të mos e shikonin nga dritarja. Si do t'u delja tani atyre përpara? Ç'do t'u thosha? Unë e dija që ata e prisnin me kurreshtje atë skulpturë, tek e cila donin të shihnin ndoshta një pjesë të vetes së tyre. Por ja që komisar i nuk po e pëlqente. Ndoshta ai ishte nxituar. Ndoshta nuk qe thelluar mirë në interpretimin e botës psikologjike të veprës sime dhe... Si është e mundur që me një fjalë goje të thuash se vepra nuk ia ka arritur qëllimit?

Por komisar i, sikur ta kishte lexuar mendimin tim, më foli me një ton dashamirës.

— Ushtar Arbeni, ju mos u mërzitni. Kjo vjen se dhe ju vetë nuk jeni formuar plotësisht si një zbulues i vërtetë. Prandaj, unë mendoj, me aq sa kuptoj nga këto punë, nuk keni mundur ta realizoni artistikisht skulpturën e zbuluesit. Vepra juaj, i dashur Arben, duhet të përgjithësonte cilësitë më të mira të zbuluesave tanë, optimizmin, guximin, mprehtësinë. Ja pra, këto cilësi unë nuk i shoh në këtë skulpturë...

Komisari u afrua pranë meje dhe më vuri dorën në sup.

— A keni biseduar me shokët për këtë punë?

A keni shkëmbyer mendime me ta? Ndoshta do të ndihmonin më shumë.

Jo, shoku komisar, nuk kam folur me ta.

— Artisti i vërtetë duhet të komunikojë me njerëzit... Megjithatë unë jam i mendimit se ju do t'ia dilni në krye kësaj pune. Frymëzimin që kërkoni do ta gjeni në stër vitje.

Ata ikën. Unë mbeta vetëm, i dërmuar shpirtërisht, në dhomën e vogël, me muret e spërkatura me baltë argjili, me stolin e vogël të rrezuar përto-

kë. Pak më tutje qëndronte skulptura e Palit, me automatikun në gjoks, e ftohtë, pa botë të brendshme... Lulishtja e repartit do të mbetej përsëri pa statujën e zbuluesit.

Vendosa të mos merresha më me skulpturë sa kohë që do të qëndroja në ushtri. Dështimi më kishte thyer. Çdo ditë merrja pjesë në stërvitjet që bënte skuadra. Mëngjez për mëngjez skuadra rreshtohej në vendin e saj dhe me në krye nënoficer Palin nisi për në stërvitje. Rruga kalonte buzë një lumi të gjerë që turbullohej sa herë binte shi.

«Ushtar Arbeni, frymëzimin që kërkon do ta gjeni në stërvitje.» Këto fjalë të komisarit të repartit i sillja gjithnjë ndër mend në fushën e stërvitjes. Vështroja me kujdes oficer Palin, shokët e skuadrës se si vepronin në terren të thyer, në vapë apo në shi, ditën apo natën, kur lagështia e lumit të futej thellë, deri në mish. Nënoficer Pali qëndronte gjithmonë përpara skuadrës. Ai komandonte, vepronte, prapsonte. Unë vështroja dhe çdo herë zbuloja tek ai gjëra të reja, cilësira të atilla që Pali mendohej të na i ngulte në shpirt, të na i bënte shprehi. E shihja tek ngrinte dylbitë, fiksonte diçka në horizont dhe pastaj, pa u kthyer nga skuadra, komandonte:

— Ushtar Arbeni!

Urdhëroni!

— Merrni dylbinë dhe përshkuani se ç' shikoni në atë drejtim.

Ose:

— Ushtar Luani, thoni cilësitë që duhet të ketë një zbulues i vërtetë.

Dhe kështu pak e nga pak, duke u stërvitur, po formohesha si një ushtar zbulues. Kisha filluar

ta doja profesionin e zbuluesit, të interesohesha më tepër. Por kjo donte të thoshte se unë nuk e dashuroja më skulpturën. Jo. Ç'është e vërteta kisha ca kohë që nuk po punoja më në «atelie». Kjo ndodhi atëhere kur unë nuk munda të realizoja skulpturën e ushtarit zbulues. Skulptura i ngjante Pali, por vetëm kaq. Art nuk kishte në atë skulpturë. Komisari kishte patur të drejtë atëhere, por unë s'e kisha kuptuar mirë.

Ja pra çfarë skulpture kisha bërë. Tani e kisha të qartë që isha nxituar. Një ditë u futa në «atelie» vetëm dhe qëndrova pranë statujës. Pali më shikonte i lodhur, disi me keqardhje, sikur të kisha ardhur nga ndonjë udhëtim i largët. Pranë meje, në një qoshe, qëndronte një çekiç i rëndë. E rrëmbeva në dorë, e ngrita lart dhe e qëllova statujën me sa fuqi pata. Mbi dysheme përpara këmbëve të mia ranë me dhjetëra copëra prej balte të tnarë.

Që atëhere kaluan disa muaj. Në repart mbusha vitin dhe tanimë isha një ushtar i formuar. Shokët e vjetër u çmobilizuan. Iku dhe Pali. Vëndin e tyre e zunë ushtarët e rinj. Çdo mëngjez shkoja në fushën e stërvitjes. I njihja mirë tani ato gërxhe ku kisha bërë kaq shumë stërvitje.

Një mëngjez postieri i repartit më dha një letër. E dërgonte Pali, ish-komandanti i skuadrës sonë. Ai punonte në uzinën e traktorëve dhe pyeste për të gjithë, për oficerët dhe për ushtarët që njihnte. Por Pali nuk kishte harruar të pyeste edhe për diçka tjetër. Nga fundi i letrës ai shkruante: «Arben, ti tashmë je një ushtar i vjetër, një zbulues i formuar. Kam dëshirë që të bësh një skulpturë të përsosur për ushtarin zbulues, për shokët tanë.

Por ama, jo si ajo që bëre atëhere, kur sapo kishe ardhur në repart. Nisja dhe një herë kësaj pune. Kam besim se do t'ia arrish qëllimit».

Pali më ngacmoi një plagë të vjetër dhe më vuri në mendime. Disa nga këto mendime më frenonin, më pengonin që ta nisja skulpturën. Kurse të tjerat më nxitnin e më shtynin ta filloja sa më shpejt, të grumbulloja baltën, pak hekur dhe në kohë të lirë mbyllesha në «atelie». E bisedova këtë çështje edhe me ushtarët e skuadrës. Fola dhe me komandantin dhe komisarin. Që të gjithë ma mbështetën, por më dhanë edhe mjaft mendime rreth idesë së skulpturës.

Njëri më tha:

— Arben, e di si e mendoj unë ushtarin zbulues? Ai duhet të jetë... Si të them... i tillë që, kur ta shohim ne, shokët e tu, statujën, të themi: «Ja, ky jam unë, ky jemi ne.»

NËN NJË ÇATI

Doktoreshë Juli u nis një mëngjez herët për të pushuar në plazhin e Durrësit. Kishte marrë lejen e zakonshme në muajin korrik, sepse gjatë atij muaji nuk bëheshin operacione në repartet e kirurgjisë, me përjashtim të rasteve urgjente.

Bukuria e plazhit e ripërtriu mjeken e re. Ajo nuk ngopej së pari qiellin e pastër, rërën e ngrohtë dhe detin e kaltër. Puna në spital e pat lodhur së tepërmi, kështu që kishte vendosur të mos bënte asgjë. Donte vetëm të çlodhej. Për pesëmbëdhjetë ditë rresht do të rrinte larg problemeve të kirurgjisë, larg nga ankesat e të sëmurëve, larg nga salla e operacionit. Ajo qëndronte shtrirë me orë të tëra në rërën e nxehtë, me fytyrën të kthyer nga dielli, pa asnjë mendim në kokë. Dhe ashtu e shtrirë vështronte njerëzit që laheshin në det, që loznin me top, ndërsa tutje dukeshin varkat e vogla me vela si pulëbardha të vërteta.

Për pesëmbëdhjetë ditë askush nuk do ta thërriste «doktoreshë!» Mbrëmjeve Julin e kapte dëshira të shtrihej në atë lumë të madh njerëzish

që shëtisnin buzë detit. E vetmja gjë që mori me vete, veç rrobave, qe radioja e dorës. Me sytë të mbyllur, e shtrirë mbi rërë, dëgjonte muzikë dhe ndjehej e kënaqur. Gjellën e gatuar e ëma, kurse i vëllai bridhte nëpër plazh dhe vinte në kabinë vetëm sa për të ngrenë.

Netët në plazh qenë gjëja më e bukur për të. Kur muzgu i mbrëmjes zbriste mbi plazhin e nxehtë, ajo së bashku me të ëmën ulej në një nga stolat buzë detit dhe harrohej pas bukurisë së portit, që dukej sikur notonte mbi një det me dritë. Deti bëhej aq i qetë, sa të dukej se qe kthyer në vaj.

Një mbrëmje ajo qe ulur pranë bregut. Nga transistori dëgjohej melodia e një kënge të kënduar në festivalin e fundit. Juli dëgjonte me vështrimin e tretur nga porti, ku mezi shquheshin siluetat e vinçave gjigantë. Ata ngjanin si ca kafshë të mëdha të llahtarshme. Buzë detit shëtisnin njerëzit me lëkurë të bronctë dhe me veshje të shumëngjyrshme. Juli dëgjonte copa bisedash, të qeshura, melodi këngësh të njohura dhe vetëm ato çaste ajo harronte telashet që kishte pasur në jetën familjare, veten e saj, sallën e operacionit deri edhe të sëmurët që mjekonte në spital.

Atë çast pranë saj kaloi një çift. Mjekja dëgjoi zërin e gruas së re që pyeste:

— Të kaloi dhembja, Bujar?

Ku e kishte dëgjuar ajo atë zë? Ai zë iu duk i njohur. Iu kujtua menjëherë, atë zë e kishte dëgjuar në oborrin e spitalit para se të hynte në sallë për të operuar. Operonte një rast urgjent.

«Unë jam gruaja e Bujarit... Më thoni si është

ai... Ju do ta operoni? Ju falemnderit, doktoreshë!...»

— Sikur më pushoi — u përgjegj burri që ecte pak i kërrusur pranë saj.

— Ikim në dhomë? — u dëgjua përsëri zëri i gruas në errësirë.

— Si të duash.

Të dy hijet të kapura për krahu u larguan në drejtim të kabinave.

«Bujari me të shoqen paska ardhur në plazh,» mendoi Juli.

— 2 —

Tre vjet më parë doktoreshë Juli sapo që emëruar kirurge në spital. Edhe atë vit, sikurse tani, ajo pushonte me të ëmën e të vëllanë në plazhin e Durrësit.

Një ditë një grua e moshuar kishte trokitur në derën e kabinës së tyre.

— Më falni që po ju shqetësoj — kishte thënë ajo e shqetësuar.

— Urdhëroni! — e ftoi e ëma me përzemërsi.

— Më thanë se vajza juaj është doktoreshë...

— Po, sapo ka mbaruar...

— Kam djalin sëmure me dhembje... prandaj erdha.

— Çfarë ka djali juaj, moj nënë? — e pyeti Juli.

— Dhembje barku, të keqen nëna.

— Vuan nga stomaku?

— Ashtu i thonë dokëtorët. I japin ilaçe, aty i pushon, aty e zë prapë.

Juli u ngrit dhe bashkë me plakën shkuan tek i sëmuri. Mjekja u ul pranë të sëmurit dhe nisi të pyeste rreth sëmundjes.

— I thashë nënës të mos nxitohej, po ku më dëgjon ajo. Nënës gjithnjë si nënës, u sul menjëherë për te ju. Na falni që ju shqetësuam.

— S'ka gjë.

Shenjat e sëmundjes qenë të qarta. Sipas Julit i sëmuri duhej të vuante nga stomaku. Ndoshta kishte ulçer, por kjo duhej të verifikohej me anën e një radioskopie. Kur të ktheheshin në qytet pas plazhit Juli do t'i bënte një radioskopi dhe do ta mjekonte. Tani për tani po mjaftohej me disa barna.

Bujari që një djalë rreth njëzet e tetë vjeç dhe flokët kishin filluar t'i rralloheshin mbi ballë. Në përgjithësi Julit iu duk një njeri i hijshëm, por jo i bukur. Fytyra e Bujarit që e zakonshme, me sy të gjallë, që e tregonin njeri mendjempreh të dhe që dinte t'ua fitonte lehtë zemrat të tjerëve. Ai kishte mbaruar Institutin ekonomik dhe punonte në një nga ndërmarrjet më të mëdha të qytetit. Juli e kishte parë dhe herë të tjera në qytet këtë njeri, por nuk e njohte nga afër. Tani në plazh po njohëj me të në rrethana të veçanta. Ai i sëmure, kurse ajo me rolin e mjekes.

Të nesërmen Juli e vizitoi përsëri të sëmurin. Donte të sigurohej për diagnozën. Ka sëmundje të atillë ku diagnoza nuk mund të vihet menjëherë. Në këto raste mjeku duhet të bëjë disa vizita që të mund të arrijë në një konkluzion. Këtë mjekja e re e dinte fare mirë.

Bujari dhe njerëzit e tij e pritën përzemërsisht në kabinën e vogël të plazhit. Ai fliste dhe qeshte. Julit iu duk njeri interesant, i guximshëm, që dinte të hapte kollaj rrugë në jetë. «Qenka praktik», mendoi ajo, jo pa kureshtje.

— Keni një profesion të mrekullueshëm — i kishte thënë Bujari.

— Të gjithë profesionet janë të bukura — qe përgjegjur ajo.

— Në këtë pikë nuk jam dakord me ju. Më falni, — ai kishte qeshur duke nxjerrë jashtë dhëmbët e tij të bukur e të fortë — por kirurgjia do të thosha është diçka...

— Ju e teproni!

— Ndoshta...

Juli buzëqeshte. Bujari vazhdoi të filozofonte:

— Kështu ndodh në jetë. Çdo njeri fillon e mërzitet me profesionin e vet. Siç duket edhe ju, mjekët, nuk bëni përjashtim nga ky rregull. E megjithatë asnjeri nuk shkëputet dot nga zanati që ka zgjedhur. Ai i qepet gjithë jetën deri në vdekje.

Kur u kthye në dhomën e saj, atë e kishin pushtuar disa mendime të çuditshme. Juli u mundua t'i flakte ato mendime, por e kishte të vështirë. Përse i rrinte mendja te Bujari? Ç'ishin ato vështrime që i hidhte ai? Ndoshta Juli nuk bëri mirë që shkoi për herë të dytë tek i sëmuri. Po fundja përse të mos shkonte? Në fund të fundit ajo qe mjeke dhe duhej të shkonte tek i sëmuri aq herë sa e kërkonte nevoja.

Ai qe për të vetëm një i sëmurë. Asaj i interesonte të dinte nëse Bujari kishte apo jo ulçer në stomak. Ja, kjo qe e gjitha.

Julit nuk i pëlqente shqetësimi që ndjente. Atëhere përpiquej të vinte në dukje anët më negative të Bujarit. Atij kishin filluar t'i binin flokët, hiqej krenar dhe, kur fliste, mundahej të nxirrte në dukje gjithmonë veten e tij. Veç kësaj ai kishte treguar hapur një përbuzje për profesionin e tij. Kjo ishte diçka e pahijshme. Ajo tani që një vajzë e rritur dhe e njihte pak a shumë psikologjinë e njerëzve. Prandaj nuk duhej të bëhej skllave e disa ndjenjave të çastit, në një kohë që duhej t'i kushtohej profesionit të vështirë të kirurgjisë.

Bujari e kishte pyetur Julin nëse lexonte ndo një libër. Ai që rruar dhe binte erë parfum.

— Kam vendosur të mos lexoj asgjë.

— Pse? — që habitur ai.

— Dua të çlodhem.

— E kam fjalën për letërsi artistike, shoqja doktoreshë. Nuk di nëse e keni lexuar romanin «Dasma».

— Jo.

— Mëkat. Do t'jua jap ta lexoni.

— Ju falemnderit!

— Me siguri që do të t'ju pëlqejë.

Vizitat midis dy familjeve u bënë më të dendura. Bujari u miqësua me të vëllanë e Julit dhe vinte shpesh në dhomën e tyre. Ditën qëndronin në rërë së bashku nën një çadër dhe mbrëmjeve shëtisnin buzë detit. Vonë shkronin në hotelin «Adriatik» për të vallëzuar. Kështu pak nga pak Bujari u fut në jetën e saj. Juli e kuptoi se ata të dy qenë bërë shumë të afërt. Bujari kishte ditur të futej në zemrën e saj, prandaj edhe e dashuroi.

Në fund të vitit ata u martuan. Muajin e mjal-
tit e bënë në Pogradec, megjithëse qe ftohtë. Dar-
kave dilnin shëtitje ose rrinin në restorantin e
hotel «Turizmit» duke i përshpëritur njëri-tjetrit
fjalë dashurie. Një pasdite, megjithëse frynte erë,
u ngjitën në majën e një kodre dhe që atje sodi-
tën si në pëllëmbë të dorës Pogradecin me rrugët
e tij të ngushta, shtëpitë e vogla dhe liqenin e
shqetësuar.

— Sa bukur! — u mahnit Juli.

Panorama iu duk si një tablo e punuar me
ngjyra të kursyera.

— Unë nuk shoh asgjë të bukur, e dashur! —
qe përgjegjur Bujari duke ngritur jakën e palltos
së madhe.

Juli nuk foli. Ajo vështronte me ëndje rru-
gën kryesore gjatë liqenit, njerëzit që nxitonin
nëpër trotuarë dhe pemët e rreshtuara në të dy-
ja anët e rrugës.

Pas dhjetë ditësh ata u kthyen në qytetin e
tyre. Juli shkoi në shtëpinë e Bujarit dhe për të
filloi një jetë krejt e re. Ajo çuditej se si ky nje-
ri i qe bërë aq i dashur. Edhe në spital, ku kishte
shumë punë, fytyra e Bujarit e ndiqte ngado që
shkonte: në sallën e operacionit, në poliklinikë ose
në pavionet e të sëmurëve. Sapo kthehej nga puna,
i shoqi e priste me buzë në gaz. Ai mbyllte derën
e jashtme dhe e pushtonte në krahë sikur të kishte
ditë pa e parë.

— Ç'kemi, Juli?

— Punë, i dashur.

— A u lodhe?
— Sot kemi operuar me shefin pesë të sëmurë. Njërit i hoqëm veshkën, operacioni vazhdoi dy orë e ca.

— Shpëtoi?

— Them se do të shpëtojë.

— Po ulçerën time kur do ta shërosh? —
bënte shaka Bujari.

— Ti je një i sëmurë i radisiplinuar. Ilaçet nuk i pi, periz nuk mban dhe pretendon të shërosh.

— Atëhere operomë.

Ata qeshnin me të madhe.

— Të të them të drejtën. unë s'kam besim te ti — e ngacmonte përsëri Bujari.

— Të operon shefi.

— U zemërove, e dashur?

— Jo, Bujar.

I shoqi e shtrëngonte pas vetes.

— Më do, Juli?

— Po.

— Sa?

— Aq sa nuk tregohet. Po ti, Bujar?

— Shumë.

Kështu rrodhën ditët, javët dhe muajt. Burrë e grua kalonin mbrëmjet bashkë dhe e ndjenin veten të lumtur. Bisedonin për gjëra të ndryshme dhe Juli shpeshherë habitej me krenarinë e të shoqit. Ai gjithnjë mburrej për punët që bënte në ndërmarrje, mburrej për aftësitë e tij dhe linte të kuptohej se, po të mos qe ai në atë ndërmarrje të koklavitur, çdo gjë do të ishte shembur.

— Po të tjerët ç'bëjnë? — e pyeste Juli të shoqin.

— Të tjerët bëjnë muhabete. Ja, g'bëjnë...

Julit nuk i pëlqente që i shoqi të mburrej në këtë mënyrë. Ajo nuk i duronte dot njerëzit mburraveçë. Përse mendonte Bujari që vetëm ai e mbante ndërmarrjen? A nuk ishte kjo për t'u çuditur?

Një ditë Julit nuk iu durua.

— Ti mos e pandeh veten sikur je ekonomisti më i mirë në rreth.

Bujari qe vrenjtur.

— Ç'do të thuash, Juli?

— Dua të të them që lëri të tjerët të të mburrin. Njerëzit të shohin nga puna dhe jo nga guna.

Por Bujarit nuk i bënë ndonjë përshtypje këto fjalë. Ai dukej mjaft i kënaqur nga vetja. Me sa duket, punët në ndërmarrje i shkonin mirë dhe njerëzit e lëvdonin. Në fytyrën e të shoqit Juli lexonte ndjenjën e një besimi të tepruar.

Një darkë ai i tha asaj me mburrje:

— Sot drejtori më lëvdoi në mes të kolektivit.

— Pse?

— I mbarova një punë që ia rriti shumë prestigjin përpara ministrisë.

— Në fund të fundit ke bërë detyrën.

— Sa naive që bëhesh, Juli! Këto gjëra kërkojnë aftësira prej pelivani. Më kupton?

Julit qe vrenjtur në fytyrë. Ajo ia nguli sytë të shoqit.

— Ç'janë këto pelivanllëqe, Bujar?

Bujari priste që e shoqja ta përgëzonte. Kurse ndodhi e kundërta. Një ndjenjë zemërimi e pushtoi në çast. «Me kë flas dhe unë!» tha me vete.

— Ç'kemi andej nga fronti i kirurgjisë, e dashur? — e pyeti të shoqen me një zë artificial.

— Sot kam shpëtuar një njeri nga vdekja e sigurtë.

— Pa shih! — u tall Bujari me kujdes.

— Në një aksident të dëmtuarit i qe dërmuar shpretka dhe barku i qe mbushur me gjak — nisi të shpjegonte ajo, pa e vënë re ngacmimin e të shoqit.

Zemërimi e pushtoi përsëri Bujarin.

— Mjaft më! Vetëm për operacione di të flasësh ti...

— Kjo është puna ime, Bujar, — i qe përgjegjur gati me lot në sy.

— Kjo është puna ime! — u tall i shoqi. — Jeta ka edhe gjëra të tjera, ka muzikë, ka letërsi. Të kam thënë kaq herë të shkojmë për vizitë te drejtori, kurse ti...

— Bujar, ti po më fyen!

— Me ke shkova e u pleksa unë...

— Mjaft!

Rastet kur ata grindeshin filluan të bëheshin më të shpeshta. Ndonjëherë grindja fillonte për hiçgjë. Atëhere midis tyre ndorej një ftohtësi e çuditshme që e shqetësonte Julin. Kjo ftohtësi sa vinte e shtrihej më tepër midis tyre. Nga vinte ajo? Si lindte ashtu papritur e pa kujtuar? Ç'u bënë gjithë ato fjalë të ëmbla dashurie që i thoshte më parë ai? Mos vallë ajo nuk e kishte njohur mirë? Nga dita në ditë ai po bëhej tjetër njeri. Fyerjet binin si breshër njëra pas tjetrës mbi Julin. «Ti s'je gjë tjetër veçse një budallaçkë e diplomuar në mjekësi!» Julit i mblidhej në grykë një lëmsh që e lironte vetëm atëhere kur qante. Përse e përçmonte Bujari punën e saj? Ç'qe ajo për të? Mos vallë ai e quante vetëm pronë të tij, me të

cilën mund të bënte ç'të donte? «Paskam qenë fatkeqe! mendonte Juli për martesën e saj. Përse u nxitova dhe nuk bëra përpjekje për ta njohur më mirë këtë njeri?» Ajo kishte vepruar si një vajzë e papjekur. Tani midis tyre qe vendosur një durim mashtrues. Sa kohë do të vazhdonte kjo gjendje? A do të kishte durim ajo ta shtynte gjatë bashkëjetesën me Bujarin?

Në apartamentin e tyre tani nuk dëgjohej gjë tjetër veç grindjeve, fyerjeve dhe përplasjeve të dyerve. Juli mbyllej në dhomën e gjumit e dëshpëruar dhe qante. Flinte keq dhe nervat i qenë dobësuar. Hutimi i saj u kishte rënë në sy edhe shokëve të punës. Ajo punonte midis tyre dhe s'qe e mundur t'ua fshihte të gjitha shqetësimet. Ata ia lexonin brengën në fytyrë e në sy.

Një ditë, duke operuar në sallën e operacionit, shefi i kërkoi bisturinë. Mjekja nuk qe e përqëndruar dhe në vend të bisturisë i dha gërshërën.

— Dua bisturinë, dokoreshë! — i kishte thirrur shefi me një ton të ashpër. — Ku e keni mendjen?

— Më falni, doktor! — i qe përgjegjur Juli, duke u skuqur në fytyrë.

«Mirë që kam maskën dhe nuk më shohin,» mendoi mjekja e shqetësuar dhe gati iu mbushën sytë me lot.

Juli kishte bërë çmos që ta largonte ftohtësinë, që si një dimër i egër qe futur midis tyre. Ishte e vërtetë se ajo nuk e adhuronte më si më parë Bujarin, por nuk kish menduar kurrë të ndahej prej tij. Mirëpo ai sa vinte e ftohej gjithmonë prej saj, nuk e përkëdhelte më si më parë. Çfarë kishte ngjarë? Mos vallë dikush tjetër qe futur në

mes të Bujarit? Këtyre pyetjeve ajo s'u jepte dot rrugë. Ato e shqetësonin, e hutonin dhe e linin pa gjumë.

— Bujar, ti nuk e kupton se me këtë qëndrim që mban po i vë kazmën familjes sonë? — i thoshte Juli.

— Ku merr vesh ti nga familja.

— Kush e thotë këtë? — nxehej Juli.

— Unë të them.

— Ti je një mikroborgjez.

— Po ti... Ti ç'je?

Bujari i pushtuar nga zemërimi kërkonte fjalët më të ulëta për ta fyer të shoqen. Ajo mbyllte veshët që të mos e dëgjonte dhe vraponte për në dhomën e gjumit. «Çdo gjë ka marrë fund, mendonte me vete, s'mund të jetohej më me këtë njeri. Le të bëhet ç'të bëhet». Midis saj dhe Bujarit që hapur një hendek i thellë, që nuk kapërcehej dot. Ajo kishte filluar ta urrente me të gjitha fuqitë e shpirtit. Tani vinte në dukje te Bujari disa të metat që më parë nuk ia pat vënë re. Për çudi ai tani i dukej dhe i shëmtuar, me veshët mjaft të mëdhenj e qesharakë. Si e kishte dashuruar ajo, Juli, një njeri të tillë? Ku i kishte pasur sytë? A e kishte dashur Juli me të vërtetë, apo ashtu i që dukur? Si do të rronte ajo me një njeri, për të cilin nuk ndjente më asgjë?

— 4 —

Një infermiere, shoqe pune, erdhi një ditë vizitë në shtëpi të Juli.

— Do të të them diçka — i tha mjekes.

Juli po priste që infermierja të fliste. Zemra iu drodh nga një parandjenjë e keqe.

— Vetëm mos ma merr për të keq — përsëriti ajo.

— Ne jemi shoqe pune dhe s'ka përse të zemërohemi — iu përgjegj Juli e shqetësuar.

Infermierja zuri vend më mirë në karrige, kruajti zërin sikur ta pengonte në fyt ndonjë gjë, pastaj foli.

— Mbrëmë kam parë Bujarin me një vajzë të zënë për krahu.

— Bujarin?

— Po, tët shoq.

Julin e zunë ca të dredhura. Asaj iu bë sikur dikush i hodhi nga lart një kovë me ujë të ftohtë dhe tani nuk përmbahej dot nga të dridhurat.

— Ndoshta të kanë bërë sytë — nguli këmbë ajo.

— Jo, nuk më kanë bërë sytë, dokoreshë.

Në zërin e infermieres kishte një siguri të tillë, sa që Juli nuk e pyeti më. Në ato çaste ajo donte të ishte vetëm për vetëm me brengën e saj. Koka i qe rënduar dhe i qe bërë si plumb. I dukej sikur brenda në kafkë qe futur një njeri dhe me një çekan të rëndë i godiste në mënyrë ritmike faqet e brendshme të kokës. Ajo kishte mbetur si e ngrirë dhe s'qe në gjendje të lëvizte ose të thoshte ndonjë fjalë. As infermierën s'e kish ndjerë kur qe larguar nga dhoma. Nuk mbante mend në e kish përcjellë deri te dera. Dridhej e tëra. Koka i dhembte. Ç'po ngjiste me të? Tani po provonte se ç'efekt mund të bënin fjalët mbi gjendjen shpirtërore të një njeriu të munduar.

«Duhet të ndahem sa më parë nga Bujari.»

— Ky mendim ju ngul në tru si thikë e mprehtë. Duhej të ndahej. Ç'kuptim kishte jeta duke ndenjur me të? Tek ai qenë mbledhur të gjitha të këqijat. Kurse ajo vazhdonte të jetonte nën një çati me të. Por sa e rëndë qe fjala «ndarje». E pa veten si një grua të braktisur e të gënjyer nga burri. Ky ishte zhgënjimi më i madh që Julit po pësonte në jetë. Ç'do të thoshte bota? Kujt do t'i jepnin të drejtë. Ajo e dinte që Bujari do të bënte çmos që të mos turpërohej e që nderi i tij të mos çenohej. Ai ishte i zoti për punë të tilla. Por ajo nuk do ta lejonte më Bujarin ta merrte nëpër këmbë.

Në mbrëmje, kur ai po hante darkën duke lexuar gazetën, ajo iu drejtua e vendosur:

— Bujar!

Ai nuk u përgjegj. Bënte sikur lexonte.

— Bujar! Nuk më dëgjon?

Julit i hipi një të kuq në fytyrë.

— Deshe gjë? — pyeti ai me indiferencë.

— Dua të të them diçka.

Bujari i hodhi së shoqes një vështrim kurreshtar.

— Thuaje!

— Të kanë parë duke shëtitur krah për krah me një vajzë.

Ai u zbeh. Mbështolli gazetën dhe e vendosi mbi tryezë.

— Shpifje! — thirri.

— Unë nuk mund të jetoj më me ty.

Bujari u ngrit në këmbë. Shtriu dorën drejt saj duke e treguar me gisht.

— Këto janë shpifje që i bën ti, me qëllime të këqija.

Pastaj veshi xhaketën dhe doli jashtë duke përplasur derën. Juli e pa që nga dritarja, nën dritën e llambave neon, tek qëndroi për një çast për të ndezur cigaren. Ishte i nervozuar. Ajo e vuri re mirë. Pastaj ai mori rrugën pa e kthyer kokën pas.

Juli qëndroi në dritare për një kohë të gjatë. Fytyra i kishte marrë një pamje të zymtë, të dëshpëruar. Në qiell kishte dalë hëna, një hënë e plotë, e rrumbullakët, që derdhte mbi qytet rrezet e argjendta. Mbrëmja qe e bukur, por në atë gjendje shpirtërore që kishte ajo nuk i bënte përshypje asgjë.

Pa dashur mendja i kaloi në vitet e kaluara, kur babai i saj me të gjithë familjen jetonin në fshat. Pasi mbaroi shkollën shtatëvjeçare në fshat, nga fundi i gushtit ajo hipi në një karrocë të kooperativës së bashku me babanë dhe u nis për në stacionin e trenit. Valixhen e vjetër prej dërrasë të mbushur me ndërresa Juli e mbante pranë, sikur të kishte frikë se mos ia merrnin. U dëgjua sirena e lokomotivës dhe pas pak treni ndaloi me zhurmë të madhe sikur t'i kërcisnin të gjitha këllqet. I ati e zuri për dore dhe që të dy u futën në një vagon pasagjerësh. Pas disa orësh treni e shpuri në kryeqytet, ku do të mësonte për ndihmës mjeke. Të nesërmen ata u futën në një ndërtesë të madhe e të lartë, në ballë të së cilës qe varur një tabelë e gjatë: «Politeknikumi mjekësor». Në këtë shkollë ajo mësoi të gjitha të fshehtat e organizmit të njeriut. Mësimet qenë të vështira. Katër vjet në politeknikum kaluan si era. Juli mbaroi me nota shumë të mira dhe menjëherë ia dha bursa për të vazhduar fakultetin. Mësimet u

bënë më të vështira. Më topër se çdo lëndë e tërhoqi kirurgjia. «Do të bëhem kirurge», vendosi ajo atëhere. Kur bënte praktikë, futej nëpër sallat e operacionit dhe harronte të dilte prej andej. Mbi maskat e bardha e shikonin vështrimet e kirurgëve të lodhur nga puna dhe nga pagjumësia. Disa nga ato vështrime i jepnin zemër, e inkurajonin për të ndjekur rrugën e vështirë të kirurgjisë. Por kishte dhe ndonjë kirurg që e vështronte shtrembër e me mospërfillje. «Ik, moj shoqe, se s'është për ty kirurgjia!» Juli i evitonte ata sy. Ajo ngulej në qoshe të sallës së operacionit dhe shikonte, dëgjonte dhe ndihmonte ata njerëz të veshur në të bardha, që qepnin ose hiqnin pjesë organesh.

Një ditë profesori i tha:

— Juli, lahu dhe ti dhe eja të na ndihmosh.

Me sa gëzim i fërkonte Juli duart me furçen e fortë. Me bisht të syrit ajo shikonte si vepronin kirurgët dhe bënte si ata. Kur iu afrua tryezës së operacionit e veshur krejt me rroba sterile, atë e pushtuan ndenja të çuditshme. Ajo dridhej e tëra nga një ndjenjë frike e pasigurie, që s'dinte se nga i vinte. Fytyra i qe skuqur, duart i dridheshin lehtë, ndërsa zemra i përpëlitej si një zog brenda në gjoks. Ja, kështu i kishte hapur shtigjet e kirurgjisë ajo. Kurse Bujari as donte t'ia dinte për këto gjëra. «Kukulla ime e vogël», tallej shpesh ai me të. Ai e donte Julin vetëm si një kukull për të luajtur në orët e vona të mbrëmjes. Me gjithë mend ajo kishte qenë një kukull për atë njeri me shpirt të vogël. Ajo e kish dashur Bujarin dhe gëzohej si një fëmijë kur ai hynte te dera e shtëpisë. I hidhej në qafë dhe ishte e lumtur. Kështu kishte ndodhur vitin e parë të

martesës. Pastaj çdo gjë filloi të përmbysej. Julit i kujtohej një mbrëmje kur ata po flinin. Mesnata sapo kishte kaluar, kur ra zilja e derës. Një motor maqinë rrinte ndezur poshtë, në rrugë.

Bujari qe ngritur nga shtrati.

— Kush është? — kishte pyetur i zemëruar.

— Jam unë, shoferi i spitalit, kërkojnë doktoreshën në sallën e operacionit.

Bujari kishte hyrë në dhomë tërë inat.

— Ç'dreq pune është kjo që bën ti?.. Nuk kemi qetësi as natën, as ditën nga të sëmurët e tu. Mirë ti se atë profesion ke zgjedhur, por unë ç'taksirat kam të prish gjumin? Tjetër herë fli në kuzhinë.

Kur qe kthyer Juli nga spitali, sapo kishte filluar të gdhiehej. Ajo nuk u fut në dhomën e fjetjes. E lodhur siç qe u shtri mbi minder dhe e zuri gjumi.

Ajo ngjarje u dha fund një herë e përgjithmonë marrëdhënieve të tyre. Kështu kaluan ditë të rënda për të. Pas disa javësh ata u ndanë me gjyq.

— 5 —

Menjëherë pas ndarjes mjekja e re u çorodit. Një dëshpërim i hidhur e ndrydhi dhe e bëri të hështur. Julit i bëhej së njerëzit flisnin vetëm për të, se e mbani në gojë orë e çast. Ajo nuk shkëputej nga spitali. I hipi një dëshirë e madhe për të punuar, për të qëndruar midis të sëmurëve, për t'i dëgjuar ata me vëmendje të madhe. «Ndo-

shta fatkeqësia e bën njeriun më të vëmendshëm ndaj të tjerëve», mendonte ajo.

Që në mëngjez Juli kish marrë shërbimin e mjekut të rojes dhe po mundohej t'u bënte ballë të gjitha telasheve që ka spitali gjatë rojes. Atë ditë shefi i repartit të kirurgjisë nuk kishte planifikuar asnjë operacion, pasi që nisur me shërbim me urdhër të drejtorisë së spitalit. Dhe Juli kish mbetur vetëm.

Ajo sapo që futur në dhomat e pacientëve për të pyetur të sëmurët e operuar, kur bëri ballë në derë infermierja e ambulancës.

— Doktoreshë.

Juli i hodhi një vështrim pyetës infermieres.

— Ka ardhur një urgjencë.

— Çfarë ka?

— Thonë se është një abdomen akut.

— Erdha!

Në ambulancë Juli gjeti drejtorin e spitalit. Ai i kishte kthyer shpinën dhe që përkulur mbi të sëmurin për ta vizituar. Kur mjekja iu afrua të sëmurit, iu duk se iu mor fryma dhe s'do të ishte në gjendje të bënte asnjë veprim. Përpara saj, shtrirë mbi shtratin e vizitës, qëndronte Bujari, me duart mbi bark, i zbetë, me këmbët të mbledhura kruspull nga dhembja. Fytyra e tij shprehte shoëtesim dhe frikë. Disu bula djerse i mbulonin ballin, ndërsa hunda dukej sikur i që holluar në majë. «Gjendje peritoneal», mendoi mjekja. Juli kishte kohë që nuk e kishte parë dhe as që kish dashur ta shikonte. Madje edhe emrin nuk donte t'ia dëgjonte. Ai njeri i kish prishur ëndrrat më të bukura që kishte pasur ajo mbi familjen, jetën dhe dashurinë. Ajo e urrente atë njeri. Po, e

urte. Asaj nuk i besohej që dikur e kish dashur. Njeriu që rrinte tani i shtrirë mbi tryezën e vizitës së ambulancës e kish torturuar, e kish fyer aq sa nuk tregohej me gojë. Por ai, Bujari, po yuante nga dhembje të forta barku. Jeta e tij qe në rrezik; rreth tij sillej përçark vdekja, e cila mund t'ia këpuste fillin e jetës nga çasti në çast. Juli e kuptoi se ulçera e stomakut qe shpuar dhe jepte atë kuadër klinik që mjekët e quajnë abdomen akut. Në këtë gjendje, po të mos operohej, i sëmuri vdiste me siguri. Por kush do ta operonte? A mund ta operonte Juli pas gjithë atyre gjërave që kishin ngjarë midis tyre?

Drejtori iu afrua mjekes. Me sa dukej ai e kuptonte se te Juli po zhvillohej një luftë mendimësh të kundërta; ndjenjat qenë përplasur me detyrën.

— E nisim për në Tiranë, doktoreshë?

Ky zë iu duk asaj sikur i erdhi nga larg, bile nga një largësi e madhe.

— Si thoni? — pyeti përsëri drejtori. — E nisim menjëherë me autoambulancë.

Mjekja qëndroi në mëdyshje.

— Në këtë gjendje? Ai vdes me siguri. — Ajë mori frymë lirisht dhe, duke e parë dretorin drejt në sy, shtoi: — Shoku drejtor, në radhë të parë unë jam mjekë.

— E dija që do të vepronit kështu, Juli.

Drejtori i lehtësuar doli nga ambulanca duke fshirë ballin me shami. Nga jashtë ai dëgjoji mjekën që urdhëroi me ton të prerë.

— Shpjereni të sëmurin në sallën e operacionit.

Në ato çaste Juli harroi se ishte grua. Përpara saj kaloi barrela me të sëmurin dhe ajo u nis pas

tij. Jeta e Bujarit varej në duart e saj. Këtë njeri ajo dikur e kishte dashur më tepër se veten; ndërsa tani ishte njeriu që përbuzte më tepër. E megjithatë ajo qe mjeke dhe do të shkelte mbi gjërat e saj personale, sepse duhej të shpëtonte patjetër njeriun, të shoqin e një gruaje dhe babanë e një fëmije. Me atë tjetrën kishte lindur dhe një djalë. Kurse ajo kish mbetur vetëm. Vetëm fare, me punën dhe me të sëmuret. Doktoresha vuri re se nuk ndjente zili. Ajo e kish fshirë nga jeta e saj atë njeri me të gjitha kujtimet. Tani dhe për pak ajo do të futej në sallë dhe do ta operonte për ta shpëtuar. Do të bënte çmos për ta shëruar që ai të kthehej pranë gruas dhe bebes së vogël.

— Me leje, shoqja doktoreshë?

— Më falni, shoqe, por jam e zënë.

Një grua e re me sy të përlotur qëndroi përpara Julit. Mjekja ndali hapin. Të dy gratë qëndruan përballë njëra-tjetrës.

— Urdhëroni! — foli me ngut mjekja.

— Unë jam gruaja e Bujarit.

— Ah!

— Tani sapo më lajmëruan në shtëpi se Bujari u shtrua në spital dhe erdha me vrap.

— Qetësohuni!..

— Më thoni si është ai..

Gruaja e re qante. Lotët i rridhnin nëpër faqe dhe i pikonin poshtë nën mjekër.

— Gjendja është e rëndë.

— E mjera unë!..

— Mbajeni veten! — i dha kurajë Juli.

Gruaja e Bujarit fshiu lotët dhe ngriti sytë mbi fytyrën e Julit.

— Juve do ta operoni?

— Po, unë do ta operoj. Mos u bëni merak, shoqe. Unë do bëj çmos për ta shpëtuar. Uluni diku në njërën nga këto stole dhe prisni. Tani do të hyjë në sallë.

— Ju falem nderit, daktreshë! Shumë ju falem nderit!

Juli kapërceu oborrin dhe hyri në korpusin kryesor të spitalit. Në thellësi të shpirtit ndjente një qetësi të çuditshme. Ishte e qetë dhe e sigurt.